



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 30 QERSHOR DHE 4 KORRIK 2011

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
30. JUNA I 4. JULA 2011. GODINE

QERSHOR – JUNI
2011

E enjte, 30.06. 2011, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hapi punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Sa për fillim, s'ka nevojë edhe pse mendoj që e kemi një kuorum të mirë sot.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Po, para se të fillojmë me rendin e ditës, ju njoftoj se me vendim të Presidentes së Republikës së Kosovës, është bërë zëvendësimi i deputetit Ibrahim Makolli, i zgjedhur ministër i Ministrisë së Diasporës, me deputetin e ri Emin Gërbeshi, kandidat i Koalicionit Kosova e Re, të cilit i dëshiroj punë të mbarë!

Ftoj deputetin Gërbeshi, që të nënshkruaj deklaratën e betimit.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Deklarimet jashtë rendit të ditës

Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjatë 5 minuta, ndërsa në emër të deputetit 3 minuta. Ju e dini që nuk ka replika në këtë pikë të rendit të ditës dhe 30 minutat janë të rezervuara vetëm për deputetët. Fillojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së shpreh shqetësimin e vet me veprimet e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i njohur për dy veprime të karrierës, heqjen e fotove të presidentit historik të Kosovës doktor Ibrahim Rugova dhe Nënës Terezë, si dhe themelimin e një çmimi që më parë ishte themeluar me urdhrin dhe mendimin e shefit të tij. Ai po vazhdon eliminimin politik të udhëheqësve të departamenteve dhe institucioneve të kulturës. Pasi largoi politikisht drejtorin e Departamentit të Rinisë dhe atë të Zyrës së Informimit, solli po ashtu politikisht sekretarin e përgjithshëm dhe nëpërmjet njerëzve të tij shantazhoi drejtorin e Qendrës Kinematografike dhe atë të Galerisë së Arteve. Tani ka shpallur konkurs politik për këta dhe drejtorë të tjerë, që të gjithë me kontrata valide. Po ashtu, të njëjtin veprim ka bërë lidhur me drejtorin artistik të Teatrit Kombëtar të Kosovës, që ka kontratë të ligjshme, gjë që është pranuar publikisht edhe nga vetë ministri, gjegjësisht ministria.

Ministri me dëshirë ose i urdhëruar 10 ditë më parë, në kundërshtim me ligjin ka urdhëruar që të emërohet drejtori i Departamentit të Rinisë ish ushtruesi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm. Sipas Ligjit për institucionet e kulturës, këto kontrata janë valide dhe janë nënshkruar pas vlerësimit të punës së drejtorëve. Për të shmangur këtë të vërtetë, ministri ka kërkuar interpretimin e Zyrës ligjore të kryeministrit, ndonëse një gjë e tillë është në kundërshtim me normat, pasi kjo zyrë nuk është një palë e tretë që bën

interpretime të pavarura, por një njësi e së njëjtës Qeveri, njësi në shërbim të shefit të ministrit.

Vlerësimi dhe vazhdimi i kontratave është në përputhje me normën ligjore të përcaktuar me Ligjin për shërbimin civil, neni 95 dhe 95.1 pikë b, si dhe me udhëzimin administrativ, numër 2002/8 të Ministrisë së Shërbimeve Publike. Qeveria e Kosovës edhe me këtë dikaster që nga fillimi i mandatit nuk ka bërë asnjë punë për të shënuar veç shantazhimit të shërbyesve civilë.

Grupi parlamentar i LDK-së këto veprime i konsideron jo ligjore, të papërgjegjshme dhe të papranueshme. Me këto veprime provohet se Qeveria ka emëruar në krye të dikastereve shërbëtorë politikë, pa dije dhe pa kulturë, të cilët po shumëfishojnë veten duke sjellë aty edhe njerëz tjerë si vetë ata.

Lidhja Demokratike e Kosovës kërkon që të respektohen ligjet dhe normat e tjera, të mos ketë ndërhyrje të strukturave politike në administratën e Ministrisë dhe të institucioneve, por të punohet për të krijuar kushte për punë.

Kasta politike e kësaj ministrie ka me çfarë të merret, sidomos tani pasi ka zvogëluar në mënyrë drastike buxhetin, pasi ka lënë pa përkrahje rininë dhe pasi ka shkaktuar për shkak të mospërkrahjes së aktiviteteve, përjashtimin e dy federatave nga garat ndërkombëtare.

Po ashtu, kjo ministri dhe ky ministër pas hoqi foton e presidentit Rugova, tani nëpërmjet Këshillit të paligjshëm të librit ka refuzuar bibliografinë për doktor Ibrahim Rugovën, e cila është menduar si pjesë e kompletit të veprave të njeriut të madh të kulturës shqiptare dhe themeluesit të shtetit të Kosovës. Kjo bibliografi është paraqitur në konkurs nga Shtëpia botuese “Faik Konica” e Prishtinës, e cila ka botuar vëllimet tjera të veprës së plotë të doktor Ibrahim Rugovës.

Grupi Parlamentar vëren se Qeveria ka zgjedhur autor dhe vepra të parëndësishme ose ky grup, ky këshill, madje edhe vepra që tashmë janë botuar dhe janë qarkulluar ose janë në qarkullim në tregun e librit dhe ka refuzuar përshkrimin më të plotë të shkrimeve të doktor Ibrahim Rugovës dhe të shkrimeve për të. Këshilli jolegjitim i ministrit dhe i shefit të tij po dëshmon se aty është për të punuar për Qeverinë e PDK-së dhe për interesat të një kaste politike dhe jo për të ndihmuar librin dhe kulturën.

LDK-ja, Grupi Parlamentar shpreh shqetësimin e thellë për këtë që po ndodhë në këtë ministri. LDK-ja edhe një herë kërkon që Qeveria të sillet në përputhje me mandatin që ka. LDK-ja konstaton se veprimet e njerëzve të Qeverisë së PDK-së në Ministrinë e Kulturës dhe në institucionet e këtij dikasteri, që nga dita e parë e këtij mandati janë tepër të dëmshme, në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe me çdo etikë.

Grupi ynë parlamentar shpreh shqetësimin e thellë për veprimet e tilla dhe bën thirrje që të hiqet dorë nga këto veprime të papërgjegjshme dhe jo të ligjshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Nga Partia Demokratike, fjalën e ka deputeti Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shokë dhe shoqe të Lëvizjes “Vetëvendosja”,

Në seancën e fundit nuk e pata mundësinë të replikoja, ani pse në paraqitjen time replikuan dy shokë të kësaj Lëvizje, shoku Glauk dhe shoqja Alma. Ne si duket nuk po kuptohemi, unë nuk e kuptova pse shoku Glauk u nxe aq shumë, kur unë përmenda emrat e shokëve të tij të përfshirë në biznese. qoftë edhe në kompani greke. Poenta ime ishte jo pse ata po bëjnë biznes, po pse ata nuk po i përmbushin vetë standardet që ua kanë vënë të tjerëve. Pra, ata po bijnë në kurthin që më aq kujdes ua kishin ngritur të tjerëve. Sipas mendimit tim, Fisnik Ismajli nuk ka bërë kurrfarë krimi ekonomik për faktin pse ka bashkëpunuar me kompani greke. Shpend Ahmeti nuk ka faj pse doganat ia kanë larguar vëllain nga puna, e as shoqja Alma pse ka punuar me zotin Behxhet Pacolli, as shoku Visar pse ka punua në Trustin Pensional, e as shoku Florin, zoti Florin, se kapitalist, ka përfituar prej burimeve natyrore. Normalisht, nuk ka asgjë të keqe, përkundrazi. Normalisht, nuk ka asgjë të keqe pse familjarët e Glaukut merret me import të pulave prej vendeve të ndryshme të rajonit. E keqja qëndron pse ju i gjykoni të tjerët kur veprojnë ngjashëm. Shoku Glauk më akuzon mua si gazetar, prandaj është hipokrit. Ju keni qenë shoku Glauk, së bashku me shokun Albin që më keni thirr në telefon, kur unë e kam udhëhequr Gazetën Ekspress edhe keni kërkuar që në Gazetën Ekspress ta botoni shtojcën e juaj. Kjo ka ndodhur për 62 herë. Ne kemi investuar në lëvizjen e juaj, kur keni qenë si OJQ kemi investuar 35 mijë euro, ua kemi botuar gratis, i kemi edhe të dhënat për këtë. Ndërsa, në anën tjetër, sikur unë të isha gazetar mercenar dhe Gazeta Ekspress të ishte mercenare, pse do të shkruante shoku Albin në këtë gazetë plotë dy vite dhe duke përfituar nga kjo gazetë 6842 euro. Si ndodhi atëherë, ku ishte ideali juaj në atë kohë? Atëherë ishit në gabim, apo tash jeni në gabim pse na sulmoni?

E fundit, por jo nga rëndësia, biznesi në Leposaviq meqë e ke për shumë qejf shoku Glauk, nuk zbulove asgjë, ajo u bë në mënyrë legale. Unë dhe partnerët e mi me vetëdije e kemi regjistruar atë biznes në Prishtinë dhe kemi operuar në Leposaviq. Në momentin kur unë kam vendosur të futem në politikë, jam tërheqë prej atij biznesi. Nuk do të thotë që kur ta lë politikën, nuk do t'i kthehem biznesit, sepse mendoj se vetëm në këtë formë Kosova ecë përpara.

Ndërsa, në anën tjetër, që e përmendi Leposaviqin, ne kemi konsideruar dhe janë investuar aty miliona euro për faktin që e kemi konsideruar që Leposaviqi ka qenë dhe është pjesë e Kosovës. Ndoshta ti nuk ke qenë asnjëherë atje dhe nuk do të shkosh asnjëherë atje. Mirëpo, ne ashtu e kemi konsideruar dhe kemi menduar që integrimi i Kosovës bëhet duke investuar edhe në atë pjesë të Kosovës, pa marrë parasysh a është Leposaviq, a është Zveçan apo Mitrovicë e veriut. Ne kemi investuar miliona euro, partnerët e mi kanë investuar miliona euro. Unë jam tërhequr prej atij biznesi, ndërsa pasurinë time, ti gënjeve Glauk kur the që e kemi bërë prej atij biznesi. Asnjë cent i buxhetit të Kosovës nuk është futur në atë ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Unë e kam bindjen që kjo pikë e rendit të ditës që sa herë nuk është duke u shfrytëzuar për çështjen për të cilën është futur në rend të ditës kjo ose në Rregulloren e Punës kjo pikë e rendit të ditës. Unë ju kisha lutur që të ngriten çështjet që janë në interes të publikut dhe që s'mund të hynë në debat në Kuvend. Shumë çështje që po ngriten, në këtë rast unë mendoj që janë më tepër arsyeime, akuza, kundër akuza, por jo diçka që është në interes të opinionit publik dhe, fundi i fundit, të qytetarëve të Kosovës. Megjithatë, vazhdojmë me pikën e rendit të ditës.
Fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Atëherë, të nderuar deputetë,
Unë nuk do ti drejtohem Beratit me shok, sepse kurrsesi nuk e kemi shok, tashmë e kemi definuar në seancën e kaluar si mercenar dhe kjo çështje është mbyllur, po me qenë se tha që duhet të ngriten këtu në Kuvendin e Kosovës çështjet të cilat i interesojnë opinionit publik, atëherë unë do t'i thosha Beratit që përpara se ta marrë çfarëdo të drejte për të akuzuar, duhet t'ia sqarojë opinionit publik se kush ia ka blerë atij xhipin e shtrenjtë të cilin e vozitë? Faleminderit!

KRYETARI: Nuk kjo seancë për pyetje parlamentare.
Vazhdojmë. Deputeti Skender Hyseni e ka kërkuar fjalën.

SKENDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar deputetë,
Zoti kryeministër, të nderuar ministra,
Unë sot kam marrë për shkas paraqitjen time një mori urimesh që i kanë shkuar këto ditë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, zotit Ban Ki Mun, me rastin e rizgjedhjes së tij në këtë post të rëndësishëm. Dhe, pa u vonuar, do të them që zoti Ban Ki Mun meriton absolutisht në të gjitha pikëpamjet, urimet më të përzemërta të Kosovës.

Po kjo nuk është arsyeja pse kam dalë këtu. Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, më 21 qershor i dërgon telegram urimi sekretarit Ban Ki Mun dhe ky ishte gjest i qëlluar, sa protokollar, po aq edhe shtetëror. Dhe nuk po hy në përmbajtje të vetë telegramit, është çështje të cilën do ta gjykojë secili veç e veç. Dhe do të ishte çdo gjë në rregull, sikur të mbaronte me kaq.

Vetëm një ditë më vonë, diku nga Afrika zëvendëskryeministri Behxhet Pacolli do ta urojë, po ashtu, Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Sikur nuk mjaftoi telegrami i kryeministrit.

Për befasinë time të madhe, vetëm një ditë më vonë ministri i Jashtëm i Kosovës, Enver Hoxhaj, po ashtu do t'i dërgojë një telegram urimi Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Pak më e ngadalshme në këtë rast u tregua Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, kjo më 24 qershor, domethënë, ditën e 4-të, pra.

Dhe, krejt në fund, kryetari i Parlamentit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi. Çka tregon kjo? Kjo tregon një çakordancë totale në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës, një mos koordinim total. Pas telegramit që Sekretarit të Përgjithshëm i kishte shkuar nga kryeministri i Kosovës, nuk do të duhej dhe nuk guxonte askush të dërgonte të njëjtin person, të njëjtin telegram me të njëjtin motivacion, natyrisht, me përmbajtje të ndryshme. Unë i kam lexuar përmbajtjet e të gjitha telegrameve, nuk kam kohë për t'i deklamuar këtu. Kjo shtron nevojën...

KRYETARI: Skender, edhe ty po ta tërheq vërejtjen, po keqpërdoret kjo pikë e rendit të ditës, këto çështje s'janë për t'i ngritur në këtë pikë të rendit të ditës.

SKENDER HYSENI: Zoti kryetar, nuk po e keqpërdori!

KRYETARI: Jo, keqpërdorim, jo veç nga ti, po nga gjithë folësit sot është keqpërdorë kjo pikë e rendit të ditës.

SKENDER HYSENI: unë po e shtroj nevojën e madhe që midis...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju lus, deputetë, ngritni çështjet për të cilat është bërë kjo pikë e rendit të ditës, jo për gjithçka, mos e bëni parlamentin strajcë të lypëses, ju lutem, a! Po, natyrisht, as nuk është urime e përshëndetje, as nuk është çka duash të flasësh këtu. Kush do t'i çojë, i çon telegram, secila njësi është në veti, institucion në veti, dhe mos u merrni me këto çështje!

(Reagim)

Pa, jo bre, se edhe s'e keni pas bërë fet edhe ju kur keni qenë në...!

Fjalën e ka deputetja Xhevahire Izmaaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kryeministër i Republikës së Kosovës,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të respektuar deputetë kolegë,

Unë, si deputete e këtij Kuvendi do të ngrejë një shqetësim lidhur me tre raporte ndërkombëtare të publikuara dje dhe mënyra e interpretimit të tyre, e cila në thelb nuk ishte ashtu siç prezantohej. Raport që me qëllim apo pa qëllim po mundohet të krijojë një opinion ndryshe tek qytetarët e vendit tonë.

Raporti i departamentit të shtetit ishte i drejtë lidhur me fenomenet për rajonin dhe Kosovën. Sa i përket prostitucionit në Kosovë, të jemi të sigurtë, Kosova nuk mund të jetë burim i prostitucionit, siç është interpretuar, por edhe mund të pajtohemi se si dukuri transite dhe veprimtari ekziston.

Personalisht kam një shqetësim. Pse nuk iu dha rëndësi faktin se Kosova u radhit në grupin e dytë nga Departamenti i Shtetit, duke e renditur Kosovën me Zvicrën, Japoninë, Greqinë, që nënkupton se një fenomen i tillë është edhe tek vendet shumë demokratike dhe zhvillimore, siç është edhe Zvicra, e në këtë pikë as Kosova s'mund të jetë immune.

Po ndalem tek raporti i Fridomhaus, i cili për Kosovën do të ishte shumë shqetësues sikur të bëhej nga ekspertë të pavarur ndërkombëtarë me një përmbajtje të tillë që e kemi. Por, më lehtësoi shumë fakti kur e pashë kush e ka përpiluar këtë raport. Mendoja se këtu është bërë ndonjë analizë e mirëfilltë, por prapë them se ndihem e relaksuar kur pash kush janë autorët e tij.

Ky raport nuk u duk seriozë dhe kjo organizatë po e zhvlerëson kredibilitetin e saj me raportet të cilat i merr të shkruara nga vendorët, të cilët kushtimisht mund të jenë raporte politike. Autorët e hartimit mund të jenë të paguar, mund të jenë edhe vegla që t'i kënaqin egot e tyre të cilët dëshirojnë që Kosova të duket e tillë. Më relaksoi fakti kur lexova se raporti është bërë nga këshilltarja e Presidentes së Kosovës, Arjana Qosaj dhe Krenar Gashi, nga KIPRED, e ky si i tillë prezantohet si raport i Fridomhaus, si fenomen. Hartimi i raporteve të tilla nga vendorët është shumë shqetësuese, sepse raportet të cilat po e dëmtojnë në vazhdimësi kredibilitetin e Kosovës në botë, po bëhen pikërisht nga njerëzit tanë, nga njerëzit nga vendi ynë. Por, këtu duhet të ndalem të shohim se sa serioz mund të jetë ky raport dhe kjo analizë, kur ne po e dimë nga vinë autorët e tij.

Raporti i Bankës Botërore e qet Prishtinën të fundit në rajon për joshje të biznesit dhe këtu pajtohem që burokracia në komunën e Prishtinës është shumë e lartë, pavarësisht masave që ka marrë Qeveria e Kosovës për joshje të bizneseve, por këtu kërkojmë që kryetari i Prishtinës të merret me këtë problem, që është shumë serioz dhe është përgjegjësi ekskluzive e tij, si kryetar i Prishtinës. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë. Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar dhe gjithë të pranishmit në seancë!

Duke u bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe duke u bazuar në dispozitat të cilat janë të paraqitura në Rregulloren e Kuvendit, ju si kryetar i Kuvendit dhe gjithë deputetët kanë të drejtë të marrin një nismë në të mirë të qytetarëve. Mirëpo, nuk kanë të drejtë ndoshta edhe aktin e rregullores, që e kemi miratuar vetë deputetët, të dalin edhe jashtë kornizave të një seance parlamentare. Në rast se është fyerje ndaj njërit deputetë, atëherë ato mund të sqarohen diku tjetër dhe jo në seancë parlamentare, ku të kthehet Kuvendi në inate personale. Për këtë arsye, si kryetar i Kuvendit, ke të drejtën ekskluzive që t'ju ndërpresësh fjalën në rast se nuk janë në pikën çfarë duhet të jetë një deputet i Kuvendit të Kosovës. Faleminderit! Për këtë arsye e mora fjalën.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

Ajo që desha të rrethoj, ishte se ne dje sapo erdhëm nga takimet e shumë përfolura tani, që i kishim në Bruksel, atje patëm takime në Komision Evropian, patëm në Këshillin e Evropës dhe patëm në Parlamentin Evropian dhe ajo çka desha të potencoj këtu, është që më bëri përshtypje se si Serbia shumë shpejt do ta fitojë kandidaturën në BE edhe falë negociatave me ne. Dhe ajo çka ishte më skandaloze në takimet që i patëm atje, ishte fakti që ata nuk kishin shumë ide për situatën se çka po ndodhë në Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë, nuk kishin shumë ide që atje po zbrazet territori për çdo ditë dhe ishin shumë të lumtur që paralelisht me këtë po ndodhin negociatat.

Desha po ashtu të them që çështja e shqiptarëve të Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës as që është çështje kur bëhet fjalë për kandidaturën e Serbisë në BE, dhe ne negociatat tona këtë kandidaturë jemi duke e ndihmuar dhe duke e realizuar pashmangshëm.

Desha këtu të flas edhe për qytetarët nga Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, të cilët edhe atje mund ta shikojnë drejtpërdrejtë seancën, po ka shumë të tillë që i kanë lënë vatrat e tyre dhe kanë dalë këndeje në Kosovë dhe sigurisht se edhe ata do të mund ta shohin. Pra, mos të shpresojnë shumë që në negociatat e tanishme, sepse ata janë duke shpresua jashtëzakonisht shumë që diçka do të zgjidhet për ta, mos të shpresojnë që Qeveria mendon për ta, që Qeveria e Kosovës mendon për ta, por le të fillojnë të mendojnë se si edhe atje, edhe këtu, edhe ku do shqiptarët duhet të fillojnë të mendojnë pakë më ndryshe, sepse duke qenë gjithmonë kokulur dhe duke i pranuar marrëveshjet sa herë që na kërkojnë të huajt, asgjë s'po fitojmë.

Po ashtu, tesha të them edhe diçka tjetër që në ato takime në Bruksel pati takime të rëndësishme dhe, megjithatë, edhe pse dyer për Kosovën atje, për Qeverinë, e sidomos për kryeministrin po mbyllen gjithnjë e më tepër, ne arritëm të kemi takime dhe takime të rëndësishme dhe të njoftojmë diçka. U deshtë t'i lëmë këto takime, pasi që më e rëndësishme se sa kjom është natyrisht interpelanca për autostradën dhe parregullsitë që po ndodhin për këtë punë dhe sigurisht që për këtë desha t'i falënderoj bashkatdhetarët tanë atje në Bruksel që na ndihmuan të vijmë shumë shpejt prej andej. Na organizuan që të jemi më të shpejtë dhe më fiksibil pasi këtë gjë nuk mund ta bënte Kuvendi as ambasada. Pra, jemi këtu sot...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Hashim Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: I nderuari kryetar i parlamentit, zot Krasniqi,

I nderuari kryeministër, zoti Thaçi,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Kohët e fundit po na ndodh shpesh në përcjelljen e spektakleve televizive, ku me të gjithë rastet viktimë janë njerëzit, e vërteta për të cilët në momente ende nuk është ndriçuar tërësisht. Nuk dua të ndalem fare në spektaklet që ndodhin me rastin e arrestimit të personave për të cilët organet e rendit dhe ato të drejtësisë kanë dyshime për ta. Po, në

momentin e arrestimit, ata kanë vetëm dyshime. Prandaj, edhe duhet mbrojtur identitetin e të dyshuarit.

Me qenë se vi nga komiteti i biznesit, më shumë jam i preokupuar me përjetimet e pakëndshme përball të cilave jo edhe rrallë gjenden kolegët e mi. Ndodhë që pa dashjen e tyre, por edhe pa siguruar fakte të mjaftueshme, ata janë aktorë të spektakleve televizive. Shumë lehtë ata shpallen kontrabandistë, shpëlarës të parave, kreator të krimit të organizuar, importues të ushqimeve të skaduar e të prishura, rrezikues serioz të shëndetit të konsumatorëve e tjerë. Që fatkeqësia e tyre të jetë më e madhe, të gjitha këto kualifikime bëhen përderisa çështja ende është në fillim të procesit. Bëhen në kohën kur ende institucioni kompetent nuk ka dhënë vlerësimin dhe nuk e kanë zbardhur të vërtetën. Skenarist dhe regjisor të spektakleve të tilla, për fat të keq, shpesh janë institucionet shtetërore, qofshin ato të rendit, të drejtësisë, tatimore, kufitare e tjera.

Unë përkrah personalisht secilin aksion që vërtet për synim ka luftimin e krimit dhe të gjitha rastet devijante në shoqëri. Madje, duke mos kursyer as biznesin, nëse vërtet ai ndodhet në këto ujëra. Mirëpo, është e paligjshme dhe në kundërshtim me të gjitha kodet e etikës profesionale që individ apo bizneset të denigrohen e të fajësohen ende pa siguruar fakte, përkatësisht kur ende procesi nuk është përmbyllur. Për më keq, publikohen emrat e pronarëve të biznesit apo të kompanisë, atyre u vishet një njollë që me mund të madh mund ta pastrojnë atë. Publikisht duke i shpallur fajtorë, ata dëmtohen rëndë, ndërsa biznesi i tyre humbë besimin në treg dhe te konsumatori.

I ngjashëm është edhe rasti i importit të më shumë se 50 tonë mish të pulës. Këtë fjalim e kam përgatitur në atë kohë, por nuk mu ka dhënë rasti të marrë fjalën.

Fillimisht, ky mall bllokohet në doganë, kurse publikisht zyrtarët e doganës deklarohen se ky mish ishte i skaduar dhe i rrezikshëm për shëndetin e konsumatorëve. Ndërkaq, pak më vonë del se me këtë mish gjithçka është në rregull nga inspektorët e AUK-ut. Mirëpo, u lëndua kredibiliteti dhe besueshmëria e konsumatorëve, jo me ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Me të vërtetë kjo pjesë e debatit po na merret nganjëherë edhe për çështje mendoj që po i dëgjojmë edhe nëpër konferenca partiake të shtypit, sot e patëm rastin komplet, një konferencë të shtypit të djeshme ta dëgjojmë edhe sot në këtë pikë, e cila me të vërtetë po ka nevojë që të jetë edhe për disa çështje që nuk kanë mundësi të shtrohen në mënyra tjera.

Unë po e shpreh shqetësimin e disa fshatarëve dhe disa fshatrave në komunën e Kamenicës, janë në kufi me Serbinë. Pata kërkesë javën që shkoi për ta shtruar, është kërkesë e tyre që lidhet me të drejtën pronësore dhe me të drejtën e kufizimit të lirisë lëvizjes për shkak të patrullimit të xhandarmërisë të shtetit serb në pronat e tyre. Ata kërkojnë që sa të jetë e mundur më shpejtë të shtrohet edhe me partnerë ndërkombëtarë kjo çështje. Është e rastit të thuhet, po ashtu, që arsyetimet që i ka dhënë herë pas herë pushteti i Beogradit rreth kësaj çështje, janë jashtëzakonisht të pavërteta, xhandarmëria serbe patrullon në raste të tilla vetëm në kufij me Kosovën edhe me Maqedoninë, zonat ku jetojnë shqiptarët, ata kanë dhënë arsye time për luftimin e krimit. Veç në vitin e kaluar kemi raste të arrestimit të një numri madh të kësaj strukture policore serbe që janë dhe që kanë qenë të përzier në kontrabandën, në çështje tjera, prandaj është mirë të punohet në këtë drejtim më shpejtë, në mënyrë që qytetarët tanë në këto fshatra të kenë më shumë liri të lëvizjes dhe të kenë qasje në kohën kur është vera të punojnë pronat e tyre.

Edhe një çështje tjetër që pata ta shtroj javën që shkoi dhe nuk më erdhi radha, Qeveria ka marrë një vendim për importimin e veturave të vjetra. Unë mendoj që krahas këtij vendimi të bëhet një vendim tjetër që ka të bëjë me heqjen, që ka lidhje me mjedisin, të heqin nga afërsia e rrugës një numër i madh i këtyre deponive të makinave të vjetra. Unë pata ta bëjë një pyetje për ministrin, po me qenë se ai rishtas ministër, ka qenë një vendim i Qeverisë, mendoj që duhet ta riaktualizohet dhe ky vendim të balancohet për shkaqe mjedisore dhe mendoj që është momenti më i përshtatshëm, e di që e ka edhe probleme ligjore, një numër i madh i institucioneve dhe sidomos ai vendor të bashkëngjiten në këtë çështje, po është çështje mjedisi që lidhet po ashtu edhe me Raportin e progresit të Komisionit Evropian. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Dhe, me këtë është harxhuar koha prej 30 minutash.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Kemi dy pyetje parlamentare, po të dy ministrat që janë të ftuar të përgjigjen në këto pyetje, ministrja Mimoza Kusari Lila dhe Besim Beqaj, si duket është shtuar numri i ministrave të jashtëm dhe ata nuk gjejnë kohë për qenë pjesë e Kuvendit, dhe nuk është mirë që kjo po ndodh zakonisht për ministrat që kanë pyetje dhe ata do të duhej të ishin sot në seancë.

Kemi pyetjen nga deputetja Afërdita Berisha Shaqiri dhe deputeti Goran Marinković. Doni, deputetë, të parashtroni pyetjet? Fjalën e ka deputetja Afërdita Berisha Shaqiri.

AFERDITA BERISHA SHAQIRI: Faleminderit, kryetar!

Jo, me qenë se nuk është prezentë, nuk do ta bëj pyetjen.

KRYETARI: Deputeti Goran Marinković, ka pyetje për ministrin Besim Beqaj. Nuk është këtu.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23 qershor 2011

A ka dikush vërejtje në këtë Procesverbal?

Prezentë janë 64 deputetë.

Atëherë, konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 23 qershor 2011.

Reagim nga salla)

Me sekretarinë bisedoni!

4. Interpelanca e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Hashim Thaçi, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosja”

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosja”, në bazë të nenit 44.1 të Rregullores së Kuvendit i është drejtuar kryetarit të Kuvendit me kërkesë për të ftuar në interpelancë Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi.

Ju njoftoj se në bazë të nenit 42.2 të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjatë deri në 3 orë.

Në bazë të nenit 44.7 të Rregullores së Kuvendit, përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në 10 minuta dhe në përmbyllje të debatit deri në 5 minuta.

Në bazë të nenit 44.8 të Rregullores së Kuvendit, kryeministri paraqet dhe arsyeton qëndrimin e Qeverisë për çështje të shtruar në interpelancë në kohëzgjatje prej 15 minutash. Koha e ndarë për diskutime sipas grupeve parlamentare dhe deputetëve pa grup parlamentar është, si vijon: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike 34 deputetë, 50 minuta, minus 8 minuta për kryeministrin. Grupi i LDK-së 27 deputetë, 40 minuta, Grupi “Vetëvendosja” 14 deputetë, 20 minuta. Grupi i AAK-së 12 deputetë, 18 minuta. Grupi Koalicioni Kosova e Re, 9 deputetë, 13 minuta, minus 2 minuta për kryeministrin, do të thotë i ka 11 minuta në dispozicion. Grupi i SLS-së, 12 deputetë, 18 minuta, minus 3 minuta për kryeministrin. Grupi “6+”, 6 deputetë, 9 minuta, minus 2 minuta për kryeministrin. 6 deputetët pa grup parlamentar deri në 2 minuta, që gjithsej janë 12 minuta.

Pra, në dispozicion kemi 3 orë, pozita 90 minuta, minus 15 minuta për kryeministrin, i mbesin 75 minuta. Opozita 78 minuta dhe deputetët pa grupe parlamentare 12 minuta.

KRYETARI: Ftoj përfaqësuesin e parashtruesit të interpelancës të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, që ta marrë fjalën.

Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: I nderuari Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Do ta filloj këtë fjalë në mënyrë pak të pazakontë, për shkak se nuk do të hyjë drejtpërdrejtë në temën e interpelancës, por jam i obliguar që ta bëjë një lloj historiku të zhvillimeve rreth kësaj interpelance ose një rekapitullim të cilën ju të gjithë e dini.

Siç e dini, Lëvizja “Vetëvendosje” e ka parashtruar kërkesën për interpelancë më 30 maj të këtij viti. Dhe në bazë të pikave 5 dhe 6 të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, interpelanca është dashur të mbahet më së largu 16 ditë pas kësaj date, pra është dashur të mbahet jo më vonë se në javën që ka përfunduar më 17 qershor.

Qeveria ishte ajo që e zvarriste datën e mbajtjes, sepse s’e dëshironte fare këtë interpelancë. Por, interpelanca megjithatë u caktua të mbahet të hënë, më 20 qershor, siç ju kujtohet. Dhe, siç e dimë të gjithë, më 19 qershor ndërroi jetë deputetja Nekibe Kelmendi dhe u varros në ditën kur duhej të mbahej interpelanca, pra më 20 qershor.

Lëvizja “Vetëvendosje” kërkoi më 20 qershor që interpelanca të shtyhet për një ditë, pra për të martën ose për seancën e ardhshme plenare, e cila ishte caktuar të mbahej të enjten. Por, Qeveria e Kosovës ishte ajo që sipas avazit të vjetër doli me mahinacionet e saj me qëllim të ikjes nga interpelanca.

Fillimisht, kryeministri Thaçi paralajmëroi se është i gatshëm të jetë i pranishëm në interpelancë vetëm e vetëm ditën e mërkurë, më 22 qershor, pra pikërisht në ditën kur Lëvizja “Vetëvendosje” kishte thirrur protestë “kundër hajnisë”.

Kur u kërkua që kryeministri të vinte në interpelancë për të enjten, arsyetimi i Qeverisë ishte se kjo gjë ishte e pamundur meqë, sipas tyre, kryeministri Thaçi do të udhëtonte atë ditë për në Bruksel. Kjo doli të jetë një gënjeshtër e kulluar, vetëm për sa të ikur interpelancës, sepse pikërisht të enjten, kur kryeministri supozoj që do të udhëtonte drejtë Brukselit, ai u shfaq në seancën plenare të Kuvendit, ku e kemi parë të gjithë. Bile, bile, me pauza të herë pas hershme ai qëndroi deri afër orës 13:00. Prandaj, kjo tregon që interpelanca paska qenë e mundur të mbahet atë ditë prej orës 10:00 deri në orën 13:00, mirëpo kjo nuk ka ndodhur për shkak të mos vullnetit të Hashim Thaçit të paraqitet në këtë interpelancë.

Kryeministri Thaçi nuk udhëtoi për Bruksel as të premten dhe as ditë të tjera, kur thoshte se do të udhëtojë.

Kryesia e Kuvendit vendosi së bashku me shefat e grupeve parlamentare në mbledhjen e mbajtur të martën, më 21 qershor, që interpelanca të shtyhet për javën e parë të korrikut. Meqenëse një numër i madh i deputetëve janë gjatë kësaj jave në udhëtime zyrtare dhe në mbledhjen e fundit të Kryesisë u vendos, në kundërshtim me vendimin e 21 qershorit, që interpelanca të mbahet për sot. Këtë vendim të Kryesisë e ka shprehur edhe kryetari i Kryesisë apo kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës publikisht, pra keni dëgjuar që ka thënë interpelancën do ta mbajmë në javën e parë të korrikut, ndërkohë që ajo po mbahet sot.

Dhe sa herë që përmendej kjo punë, e veçanërisht në Radio Televizionin e Kosovës, duke pasur parasysh edhe lajmet e natës së mbrëmshme, aty thuhej që interpelanca po mbahet përkundër faktit që shumë deputetë janë në vizitë zyrtare jashtë vendit dhe potencoheshin me emër vetëm 6 deputetë të Lëvizjes “Vetëvendosje”, pra asnjëherë nuk përmendeshin edhe 26 apo më shumë deputetë të partive tjera. Pra, RTK-ja jo vetëm kaq, por e publikoi edhe dje, e përsëriti një lloj filmi dokumentar promocional të sponzorizuar nga Bechtel, një ditë para interpelancës, një lloj siç pat vepruar, siç ju kujtohet, edhe të premten, para interpelancës së caktuar për të hënë, kur e organizoi një debat për autostradën, në mënyrë që ta zbrazë apo t’i paraprijë debatit i cili ishte parashikuar të ndodhte në Kuvendin e Kosovës. Por kjo tregon që RTK-ja, në vend që t’i shërbej interesit të përgjithshëm të qytetarëve të Kosovës, është shndërruar fatkeqësisht në vegël të interesave afariste të Hashim Thaçit dhe të bashkëpunëtorëve të tij.

Të gjithë jemi të vetëdijshëm që janë bërë tashmë një vit e dy muaj që kur është nënshkruar kontrata mes Qeverisë së Kosovës dhe konzorciumit Bechtel & Enka për ndërtimin e auto udhës Morinë – Merdar.

Ky projekt, i cili pa dyshim se është investimi më i madh kapital i Kosovës në këto 12 vitet e fundit, nuk dihet saktësisht se sa do të na kushtojë. Në këtë Kuvend kryeministri Hashim Thaçi pati deklaruar se ajo do të kushtojë diku rreth 700 milionë, ndërkohë që përmes mediave ministri i Financave e ka dhënë një shumë tjetër prej gjithsej 1 miliard eurosh, sigurisht duke kalkuluar kështu edhe koston e shpronësimit, ndërkohë që kontrata e nënshkruar nuk jep kurrfarë kostoje definitive. Atë kontratë ne ua kemi shpërndarë të gjithëve dhe besoj që e keni përpara dhe e keni lexuar atë.

Në preambulën e kontratës thuhet se, po e citoj: Kontraktori, pra Bechtel & Enka, zotohet se do të bashkëpunojë me punëdhënësin, pra Qeverinë, për ta arritur koston e planifikuar të ndërtimit prej 652.853.000 euro, ku përfshihet kostoja plus TVSH-ja. Kjo kosto synohet, por nuk është definitive, që nënkupton se Qeveria e Kosovës ka hyrë në kontratë pa e ditur saktësisht se sa do të na kushtojë ajo, kështu që presim sot nga kryeministri të na tregojë pse kanë hyrë në këtë kontratë, duke mos e ditur koston përfundimtare të saj, gjë që është shumë e rëndësishme kur e marrim parasysh koston e lartë të saj dhe kur e marrim parasysh buxhetin e varfër të Kosovës.

Vendimi që përfundimisht të shkohet me Bechtel & Enka dhe që të nisë ndërtimi i auto-udhës në këtë kohë, është tejet e dyshimtë. Së pari, ngutia për të filluar punën në auto-udhë, pa i siguruar mjetet financiare për një projekt të tillë, pa e ditur as koston, as trasenë e madje as dizajnin e rrugës, nuk i ka konvnuar fare Kosovës, por kjo kohë dhe ky vendim sigurisht se i kanë konvnuar Bechtel & Enkës, me qenë se vendimi për rrugën dhe nënshkrimi i kontratës erdhi në momentin kur Bechtel & Enka ishte në përfundim e sipër të rrugës në pjesën e Republikës së Shqipërisë dhe nuk dëshironte të humbte madje as një ditë të vetme, pa siguruar një profit të ri.

Në dokumentin vlerësues të kompanisë Eversheds, të kontraktuar nga Qeveria e Kosovës për ta vlerësuar kontratën e propozuar nga Bechtel & Enka, përmendet vazhdimisht

kostoja e planifikuar në rreth 400 milionë euro. Pra, a ka qenë plani fillestar që rruga të kushtojë vetëm 400 milionë euro dhe, nëse po, atëherë si u bë që kjo kosto u dyfishua në kontratën përfundimtare. Kjo tregon se Qeveria nuk ka pasur fare plan për këtë rrugë dhe as për koston e saj, dhe kur nuk ke plan, bëhesh pjesë e planit të të tjerëve dhe interesit të të tjerëve, siç u bë në këtë rast Qeveria e Kosovës dhe kryeministri i saj Hashim Thaçi pjesë e dëshirës së skajshme të Bechtel & Enka për përfitim maksimal nga ky projekt.

Çmimet e vetme që jepen në tekstin e mëtejshëm të kontratës, janë çmimet për njësi dhe një vlerësim i synuar i çmimeve për sektorë. Kontrata ia lejon kontraktorit që për secilin sektorë të rrugës, 9 sish sa janë gjithsej në këtë projekt, ta rrisë koston e paraparë për 20%, sepse Bechtel & Enka me kontratë e fiton të drejtën ta fillojë punën menjëherë në sektorin 1 dhe 2. Nëse vlera e kalkuluar e këtyre dy sektorëve nuk e tejkalon 120% e lejuar, atëherë punët vazhdojnë automatikisht në sektorin 3, dhe nëse vlera e tij nuk e tejkalon 120%, vazhdon në sektorët 4 e kështu me radhë.

Këtu, Qeveria e Kosovës nuk ia ka lënë vetes fare mundësinë të ndërhyjë në ngadalësimin e punës për t'ia përshtatur atë aftësisë financiare të buxhetit për t'i bartur kostot e projektit, pra që ne duhet të paguajmë, pavarësisht nëse kemi para apo jo.

Në kontratë po ashtu specifikohet se nëse punët në projekt zgjasin më shumë e 3 vjet, atëherë koston së punëve i shtohet edhe një 12% si mbulesë për inflacion që në vitin e parë, për të vazhduar me nga 4% inflacion në vite tjera. Kjo e obligon Qeverinë që të ngutet me punën, ndërkohë që nëse nuk ngutet, atëherë e paguan një përqindje pakuptimësisht të lartë të inflacionit, shumë më të lartë se sa inflacioni që po e projekton kjo Qeveri të jetë në Kosovë dhe shumë më e lartë se sa inflacioni standard në Eurozonë, pjesë e së cilës jemi edhe ne.

Po ashtu, presim nga kryeministri të na tregojë se sa kanë kushtuar dy sektorët e parë dhe a i kanë tejkaluar ato 120% e lejuar me kontratë. Se në kontratë shihet qartë se 120% lejon të kalohet dhe për këtë Bechtel & Enka nuk paguan asnjë dëmshpërblim, përveç se i duhet të pres për lejen nga Qeveria për t'ia nisur punën në sektorin pasardhës.

Kontrata është nënshkruar me kompaninë Bechtel & Enka pa e pasur të definuar saktë trasenë, pa e pasur dizajnin e rrugës, si dhe pa i bërë paraprakisht një vlerësim gjeologjik vendit ku ajo do të ndërtohet. Të gjitha këto elemente kanë mundësi t'ia shtojnë koston projektit, sepse traseja e rrugës, dizajni i saj, si dhe vlerësimi gjeologjik i tokës ku do të ndërtohet ajo, e përcaktojnë pak a shumë edhe sasinë e materialit ndërtues që duhet përdorur aty. Shtoja kësaj edhe mungesën e një kompanie mbikëqyrëse ndaj punës së kontraktuesit, ia ka lënë rrugën hapur Bechtel & Enkas që vet ta përcaktojnë se sa duan të fitojnë nga kjo kontratë.

Projekti ka filluar të ndërtohet dhe ka ardhur në fazën përfundimtare të tij në 37 kilometrat e parë, siç edhe është publikuar disa herë nga kryeministri në vizitat e tij dhe vetëm tash Qeveria e Kosovës e ka kontraktuar një kompani mbikëqyrëse të punës.

Dua të them për fund që Lëvizja “Vetëvendosje” natyrisht se është për “rrugën e kombit”, por kjo për të cilën po flasim, duket të jetë “rruga e hajnisë” dhe keqpërdorimit të kombit.

“Rruga e kombit” është rrugë e drejtë, e sakrificës së sinqertë për përafrimin dhe bashkimin e kombit, e jo rrugë e hajnisë dhe keqpërdorimit të parasë dhe pasurisë së kombit. Kjo rrugë e zgjidhur nga ju, kryeministër, është rruga e marrëveshjeve, e kontratave të dëmshme antikombëtare, rrugë e dëmtimit dhe stagnimit ekonomik, si dhe rrugë e varfërimit të kombit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Unë ju kisha thirr, deputetë, që në të ardhmen edhe në vazhdim të keni kujdes në fjalorin parlamentar. Në fund të fundit, përgjegjësi për fjalën publike e merrni vetë, por ruajeni pak një kulturë parlamentare, së paku.

Fjalën e ka kryeministri, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar Krasniqi!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Fillimisht, dua të falënderoj gjithë deputetët e subjekteve të caktuara politike të cilët kanë kërkuar këtë interpelancë për të diskutuar për projektin më madhor infrastrukturor që ndonjëherë ka ndërtuar Kosova, pra për projektin e ndërtimit të autostradës moderne, autostradës së zhvillimit dhe integritetit kombëtar dhe euro-atlantik, pra të autostradës Morinë – Merdar.

Unë me kënaqësi sot do të sqaroj në tërësi tërë procesin që ka të bëjë me ndërtimin e autostradës dhe gjithashtu do të jap informacionet e reja të fundit lidhur me dinamikën e realizimit të këtij projekti madhor.

Unë dua të besoj se deputetët të cilët e kanë kërkuar këtë interpelancë rreth ndërtimit të autostradës së integritetit, e kanë bërë një gjë të tillë vetëm e vetëm për të diskutuar për dinamikën e përfundimit të punimeve, sepse kjo është çështje kryesore në të cilën duhet të fokusohemi të gjithë.

Unë me kënaqësinë më të madhe mund t’ju konfirmoj se dinamika e deritanishme tregon një punë rekorde, të cilën në segmente të caktuara të autostradës arrin pikën e realizimit të punimeve deri në 12 muaj para afatit.

Besoj se të gjithë i gëzohemi këtij fakti, sepse kjo është një garanci shtesë që projekti ynë madhor do të përfundojë me sukses të plotë.

Qytetarët e Republikës së Kosovës jo më larg se këtë vit do të mund të përdorin komoditetin dhe lehtësirat që krijon kjo autostradë moderne. Ne jemi të sigurt se punëkryesi, konzorciumi prestigjioz botëror Bechtel & Enka do të arrijë që të përfundojë punimet në 40 kilometrat e para nga Morina deri në Therandë. Pra, në fund të tetorit apo varësisht nga koha, në fillim të nëntorit. Pra, qytetarët e Kosovës të cilët padurim presin përfundimin e kësaj autostrade, do të kenë mundësinë që të prekin rezultatet e para pozitive të kësaj autostrade qysh në muajin tetor, në fillim të nëntorit.

Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

E mirëpres gjithmonë përkushtimin tuaj për të kërkuar llogaridhënie për çdo cent i cili shpenzohet nga buxheti i Kosovës, të cilin e keni miratuar ju.

Ky interesim i juaj i kohëpaskohëshëm është interesim dhe zotimi imi dhe i Kabinetit qeveritar në baza ditore, sepse ne jemi shumë të vetëdijshëm për kufizimet buxhetore që i kemi.

Ne më mirë se askush tjetër e dimë se me çfarë kufizimesh ballafaqohemi, dhe sa vështirë është t'i përgjigjemi pozitivisht nevojave që dalin nga sektorët e ndryshëm të shoqërisë sonë.

Pikërisht për këtë arsye, Qeveria e Republikës së Kosovës është duke u treguar shumë e kujdesshme në çdo shpenzim të parasë publike. Mirëpo, kujdesi ynë në këtë aspekt në asnjë moment nuk nënkupton rrezikim të financimit të projekteve madhore kapitale të Republikës së Kosovës, sepse këto projekte kanë qenë të studiuara mirë dhe me kohë, është siguruar financimi i tyre. Kështu, për t'u siguruar së punë në autostradë do të vazhdojnë sipas dinamikës së paraparë, Qeveria e Republikës së Kosovës për vitin 2011 nga buxheti i Kosovës për nevojat e ndërtimit të autostradës ka ndarë rreth 250 milionë euro.

Të nderuar deputetë,

Unë do të doja që vërtetë t'i kursej qytetarët e Republikës së Kosovës nga ky debat i sotëm, i cili është kërkuar nga deputetë të caktuar për qëllime të caktuara dhe të ulëta politike.

Unë e kuptoj këtë gjë, po nuk mund të justifikoj dot qëllimet e tyre. Të kërkohet të ndërpriten punimet në autostradë, janë më tepër se absurde. Unë i garantoj gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës se punimet nuk do të ndalen për as edhe një ditë dhe as edhe për një orë.

Të kundërshtohet ndërtimi i autostradës, është naivitet, padituri, aventurë njerëzore, por edhe politike, është papërgjegjshmëri.

Tani me keqardhje më duhet të them se kjo interpelancë e sotshmja nuk është kërkuar me qëllim që gjoja të sigurohet transparenca dhe llogaridhënia për ndërtimin e autostradës së integritetit dhe të autostradës evropiane. Kjo interpelancë është kërkuar për një qëllim tjetër, është kërkuar për të krijuar zhurmë politike dhe për të shfrytëzuar urrejtjen politike e njerëzore të një grupi opozitar kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Unë i falënderoj të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që kësaj zhurme dhe kësaj urrejtje nuk iu ka përgjigjur dhe janë distancuar.

Për më tepër, kjo interpelancë është kërkuar për të bërë një përpjekje të dështuar për të krijuar hutë te qytetarët e Republikës së Kosovës lidhur me projektin e tyre më madhor.

Sapo që filluam ne ndërtimin e autostradës, u shpallëm antikombëtarë nga kërkuesit e interpelancës. Le të vlerësojnë qytetarët a është kombëtar apo antikombëtar ndërtimi i autostradës që e lidhë Prishtinë me Durrësin për 3 orë. Por, edhe kjo përpjekje do të dështojë sepse, e thashë edhe më herët që qytetarët e Republikës së Kosovës qysh në muajin tetor do të fillojnë të përfitojnë të mira që iu sjell kjo autostradë.

Pavarësisht kësaj, më lejoni të ripërsëris se Qeveria e Republikës së Kosovës e respekton plotësisht kontratën me konzorciumin Bechtel & Enka, përfshirë edhe nenin përkatës të kontratës që specifikon konfidencialitetin dhe mbrojtjen e biznesit të kontraktuesit në pajtim me standardet dhe praktikat ndërkombëtare në këtë fushë.

Draft-kontrata e prezantuar aty këtu, se gjëja është zbuluar, është një manipulim me opinionin publik, e ritheksoj, është manipulim me opinionin publik dhe interpretim sipas dëshirave dhe vullneteve politike. Në qasje e tillë, para së gjithash tregon seriozitetin për të vazhduar pra punimet, seriozitetin e Qeverisë së Republikës së Kosovës si partner i sigurt me investitorët e huaj.

Gjithsesi, cilado palë e interesuar ka pasur mundësi që të kërkojë qasje në dokumentin zyrtar, sipas ligjeve në fuqi, dhe institucionet kompetente e kanë theksua se kontrata finale mund të shihet, të studiohet, por nuk mund të bëhen kopje të saj për shkak të limitimeve të sipër cekura, dhe kjo është çështje legale, jo politike, këtu duhet të bëhet një qartësim i qartë.

Fatkeqësisht, ata të cilët e kanë kërkuar këtë interpelancë, tashmë i kanë shkaktuar një dëm të madh, lirisht mund të them, Kosovës, duke bërë publike në mënyrë të paligjshme, flas në kuptimin legal jo kombëtar e politik, duke bërë publike në mënyrë të paligjshme dhe të paautorizuar pjesë të kësaj kontrate ndërkombëtare, madje edhe duke bërë biznes në pjesë të kësaj kontrate. Ky veprim i pamatur dhe antiligjor do ta dëmtojë rëndë imazhin e institucioneve të Republikës së Kosovës në raport me partnerët potencial ndërkombëtarë, të cilët janë të interesuar të punojnë dhe investojnë në Kosovë. Përkundër kësaj, unë dua të them edhe një herë se projekti për ndërtimin e autostradës paraqet projektin më madhor në historinë e Kosovës, një investim strategjik për zhvillimin infrastrukturor dhe ekonomik të vendit.

Ky projekt madhor kontribuon në zhvillimin e ekonomisë përmes përdorimit të burimeve vendore, përdorimin e nënkontraktorëve vendorë dhe punësim direkt të qytetarëve të Kosovës. Momentalisht, rreth 3100 punonjës janë të angazhuar në projektin nga të cilët 68% janë punëtorë lokalë.

Është një projekt integruar, që Kosovës dhe qytetarëve të saj do t'ju ofrojë mundësitë më të mira për qarkullimin e lirë të njerëzve dhe të kapitalit.

Procesi i ndërtimit të autostradës ka qenë procesi më transparent i mundshëm, për të cilin ka pasur një konkurrencë të hapur dhe lojale ndërkombëtare, ku kanë konkurruar 7 kompani dhe konzorciume me renome globale dhe ku procesi i vlerësimit, i udhëhequr nga kompania Eversheds ka rezultuar zgjedhjen e konzorciumit Bechtel & Enka si

ofertuesi më i mirë, më i lirë dhe më i favorshëm për Kosovën, e theksoj, më i mirë dhe më i liri.

Pas këtij procesi, grupi ndërministror e ka negociuar kontratën finale me kontraktuesin e përzgjedhur gjatë një periudhe të gjatë dhe ka arritur të finalizoj një kontratë shumë të favorshme në interes të vendit dhe qytetarëve, realizimi i së cilës është paraparë të bëhet nga kapacitetet financiare të Republikës së Kosovës, pa pasur nevojë për hyrje në obligime kreditore ndërkombëtare, siç ndodh rëndom me zbatimin e kontratës të kësaj natyre kudo në rajon. E theksoj përsëri, se gjithë këtë proces e kanë përcjellë nga afër dhe drejtpërdrejtë të involvuar edhe Banka Botërore, edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, edhe Komisioni Evropian, edhe USAID-i. Pra, të gjithë faktorët relevantë ndërkombëtarë dhe është vlerësuar nga të gjithë faktorët ndërkombëtarë. Duhet thënë se është e palogjikshme që të krahasohen kontratat e këtij niveli ndërkombëtar me kontratat lokale në cilindo shtet, përfshirë edhe Kosovën.

Dallimet janë evidente në gjithë aspektet, qoftë në kapacitetet implementuese, standardet e kualitetit, përvojën profesionale, referencat e punëve të ngjashme, kohëzgjatjen e punimeve e kështu me radhë.

Autostrada Morinë – Merdar do të jetë autostradë e kualitetit më të lartë, jo vetëm në Kosovë, por në gjithë rajonin janë, e ndërtua sipas standardeve Përveç kësaj, kontrata me këtë konzorcium është kontrata më e favorshme krahasuar me cilëndo kontratë të ngjashme në rajon dhe për këtë mund t'ju ofrojmë shembuj të shumtë. Po ashtu, transparenca financiare e projektit është e plotë dhe të gjitha shpenzimet deri në detajin më të vogël janë të përfshira në Kornizën afatmesme të shpenzimeve, ligjet përkatëse për buxhetin, si dhe në raportet periodike për shpenzime të cilat bëhen publike për të gjithë dhe po ashtu diskutohen edhe në Kuvendin e Kosovës.

Prandaj, është për të ardhur keq kur herë pas herë, për qëllime shumë të ulëta politike, bëhen keqinterpretime të qëllimshme ose nga padituria dhe mungesa e përvojës në çështje të tilla.

Shembuj të marrë për çmimet e njësisë të caktuara nuk qëndrojnë, sepse ato nuk mund të interpretohen jashtë kontestit të përgjithshëm të punimeve.

Për shembull, krahasimi i çmimit të betonit është një absurdë në veti, që është prezantuar aty këtu, sepse çmimi i potencuar mund të jetë çmimi i ofruar në treg nga një prodhues i caktuar, që mund edhe të mos përmbushë specifikacionin dhe standardet ndërkombëtare të cilësisë. Por çmimi që është përfshirë në kontratën e autostradës është çmim gjithëpërfshirës që mbulon shpenzimet e prodhimit, shpenzimet e objekteve prodhuese, dërgimin e prodhimit final, formësimin e tij, vendosjen në vendet e caktuara, mjetet përcjellëse për vendosje, skelerinë, pajisjet për kryerjen e punimeve të betonit, programin për verifikimin e cilësisë, aspektet e sigurisë, testimin e prodhimit final e tjerë.

Pra, nuk mund të krahasohet vetëm një element i koston me koston e përgjithshme. Një qasje e tillë krijon konfuzion të panevojshëm dhe flet për mungesë të ekspertizës dhe padituri së nga ana e tyre që deklarojnë diçka të tillë.

Edhe çështje tjera që specifikohen në nenet e veçanta të kontratës, nuk mund të interpretohen si të ndara nga kontrata e plotë, e cila është e bazuar në standardet e Federatës Ndërkombëtare të Inxhinierëve Konsultues, në të cilat bazohen të gjitha kontrata serioze për ndërtimin e nivelit superior.

Për në fund, mund të konfirmoj se Qeveria e Republikës së Kosovës mund të vazhdojë dhe do të vazhdojë, do të vazhdojë të jetë krejtësisht siç ka qenë deri më tani transparente, duke respektuar të gjitha dispozitat kushtetuese dhe ligjore, si dhe projektin e autostradës, po ashtu për të gjitha projekt tjera kapitale të cilat janë në shërbim të zhvillimit të përgjithshëm të Republikës së Kosovës dhe të përmirësimit të jetës së qytetarëve tanë.

Dhe, në fund, gjithashtu më lejoni të theksoj se ky nuk është projekti personal i Hashim Thaçit, ky është një projekt që ka filluar në mandatin e kaluar, kur kemi qenë në koalicion qeveritar, do të thotë Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe partitë tjera. Tash është një koalicion tjetër, që gjithashtu vazhdon dhe unë besoj që çfarëdo qeverie që mund të vjen në të ardhmen, duhet të vazhdohet me ndërtimin e autostradave. Ndërsa, gjithashtu, për kundërshtuesit e ndërtimit të autostradës Morinë – Merdar, autostradës “Ibrahim Rugova”, unë kam një ngushëllim për ju, sepse në ditët e ardhshme do të shpallim shprehjen e interesit për ndërtimin e autostradës tjetër Prishtinë – Shtimje – Lipjan - Ferizaj – Kaçanik – Hani i Elezit, kështu që përgatitni kërkesën tjetër për interpelancë tjetër dhe jam i gatshëm të përgjigjem edhe për fillimin, për shprehjen e interesit të ndërtimit të kësaj autostrade.

Ndërsa, lirisht mund të kërkonti interpelancë edhe sa iu përket çështjeve tjera, që po bëni zhurmë politike, edhe që po na fajësoni për rritjen e pagave për gjithë punëtorët kosovarë, edhe sa i përket dialogut mes shtetit të Kosovës me Serbinë, ta diskutojmë platformën të cilën e kemi këtu. Gjithashtu, edhe për të gjitha çështje të tjera që ju mendoni që mund të diskutojmë, janë të nevojshme të diskutohen, por të diskutohen me argumente dhe jo me zhurmë, urrejtje, mllef apo me gjuhën e urrejtjes dhe të kërcënimit që e keni instaluar në parlament dhe të dhunës së distancuar nga qytetarët e Republikës së Kosovës, që po instaloni në rrugët e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare.

Sot po fillojmë nga Grupi Parlamentar “6+”, nuk e donë fjalën.

Grupi Parlamentar i SLS-së, nuk e donë fjalën.

Kalojmë te Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Interpelanca e ngritur për çështjen e autostradës “Ibrahim Rugova” dhe një debat i mirëfillt për projekte madhore është i mirëseardhur në demokracinë parlamentare.

Çështja e autostradës si projekt ka filluar në mandatin e kaluar dhe mund të themi se nuk jemi kundër ndërtimit të autostradës, kur dihet se autostrada është një aset i cili i ndihmon zhvillimit ekonomikë. Mirëpo, çështja e transparencës së projektit të autostradës dhe debati për autostradën është i mirëfilltë në Kuvendin e Kosovës, duke marrë parasysh se Kuvendi është përfaqësuesi i gjithë qytetarëve të Kosovës.

Dhe, çka do të zhvillohen proceset në këtë projekt madhor edhe në të ardhmen, është e mirë që të debatohet në Kuvendin e Kosovës dhe çështja e financimit të saj të jetë pjesë e këtij debati në Kuvend të Kosovës për arsye se projekti për autostradën ndërtohet me paratë e buxhetit të Kosovës. ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AAK-së, fjalën e ka deputeti Blerim Shala.

BLERIM SHALA: I nderuar kryetar,

I nderuar kabinet qeverisës,

Kolegë deputetë,

Në fillim, po ju them që gati të gjitha ato çfarë unë do t'i shpreh këtu në fjalën time, janë në fakt qëndrime, raporte zyrtare të Qeverisë së Kosovës, raporte të Fondit Monetar Ndërkombëtar, të Bankës Botërore, pjesë përbërëse të Marrëveshjes stand-by midis Qeverisë së Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Pika e parë, apo çështja e parë, nuk ka autostradë Vërmicë – Merdar, nuk ekziston autostrada Vërmicë - Merdar. Secili që e ka parë kontratën e nënshkruar midis Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit dhe konzorciumit Bechtel & Enka, do ta shohë, do ta kuptojë që kontrata vlen për vijën Vërmicë – Prishtinë e jo Vërmicë – Merdar. Ekziston projekti i autostradës, por nuk ekziston kontrata e cila e specifikon deri në detale rrugën Vërmicë – Merdar. Po them, kjo është çështje apo referim zyrtar, nuk është qëndrim imi personal, as vlerësim imi personal.

Nën dy, tema e madhe e cila është trajtuar shpeshherë prej nesh edhe këtu në Kuvend, edhe në opinionin publik ka të bëjë me çmimin e autostradës, ka pasur gati një lloj licitacioni për çmimin e autostradës, ndërsa çmimi i autostradës mund të gjendet prej të gjithë neve, kolegë të nderuar, në faqen 25 të Marrëveshjes stand-by midis Qeverisë së Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, të nënshkruar në korrikun e vitit të kaluar. Sipas kësaj marrëveshjeje dhe sipas fjalëve, raporteve të Qeverisë së Kosovës, autostrada Prishtinë – Vërmicë, gjegjësisht më falini, Vërmicë – Prishtinë, do të kushtojë 1 miliard e 4 milionë euro. Pra, mund ta shihni në faqen 25 të Marrëveshjes stand-by të nënshkruar prej Qeverisë së Kosovës.

Nën tre, në stand-by aranzhmanin e Qeverisë së Kosovës me FMN-në, vetë Qeveria e Kosovës, jo ne, jo deputetët, jo opinionin kosovar, flet, thekson që për shkak edhe të ndërtimit të autostradës do të ndodhë apo veç ka ndodhur përkeqësimi i madh i stabilitetit financiar të Kosovës. Pra, kemi të bëjmë me raportin e Qeverisë së Kosovës, jo me qëndrimet tona. Çka mund të flitet tash kur stand-by aranzhman më nuk ka.

Nën katër, sipas vlerësimeve ndërkombëtare të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore, të cilat janë shumë mirë të njohura për Qeverinë e Kosovës, nëse jo për opinionin, Qeveria e Kosovës dhe Kosova me veprimet e saja rreth stand-by arrazmanit ka rrezikuar, nuk po them ka humbur, po ka rrezikuar përkrahjen ndërkombëtare në vlerë prej 283 milionë euro.

Nën pesë, Projektet e tilla kapitale realizohen në forma të tjera, këtë e pranoi edhe kryeministri pak më parë, e jo me paratë që merren nga buxheti i Kosovës. Rëndomë realizohen me kredi të buta, rëndomë realizohen me përkrahje financiare të instancave më të rëndësishme ndërkombëtare e shumë rrallë apo gati kurrë nuk realizohen duke marrë nga kuleta e shtetit apo duke marrë nga buxheti i shtetit.

Në këtë segment jemi të sigurt që nuk kanë pasur vendimmarrje të duhur dhe transparente se në ç'mënyrë duhet të ndërtohet autostrada në fjalë, për të cilën gjithmonë qysh nga vitet '90, qysh nga koha kur presidenti Rugova i ndjerë e shpalli këtë interes, ka qenë interes i gjithë Kosovës dhe i gjithë kombit.

Analiza serioze se çfarë duhet bërë sa i përket akseve kryesore rrugore dhe autostradave, megjithatë ka pasur dhe referim në këtë analizë mund të gjendet në dokumentin e Bankës Botërore, të datës 30 mars të vitit 2008. të gjitha këto analiza, studime të fizibilitetit, ju lutem, janë financuar nga fondet e Qeverisë së Kosovës, prapë po i referohem raporteve të Qeverisë së Kosovës, jo të dikujt në opozitë apo të opinionit të Kosovës. Sipas këtij studimi të fizibilitetit, që është kryer në vitin 2006, e të cilit i referohet Banka Botërore në raportin e 28 marsit të vitit 2008, theksohet në mënyrë të prerë që rrugët 6 dhe 7, për të cilat edhe sot me gjasë do të diskutojmë, “rruga e kombit” si po i thonë dhe rruga në drejtim të Shkupit duhet të ndërtohen në atë mënyrë që të kombinohet pjesë të autostradës me pjesë të zgjerimit të rrugës. Çmimi i kësaj rruge Vërmicë – Merdar në atë rast, sipas studimit të fizibilitetit të urdhëruar nga Qeveria e Kosovës, do të ishte 308 milionë euro, ndërsa e rrugës Prishtinë – Shkup do të ishte 151 milionë euro. Këto janë pra të dhëna, fakte, vlerësime që dalin prej Qeverisë së Kosovës, prej Fondit Monetar Ndërkombëtar, prej Bankës Botërore, prej punës që kanë bërë pra zyrtarët më të lartë të Kosovës. Po ne sot, si shoqëri, si skenë politike, si ekonomi kemi ardhur dhe jemi bërë pengje të kësaj autostrate me mënyrën se si po i qasemi, me mënyrën se si kemi filluar ndërtimin e saj, se si kemi marrë vendime për ndërtimin e saj, se si po merremi me te dhe kam dronë që një autostradë me nam, e cila është quajtur “autostradë e kombit”, po shndërrohet në një rrugë qorre politike dhe ekonomike për Kosovën. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kryesisë, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, Glauk Konjufca, deputeti Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Këtu desha ta shpjegoj një manipulim propagandistik të Qeverisë, kur kemi të bëjmë me debatin lidhur me kontratën në mes shtetit të Kosovës dhe kompanisë Bechtel & Enka për ndërtimin e autostradës.

Lëvizja “Vetëvendosje e thekson shumë qartë, jo vetëm ne, por asnjë shqiptarë që e do kombin e vet nuk mund të jetë kundër ndërtimit të një auto-udhe që e lidhë Kosovën me Shqipërinë. Ajo me çka kemi ne problem, nuk është autostrada, po kontrata. Nuk ma merr mendja që kryeministri Thaçi të jetë aq i trashë, sa të mos e di dallimin. Çështja është se ai dallimin e di shumë mirë, por i merr për gjëra të njëjta autostradën dhe kontratën pikërisht për ta mundësuar propagandën e tij tipike, e cila thotë: Kush është kundër kontratës me Bechtel & Enkën, qenka kundër kombit!

Kur është fjala për merita kolektive, kryeministri thotë vazhdimisht - e bëra unë, kurse kur vjen puna e manipulimeve personale, kryeministri i mbështjellë bëmat e tij me konceptin e madh të kombit. E kjo do të thotë ta kesh kombin për fasadë, për ta mbuluar korrupsionin. Na ruajt zoti nga politikanët, që në dorën e djathtë e mbajnë flamurin e kombit, e në të majtën flamurin e korrupsionit!

Por kjo nuk paraqet asgjë të re në historinë e njerëzimit, për sa kohë që ne e dimë se të këqijat më të mëdha në këtë botë janë bërë gjithmonë në emër të së mirës. Bibe, bile kryeministri nuk ka të drejtë shumë të flas edhe për kombin. Si mund të flet për kombin ai që e ka hequr flamurin e kombit, himnin e kombit, që e ka çarmatosur ushtrinë e kombit dhe na ka sjellë një kushtetutë pa komb. Kaq sa i përket propagandës qeveritare, e tash duhet të dalim në temë, sepse nuk mund të dalësh në temë pa e shpjeguar propagandën qeveritare.

Sa i përket kontratës, ne dyshojmë dhe këto dyshime normalisht që i mbështesin fakte, se kontrata e lidhur për autostradën në fjalë e mbingarkon financiarisht në mënyrë krejt të paarsyeshme shtetin e Kosovës. Ne mendojmë se kontrata me Bechtel & Enka po ashtu është shumë e njëanshme. Kosova i merr mbi supet të gjitha dështimet e kompanisë, kurse Bechtel & Enka i merr të gjitha përfitimet e mundshme, disa prej të cilave janë vërtetë astronomike.

Kontrata e Qeverisë së Kosovës me Bechtel & Enka i ngjanë vërtet një marrëveshje të paqes midis dy ushtrive, ku njëra prej tyre ka kapitulluar dhe i pranon të gjitha kushtet e nënshtrimit. Natyrisht që kjo ushtria që ka kapitulluar në këtë kontratë është Qeveria e Kosovës. Unë nuk e di se çfarë lufte kemi humbur, që të nënshkruajmë kontrata kapitulluese. Është e qartë se Kosova nuk ka humbur kurrfarë lufte, por ndonjëri nga qeveritarët ndoshta e ka humbur ndonjë betejë dhe tash për hir që të mbetet në pushtet, u dashka që çmimin ta paguaj edhe Kosova.

Për këtë arsye, ne themi se kontrata me Bechtel & Enka është thjeshtë e pafavorshme, ky është thelbi i diskutimit tonë. Mendoj që këtu duhet ta reduktojmë diskutimin edhe të mos merremi me propagandë.

Një kontratë e tillë do të mund të nxirrej nga çdo i nënshtruar dhe çështja është si të balancohet drejtë përfitimi i Kosovës me atë të kompanisë. Ta duash kombin dhe të merresh në emër të kombit, nuk do të thotë t'i shpenzosh paratë e kombit në mënyrë të paarsyeshme. Ajo që i duhet kombit, është zhvillimi ekonomik dhe kjo gjë nuk bëhet

duke e fokusuar gati krejt buxhetin e shtetit në asfalt, dhe jo rastësisht pikërisht aty ku tenderët shkojnë me përqindje, mbikëqyrjet e cilësisë mungojnë dhe manipulimet janë më të mundshme.

Zhvillimi arrihet kur drejtpeshohet investimi në kapitalin njerëzor, prodhimi vendorë dhe efikasiteti i shfrytëzimit të resurseve për hir të së mirës së përgjithshme.

Qeveria e cila zhvillimin e ka reduktuar në asfalt, në fakt, me bilancin aktual negativ tregtar po iu shtron udhë prodhimeve të huaja, të cilat edhe më lehtë tash do të mund ta përshkojnë edhe Shqipërinë.

I bëjmë thirrje Qeverisë që të mos e keqpërdor kombin, por t'i japë llogari kombit për veprimet e veta të dëmshme.

E sa iu përket dy konstatimeve të fundit të kryeministrit, se po dëmtohen investitorët duke mbajtur kësi interpelancash të tilla, për hir të transparencës, ne themi se raportet ndërkombëtare po e rendisin Kosovën në vendin e fundit sa i përket biznesit, jo për shkak që ka transparencë, po pikërisht pse Qeveria është jo transparente dhe partner jo serioz, që në të shumtën e rasteve nuk krijon as lehtësime infrastrukturore, e shpeshherë madje krijon ngarkesa, sepse ndonjëherë e kërkon edhe hisen e vet të përfitimeve të paligjshme.

Sa i përket transparencës, po ashtu, keni thënë se kontratën mund ta marrë çdo kush. Në fakt, ne e dimë që dy organizata joqeveritare, që është organizata joqeveritar GAP dhe Lëvizja “Fol”, sidomos kjo e fundit e ka dërguar Qeverinë në gjykatë për arsye se nuk ka mund ta marrë kontratën të cilën ju keni thanë se mund ta marrë gjithkush. Kështu është edhe me negociatat me Serbinë, të cilat i përmendët, sepse për sa kohë që thatë - kemi strategji dhe kemi platformë, ne nuk e kemi marrë këtë platformë ende në Kuvend dhe kështu ka deklaruar madje edhe kryetari i Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Kryeministri e ka fjalën, për replikë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryesues Haliti!

Unë dëshiroj vetëm të sqaroj se korridori është Morinë - Merdar, kontrata është në seksione për të mbajtur buxhetin në kontroll, duke dhënë prioritete të seksioneve.

Tash dëshiroj të theksoj, pasi që e përziat politikën me këtë projekt infrastrukturor, do të thotë përsëri kaloi në beteja politike, zgjedhjet janë larg.

Ju keni kërkuar sot që Kuvendi i Kosovës të votojë për ndërprerjen e punimeve të autostradës. Kjo është nonsens dhe në fund keni për ta parë, keni për të mbetur të vetmuar edhe prej gjithë deputetëve, por edhe të distancuar prej qytetarëve.

U tha se kjo është rrugë qorre për Kosovën. Unë e theksoj - kjo është rruga e shpresës, e optimizmit e besimit, e ndërtimit, e zhvillimit, e integritetit kombëtar dhe euroatlantik.

Ju morët hov fillimisht kundër autostradës, e kthyet menjëherë në betejë të urrejtjes personale ndaj kryeministrit dhe Qeverisë dhe kaluat te flamujt shtetërorë kombëtarë, kaluat në Ramboje, në Vjenë, te pavarësia e të tjera e të tjera.

Kemi dallim sa i përket flamurit kombëtar. Natyrisht, unë jam për kultivimin, respektimin e flamurit kombëtar pa yll, ndërsa ju me yll në ballë. Unë respektoj institucionet dhe simbolet shtetërore, ndërsa ju i digjni flamujt kombëtarë, jeni të vetmit që njoh dhe që njeh kjo politikë që djegin flamurin e shtetit të vet, jeni ju 7 a 8 aty.

Kërkoni interpelancë edhe për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanovc, ju tregoj edhe për atë çështje, se e njoh para juve, bile e njoh shumë mirë, edhe ju e dini se e njoh.

Atë deficit të kaluarës nuk mund ta plotësoni tash, të jeni të bindur, edhe për shqiptarët në Maqedoni, por edhe për shqiptarët në Mal të Zi, që i keni harruar, do prej jush i njihni kështu, në kuptimin e prejardhjes familjare. Pra, hap interpelancë kur të keni qejf, diskutojmë për kauzën shqiptare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që në fillim, për të hequr edhe dyshimet nëse diku ekzistojnë, të them atë se për qytetarët e Kosovës, Lidhjen Demokratike të Kosovës, shtetin e Kosovës, është nder i veçantë që kjo autostradë mban emrin e ideatorit të saj, njeriut të madh të Kosovës, presidentit historik, Ibrahim Rugova.

LDK konsideron se ky projekt është i një rëndësie të veçantë nacionale dhe më gjer, padyshim që rëndësinë e ka të shumanshme, është projekt i nevojshëm, për këtë nuk e kemi asnjë dilemë.

Të nderuar deputetë,

Ky projekt madhor për Kosovën dhe më gjer filloi të shndërrohet, megjithatë, në një projekt të mistershëm, sekret për shumëçka. Po i them disa nga arsyet.

Edhe më herët Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Grupi Parlamentar ka shfaqur shqetësimin e vet për rrjedhën e realizimit të këtij projekti. Në vazhdim, po i themi disa çështje më shqetësuese për ne dhe qytetarët tanë, jo për nevojën që Kosova ta ketë autostradën "Ibrahim Rugova", por për mënyrën e realizimit të saj, mënyrën e shpenzimit të parave të qytetarëve tanë.

Dëshiroj t'ju rikujtoj se edhe më herët Ministria e Transportit ka nënshkruar një kontratë me kompaninë BPI CONSUL GMBH, qershor 2004, një historik për ata që nuk e dinë, unë besoj se Qeveria këtë e di, për realizimin e shërbimeve inxhinierike për projektimin e autostradës Morinë-Merdar dhe kompania në fjalë ka përfunduar projektin dhe e ka dorëzuar atë më 17 tetor 2005.

Ajo që për ne si deputetë dhe për qytetarët është e rëndësishme, sepse këto nuk i dimë më vonë, ka përbërë, mes tjerash: përshkrimin e projektit, objektivat e trafikut, qëllimet regjionale të planifikimit, pozita e rrjetit rrugor, rëndësia dhe në planifikimin regjional: nyejt rrugore, përshkrimin gjeneral të studimit, projektimit, optimalizimi, studimi i fizibilitetit të kryer dhe të përfunduar në dhjetor, saktësisht më 25 dhjetor 2006, nga kompania daneze KOV.

Është kështu apo jo, le të tregojnë qeveritarët, faza e projektimit, traseja, identifikimi i trasesë, legjislacioni, financimi e tjera. Këto janë disa nga pjesët dhe çështjet që kanë të bëjnë me projektin e autostradës, po flas të miratuar më herët. Pyes-Kush prej nesh i ka ditur ose i di këto përmbajtje për të shkuar tutje drejt shtrimit të çështjeve dhe dilemave tjera, që kanë të bëjnë me atë se, cili është tani projekti i vërtetë, ky i miratuar më herët, apo një tjetër? Kuptohet se kemi ndërrim të këtij, të atij projekti, në mos për asgjë tjetër, me ndërrimin e një pjese të trasesë, që edhe sot e konsiderojmë veprim jologjor të Qeverisë dhe besojmë në ndryshimin e çmimit.

Nëse s' është kështu, duhet të na thuhet e kundërta, transparenca. Ky projekt ka qenë dhe mbetet jo transparent ose thënë ndryshe, ky projekt dhe transparenca nuk kanë asgjë të përbashkët. Projektin definitiv, me dhe pa ndryshim të trasesë, së paku këtu në Kuvend, ne nuk e kemi parë as nuk është votuar.

Vonesa në për zgjedhjen e kompanisë për ndërtimin e autostradës, dihet ajo është bërë në janar të vitit 2010. Kontrata e panjohur për opinionin publik, kushtet e saj, çmimi. Edhe sot kur thuhet nga zoti kryeministër para disa kohe që kushton 700 milionë euro, nuk e besojmë që kushton aq.

Nëse çmimi mesatar është 7.5 milionë, po spekuloj, e duhet e kundërta të thuhet nga ata që janë përgjegjës, ose 8 milionë për një kilometër të autostradës, atëherë është një matematikë e thjeshtë se me këto para nuk mund t'i kryejmë as 100 kilometra, që ka diku 117 kilometra, sepse është thënë se ajo kushton diku 700 milionë euro, është apo nuk është i saktë ky çmim, zoti kryeministër? Kur kësaj i shtohet fakti se është thënë edhe më herët që kursehen me ndryshim të trasesë, 300 milionë euro, na bie vërtet ta kemi një autostradë shumë lirë, gjë që është në sferën e dëshirës.

Çfarë pune dhe cili është efekti i punës së kompanisë konsulente të quajtur EMI MTM, për çka janë paguar, sa kemi informata, mbi 5 milionë e 500 mijë euro. Pyesim zyrtarët, a është kjo e saktë dhe cili është efekti i atij konsultimi? Ne nuk dyshojmë që nuk është bërë puna mirë, por cilën punë, ne nuk e dimë, duhet të na tregoni ju, ku janë analizat, ku janë publikuar dhe a ka mundësi t'i shohim ato?

Përzgjedhja e konzorciumit

Konzorciumi Bechtel& Enka kishte kërkuar fillimisht 600 milionë euro, për sa ne dimë, për ndërtimin e autostradës nëpër trasenë e miratuar në bazë të studimit. Çka ndodhë në ndërkohë? Thuhet se konzorciumi ka konkurruar me dy propozime, i dyti që parasheh ndryshimin e trasesë në një pjesë të autostradës. Në bazë të asaj që ne kemi

informacione dhe dimë, kompania nuk guxon të dalë me propozime për devijim të trasesë pasi është shpallur fitues. Ajo është shpallur fitues për trasenë e miratuar, të cilën e ka shumë të qartë në studim.

Qeveria nuk duhet dhe nuk guxon të marrë në shqyrtim propozimet për devijime të trasesë, pasi me këto punë janë të specializuara kompanitë e konsultingut dhe jo kompanitë ndërtimore. Bechtel & Enka, sa e dimë ne, është punë kryerës, por jo edhe projektues i autostradës.

Propozimi i Bechtel&Enkës për devijim të trasesë ngjallë dyshime rreth punës konsulente të kompanisë që e thashë më herët dhe hedh poshtë qëndrimet zyrtare se kjo firmë është përzgjedhur dhe paguar për konsulencë rreth autostradës. Kompania është e obliguar dhe e detyruar të ndërtojë vetëm atë rrugë që ia përcakton ofruesi i projektit, investitori.

Përveç shkeljes së ligjit, mosrespektimit të Kuvendit, si organ më i lartë ligjdhënës dhe vendimmarrës dhe për projektet e tilla madhore, devijimi i trasesë nuk mund të dëshmohej as nga aspekti i përfitimeve ekonomike. E para kalon nëpër pjesë rurale, larg qyteteve, pjesa që ka të bëjë me devijim, veçmas.

Në ato pjesë, sa jemi ne në njohuri, nuk është planifikuar asnjë investim kapital, që do të arsyetonte së paku një pjesë të asaj traseje të devijuar. Traseja e devijuar dëmton rënd, veçmas planifikimet e bëra për investime milionëshe, për shembull në komunën e Lipjanit, por mbi të gjitha nuk ka kaluar as projekti e as ndryshimi i trasesë nëpërmjet Kuvendit të Kosovës, sepse nuk kemi të bëjmë me ndërtimin e një rruge të parëndësishme, të shkurtër, rrugicë, por për një projekt kapital.

Kontrata, si pjesë e veçantë edhe e rëndësishme, sigurisht e vet projektit, është si kapitull në vete, mënyra e lidhjes së saj, kushtet në të cilat është lidhur, transparenca rreth saj, sa është e favorshme e tjera? Po i përmend vetëm disa çështje rreth asaj, nëse janë të sakta apo jo nga ajo që ne jemi të informuar, kuptohet, jo nga ata që do të duhej të informoheshim, siç është Qeveria.

E pyes zotin kryeministër, se a është e vërtetë se Bechtel& Enka vetëm për transportimin e teknikës së punës ka marrë 40 milionë dhe për mirëmbajtjen e tyre merr nga 1 milion euro në vit, a është kjo e paraparë në kontratë?

A është llogaritur çmimi i ndërtimit në total, apo sipas njësive e kjo mund t'i bie se kompania merr para në bazë të punës ditore, është apo nuk është e vërtetë kjo?

A është e vërtetë se Bechtel& Enka mund të angazhojë kompani tjera, por që pagesa bëhet drejtpërdrejt nga Qeveria, kurse Bechtel&Enka merr provizion 8% për këtë?

A është e vërtetë se në tender ka qenë e paraparë që kompanitë që tenderojnë, të ofrojnë edhe dizajnin e rrugës dhe koston, e që sipas informatave tona, kompania fituese këtë nuk e ka pasur. Nëse e kemi gabim, ju duhet të na thoni këtë, sepse edhe nëse nuk ia

qëllojmë, përsëri e përsëris, për të satën herë, faji është i juaji. A është e vërtetë se çmimet në kontratë vlejnë vetëm për 3 vjet, por nëse projekti zgjat, çmimet u përsërit edhe këtu, do të rriten për 12%?

Financimi, konsiderojmë i vet autostradës është i paqëndrueshëm, i pasigurt, apo duhet të shesim çdo gjë që është pasuri e vlefshme, në mënyrë që ta kryejmë këtë autostradë. Kur kësaj i shtojmë edhe keqësimin serioz të raporteve tona me institucionet ndërkombëtare, veçmas si FMN-ja, pastaj raportet e fundit që flasin për Kosovën, si vend të pasigurt për investime, atëherë kush do të na besojë e të na jap, qoftë edhe një euro për projektet tona?

Të nderuar kolegë deputetë,

Mungesa e organit kompetent për mbikëqyrjen e punimeve, është një shkelje serioze. Organet e tilla formohen, zgjedhën edhe për projekte shumë të vogla e lere më për një projekt si ky i autostradës. Këtu nuk ka absolutisht justifikim dhe këtu duhet të ketë përgjegjësi. Kush deri sot ka mbikëqyrur cilësinë e punimeve, kush kujt i jep llogari për këtë, kush i paguan lëshimet e bëra eventuale në cilësi? Ne e dimë që në ndërkohë është zgjedhur organi mbikëqyrës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, thekson edhe një herë se ndërtimi i autostradës “Ibrahim Rugova”, vazhdon të realizohet me shumë të panjohura, dilema, dyshime, vazhdon të jetë projekt jotransparent. Me një qasje të tillë, me mungesë përgjegjësie të Qeverisë të Kosovës, ne do të vazhdojmë edhe më tej të thellojmë hendekun mes qytetarëve dhe pushtetit, ikjen e përgjegjësisë dhe kryerjen e obligimeve të llogaridhënies të Qeverisë, atij që duhet t’i japë llogari, Kuvendit të Kosovës, organ që ky e ka zgjedhur. Me këtë Qeveria vazhdon të japë shembullin më të keq të mosrespektimit të ligjit, obligimeve dhe përgjegjësisë kushtetuese, shpenzimin e parave të taksapaguesve tanë në mënyrë të pakontrolluar.

Vazhdojmë t’u tregojmë partnerët tanë se ne nuk po mund apo nuk po dëshirojmë të qeverisim ashtu siç duhet, vazhdojmë t’i largojmë edhe ata pak investitorë, donatorë të mundshëm, sepse po ua japim shembullin e keq të qeverisurisë se kjo vërtet po na tregojnë, thashë pak më herët, po e përsëris edhe raportet e para dy ditëve të tri organizatave, gjegjësisht institucioneve prestigjioze ndërkombëtare. Ata që më së shumti do të përfitonin që kjo mënyrë e qeverisjes të ndalet, janë qytetarët e Kosovës, e ata që më së shumti do të përfitojnë me vazhdimin e kësaj mënyre të qeverisjes, janë qeveritarët dhe bashkëpunëtorët e tyre. E përsëris, atë që e thash në fillim, që Grupi Parlamentar i LDK-së, e përkrah projektin e tillë si të një rëndësie të veçantë, ka qenë në një mënyrë apo tjetër iniciator dhe pjesë e këtij projekti, por që kërkojmë transparencë, heqjen e të gjitha ndryshimeve dhe dilemave që mund të ketë rreth këtij projekti madhor. Faleminderit!

KRYESUESI: Kryeministri e ka fjalën, zoti Thaçi!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, Ismet, gjithashtu për diskutimin tuaj.

Unë kam përshtypjen, ose nuk jeni fare i informuar personalisht rreth kësaj çështjeje, ose ai që ta ka përgatitur fjalimin, nuk është fare i informuar.

Nën një, Parlamenti i Kosovës, po s' është marre edhe për ta ndihmuar përgatitjen e fjalimit se je shef i Grupit Parlamentar dhe, natyrisht të duhen konsulta, këshilla, rekomandime, edhe kryeministri, ministrat, deputetët marrin këshilla, kështu që ajo është vlerë, jo fyerje. Po tash, ose nuk je i informuar mirë, ose ai që ta ka shkruar, ta ka shkruar komplet gabimisht.

Parlamenti i Republikës së Kosovës, kurrë nuk ka marrë vendim për ndërtim ose mos ndërtim të kësaj autostrade. Llafe janë bërë kohë të gjatë për ndërtimin e kësaj autostrade. Kur ka filluar, si ka filluar, ju e dini shumë mirë, natyrisht se unë do t'ju informoj zoti Ismet, në çështjet që ju ngritët, më shumë keqinterpretuese dhe dezinformuese se sa parimore?

Unë do t'ju informoj, por do të ishte edhe shumë më rëndësi që të informoheni edhe nga bashkëpartiakët tuaj për çështje të caktuara edhe nga ish-presidenti Sejdiu, me të cilin kemi inauguruar së bashku, fillimin e punimeve edhe nga ish-ministrat e partisë suaj që kanë qenë në Qeveri, së bashku me mua, e në ceremoni kemi qenë të gjithë së bashku.

Nuk po bëni dallimin në mes çështjeve legale, ligjore dhe mlllefeve politike. Nga kjo që po dëgjoher ndonjëherë aty-këtu, do të thotë ky është mëkati, ndërtimi i autostradës Vërmicë-Prishtinë, apo korridorit në drejtim të Merdarit, është mëkati më i madh që po i ndodh Kosovës. Ky dallimi ynë, ju e shihni mëkat, ne e shohim mrekulli dhe e kuptojmë që po i ndodh mrekullia vendit. Devijimi i ndërtimit të autostradës, është vendim i Qeverisë, të cilin e ka marrë Qeveria e Republikës së Kosovës, me një qëllim të vetëm, kursimin e mbi 300 milionë eurove, natyrisht se do të kemi 7-8 minuta më tepër kohë për të kaluar në këtë rrugë. Ndërsa, ne nuk mund të ndërtojmë autostrada nëpër çdo fshat, por ndërtimi i autostradës, e përmenda, prej Prishtinës në drejtim të Shtimes, Lipjanit, Ferizajt, Kaçanikut, Hanit të Elezit, do të kalojë në atë pjesë. Pra, devijimi është si rezultat i kursimeve që do të ndodhin mbi 300 milionë eurove dhe do të kemi 7-8 minuta më tepër udhëtim.

Sa i përket raporteve me Fondin Monetar Ndërkombëtar, disa deklarime janë trillime dhe dezinformime. Kosova ka raporte të mira me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe ka ridizajnuar agjendën dhe programin e saj. Mua, më vjen mirë kur dëgjoj se jeni aq të disiplinuar në raport me Fondin Monetar Ndërkombëtar, nga pozicioni opozitar aty-këtu, por edhe ju e dini se nuk është bash krejt ashtu. Natyrisht, dallimi është se dhe duhet për ta bërë atë dallim, ne nuk jetojmë më në autoritetin e UNMIK-ut, jemi vend sovran dhe kemi edhe politikat tona. Duhet të dëgjoher dhe të respektoher edhe zëri ynë, i politikave tona qeveritare dhe debate me Fondin Monetar Ndërkombëtar bëjnë, prej Qeverisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të gjitha vendeve më të zhvilluara të Bashkimit Evropian, por edhe Kosova dhe vendet e tjera të rajonit, ju e shini kanë debate, bile goxha të avancuara në kuptimin e ballafaqimeve të ideve. Por, Kosova do të vazhdojë të jetë në agjendë të përbashkët me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe nuk

është jashtë programi. Ai që thotë se Kosova është jashtë programi, gënjen. Kosova nuk i ka humbur 360 milionë euro, as edhe një cent nuk e ka humbur dhe urdhëroni, thirrreni një interpelancë, diskutojmë me argumente.

Unë ju siguroj dhe garantoj juve dhe të gjithë qytetarët e Kosovës, përsëri se nga rritja e pagave për të gjithë punëtorët kosovarë, Kosova nuk e ka humbur asnjë cent, as nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, as nga Komisioni Evropian, as nga Banka Botërore, prandaj, lë të jemi të qartë dhe të mos u japim konotacione politike çështjeve të rëndësishme.

Sa i përket raporteve të institucioneve ndërkombëtare, raporti i Bankës Botërore, ndërlihet drejtpërdrejt dhe ekskluzivisht me komunën e Prishtinës, e cila është shpallur si kryeqyteti apo komuna me klimën më të keqe të zhvillimit të biznesit në Evropë e me gjer, sepse biznesi është koncentruar në 3 apo 5 veta dhe nuk i takon komunitetit të biznesit. Kemi monopol dhe jo konkurrencë. Prandaj, kërkojeni përgjigjen në Kuvendin Komunal të Prishtinës, ku e kalon pjesën më të madhe të kohës edhe ju, fizikisht, zoti Ismet.

KRYESUESI: Replikë, zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti kryeministër, unë mendoj se ju po flisni me mllef, në asnjë mënyrë unë nuk kam folur me mllef. Unë i kam thënë ato që i mendon Grupi Parlamentar dhe ju hiqeni mllefin, sepse ju e keni atë, e para. E dyta, fjalimet ua përgatisin juve, se e keni shqyr një mori njerëzish, me vagonë, njerëz të ngarkuar, këshilltarë, është e drejtë e juaja, unë s' kam këshilltarë dhe i bëj vetë fjalimet, por fjalimin nuk mund ta bëj për qejf tuajin, zoti kryeministër.

Ajo që po ju them, pikërisht është problemi, se ky Kuvend nuk ka marrë vendim për Autostradë. Këtu është problemi dhe këtu nuk po dallohem, sepse po e vërtetoni atë që e thashë, e mendimi jonë është, se ky Kuvend është dashur të merret me një projekt madhor të tillë.

Sa i përket informacioneve, kemi më shumë se sa që juve ua merr mendja. Nuk ka nevojë unë të konsultoj askënd. Edhe në mandatin e kaluar, ne kemi pasur vërejtje edhe, pavarësisht kush me kënd ka qenë në koalicion, prandaj mos u thirrni në njerëz që vetëm sa dëshironi t'i arsyetoni disa gjëra, dallimi në mes çështjeve ligjore dhe mllefeve. Edhe një herë po e përsëris, unë i kam shtruar qeshtjet edhe në formë të dilemave dhe ju nuk iu dhatë përgjigje asnjeres prej tyre dhe këtu s' ka të bëjë fare me mllef.

Ju duhet ta kuptoni se këtu jeni në Parlament dhe këtu e keni edhe opozitën. Kur e mbani mbledhjen e Grupit tuaj Parlamentar, këta ta bëjnë qejfin, flisni qysh të keni qejf, është problem i juaji, por këtu jemi, parti të ndryshme, prandaj dalloni këto gjëra, unë e di që i dalloni, por ju po bëni politikë, sigurisht që po bëni edhe në Parlament, politikë.

Nuk është e vërtetë se ne jemi kunder autostrades, dy herë e përmenda ,se e kam ditur ose e kam paragjykuar se ju do të reagoni në stilin e asaj që e thoni, edhe më herët e keni thënë, se ne jemi kundër. Prandaj, dy herë, në fillim të fjalimit edhe në fund e thashë, ne nuk e llogarisim mëkat autostradën, siç e thatë ju tash, por ne e llogarisim si nevojë dhe si domosdo. Po ta përsëris edhe një herë...

KRYESUESI: Meqë flet në emër të Grupit Parlamentar, atëherë vazhdojani fjalën zotit Beqiri!

ISMET BEQIRI:... si duket, zoti kryeministër, në këtë pjesë, nuk më paske dëgjuar se ke qenë duke u mbushur mllef, me qenë se po ke dëshirë për ta përmendur. Pikërisht, devijimin e autostradës, unë e kuptoj dhe jam i informuar, nuk jam aq i pa informuar sa mendoni ju, e ka bërë Qeveria, por ne konsiderojmë se është veprim i paligjshëm, sepse e konsiderojmë edhe projekti edhe ndërrimi i trasesë, është dashur të votohet në Kuvend, ju thoni se nuk duhet, atëherë mbetet në tuajën, për shkak se ju e keni numrin këtu të deputetëve.

Unë FMN-n e përmenda kalimthi, dhe nuk ka të bëjë me trillime por me raporte , ajo që është publike e përsërita dhe e thashë vetëm kalimthi. Ndërkaq, gjithë opinionin po e sheh se, ju nuk po mund ta shndërroni Prishtinën si komunat e tjera që i menagjoni, të mos më keqkuptojnë kolegët, psh. Shtimja,e me rend duke iu hyrë të gjithave ato që i keni, sepse ju jeni një ndër ata që me asgjë s'po tregoni që qytetarët e Prishtinës duhet të ju përkrahin, as me ligjin për Prishtinën, ju e dini fort mirë, zoti kryeministër që e kemi kërkuar kete ligj, nuk është bërë asnjëherë, sepse ju mendoni votat t'i merrni në Prishtinë, duke e ngulfatur Prishtinën. E sa i përket se unë fizikisht po rrija më shumë në komunë, nuk kam dyshuar që jeni duke më përcjell, Qeveria. Faleminderit!.

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Mujota ka sqarime shtesë, në emër të Qeverisë.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Unë dua fillimisht të falënderoj Komisionin parlamentar për Mbikëqyrje Funksionale, që ka pasur një takim në Ministrinë e Infrastrukturës dhe ka pasur mundësi të informohet detalisht për gjithë historikun e ndërtimit të autostradës Morinë – Merdar dhe natyrisht dua të shpreh shqetësimin tim, pa dashur të spekuloj se dy grupe parlamentare që janë këtu, nuk kanë qenë prezent me përfaqësuesit e tyre dhe arsyet i dinë vetëm ata. Por, si do qoftë kjo është një histori e cila duhet treguar plotësisht ashtu siç është interesi i vendit, prandaj unë dua të tërheq vëmendjen në tri apo katër çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me kontratën dhe ndërtimet aktuale në autostradën Morinë – Merdar.

Përfitimet politike dhe strategjike tashmë janë vërtetuar dhe natyrisht se edhe ata që ishin më skeptikë në kuptimin e qëndrueshmërisë së përfitimeve për ndërtimin e autostradës, u

bindën me përfundimin e rrugës në segmentin që i takon Shqipërisë. Dhe, vazhdimi i kësaj rruge të kombit, ishte një vendim i drejtë, një vendim historik, një vendim i cili ka dëshmuar se Kosova po zhvillohet dhe po krijon parakushte për zhvillimin ekonomik, duke ndërtuar infrastrukturë rrugore të standardeve evropiane.

Plotësisht, Komiteti Ndërmator, me vendimet e veta, me analizat e veta, me punën që ka bërë atë kohë, ka ardhur në përfundim për të marrë një kontratë, e cila është më e dobishmja për Kosovën dhe natyrisht më e dobishmja deri më tani në praktikën e rajonit.

Ky është një projekt i cili është një shtyllë e rëndësishme e infrastrukturës së vendit dhe për të zhvilluar e për të përmirësuar ekonominë dhe jetën e qytetarëve të Kosovës, nuk do koment se nuk duhet kundërshtuar. Por, vëmendja, për të mos mbajtur fjalë tjera, të cilat tashmë janë shpalosur në Kuvend, është aty tek disa dilema që janë ngritur.

E para, duhet të siguroj që kompania mbikëqyrëse për autostradën është përzgjedhur, po presim afatet kohore ligjore për të nënshkruar kontratat, ndërsa çështjet e zvarritjes së përzgjedhjes së kontratës, ju të gjithë i dini, për mospasur në përzgjedhjen e saj dhe për vakumin institucional që ishte krijuar për një kohë dhe tashmë kjo periudhë është përmbyllur dhe brenda dhjetë ditësh do të jetë kontratë e nënshkruar për kompaninë mbikëqyrëse, që është një standard dhe kusht për punimet në autostradë.

E dyta, mbikëqyrja e autostradës ka ekzistuar gjithmonë, nga fillimi i punimeve përmes menaxherëve, përmes inxhinierëve, ekspertëve të Ministrisë për 24 orë në ditë, prandaj, për çështjen e mbikëqyrjes dhe zgjidhjes së problemit për mbikëqyrjen e autostradës, tashmë kjo histori është mbyllur.

Më lejoni të përmend edhe disa prej fakteve të cilat ndihmojnë që Kuvendi të ketë një korrektësi në raport me diskutimin që bën për autostradë. Nga viti 2003 deri në vitin 2007, sigurisht qëndrojnë ato që janë zhvilluar disa aktivitete të cilat i përmendi deputeti Beqiri dhe ka pasur një hartim të projektit zbatues për autostradën Morinë-Merdar, dy kontratat dhe studimi i fizibilitetit me ndikimin e ambientit, që ka nënkuptuar Kompaninë BPI Consultig nga Gjermania dhe nuk është përmbyllur kjo kontratë. Arsyeja, kjo kontratë ka qenë, ose ky projekt ka qenë parcial, vetëm në masën 20%, prandaj këto janë arsyet të cilat tregojnë se projekti ka pasur një rrugë tjetër dhe një jetë tjetër në vazhdimësi.

Pastaj kur Qeveria e Kosovës ka shpallur korridorin Morinë – Merdar, zonë me interes të përgjithshëm, dhe natyrisht se ka qenë një vendim i drejtë, një vendim të cilin duhet ta përkrahin të gjithë deputetët dhe të gjithë qytetarët e Kosovës, sepse puna në praktikë tregon se tashmë punët kanë ecur mirë.

Sa i takon transparencës, nuk di se si ka mund të jetë një proces kaq i rëndësishëm i një kontraktimi shtetëror me një kompani, me një konzorcium të fuqishëm ndërkombëtar, më transparent, përveç asaj që përcakton ligji dhe rregullat e një kontrate të tillë. Procesi i tenderimit ka filluar me shpalljen e shprehjes së interesit dhe është botuar në mediat më të mëdha në botë, që nënkupton se ka pasur një qasje edhe ndërkombëtare. Vlerësimi i

ofertave nga Komiteti drejtues ndërministror dhe kompanitë këshilluese, kanë përpiluar listën e ngushtë prej 7 kompanive dhe natyrisht është përzgjedhur kompania që ka ofruar kushte më të mira, më të favorshme për Kosovën dhe kushtet më të zbatueshme në praktikë, sepse vërtet kompania Bechtel&Enka bën punë që tregon se do ta realizojë projektin dhe është mirë që Komiteti Ndërministror, atëherë ka marrë këtë vendim, sepse po të bënte ndryshe, ndoshta do të vendosej në pikëpyetje edhe realizimi në praktikë i autostradës.

Benefitet ose përfitimet nga kjo janë të mëdha dhe nuk dua të ndalem shumë. Unë ju përkujtoj edhe një çështje tjetër dhe dua të citoj ligjin, meqë deputetët e Parlamentit janë ata të cilët miratojnë ligjet, atëherë duhet t'iu përmbaheni plotësisht këtyre gjërave.

Qasja në dokumentet publike është e rregulluar sipas neneve përkatëse dhe unë besoj se këtu do të gjejnë në pajtim të gjithë deputetët e Parlamentit të Kosovës dhe të gjitha institucionet e vendit. E para, në nenin 4, thuhet, pika 4: “Dokumentet publike, të pranuar nga kërkuesi nuk mund të përdoren për qëllime denigrimi, për qëllime propagandistike apo për qëllime komerciale”. Po ashtu, format e qasjes në dokumente në nenin 11 pika 2, thuhet: “Nëse kufizimi vlen për disa nga informatat e një dokumenti, institucioni publik duhet të ofrojë qasje në pjesën tjetër informative të cilat i përmban dokumenti”. Për të vazhduar më tutje, “përgjashtimet e të drejtës në qasje të dokumenteve përcaktohen në nenin 12 pika 1, ku thuhet: “kufizimi i kësaj të drejte ushtrohet proporcionalisht dhe vetëm për qëllime të mbrojtjes së privatësisë dhe interesave tjerë legjitimë privat, interesave komerciale dhe të tjera ekonomike.”.

Prandaj, të nderuar deputetë, për të vazhduar më tutje, refuzimi në qasjen e dokumenteve zyrtare mund të ndodhë edhe nëse, pa marrë parasysh ndihmën nga institucioni publik, kërkesa mbetet tejet e pa qartë për të mundësuar identifikimet e dokumenteve, apo nëse janë plotësuar kushtet dhe kërkesat nga paragrafi 2 i nenit 11 të këtij ligji. Po ashtu, kërkesa për qasje në dokumente të klasifikuara, kërkohet që kërkesa për qasje në dokumente të klasifikuara të bëhet në pajtim me ligjin në fuqi për klasifikim të informacioneve dhe rregullave të sigurisë.

Të gjitha këto na obligojnë të gjithë neve që të sillemi shumë serioz në raport me kontratën shtetërore të lidhur me konzorciumin Behtel&Enka dhe natyrisht të gjithë ne duhet të jemi shumë seriozë për përmbushjen e obligimeve tona shtetërore dhe kjo po ndodh dhe do të ndodhë.

Ndërtimi i autostradës është rrugë e pakthyeshme. Do të ishte një vetëvrasje infrastrukturore për Kosovën të mendohej që duhet ndërprerë apo duhet rinegociuar në forma tjera me kompaninë ekzistuese, për shkak se atëherë do të ishte fundi i ndërtimeve në Kosovë.

Ne po hapim perspektivën tjetër të zhvillimeve dhe jemi shumë të bindur që tashmë me krijimin e kushteve paraprake me studimin e fizibilitetit për rrugën Prishtinë-Hani i Elezit, do të kemi edhe një lidhje tjetër të fuqishme në mes dy korridoreve, korridorit 10 dhe korridorit 8, që hap perspektivën e zhvillimit ekonomik për Kosovën, që hap perspektivën e integritimeve nacionale dhe ndërkombëtare, prandaj të gjithë ne të

bashkohemi në ndërtimin e autostradës dhe krijimin e kushteve për përfundim sa më të suksesshëm të saj.

Dhe, fare në fund, më lejoni të përmend edhe dy apo tri çështje që kanë rëndësi për të gjithë qytetarët e vendit. Kompania e cila po bën punimet në autostradë, po i përmbahet kontratës plotësisht, sikur që edhe Qeveria, Minsitria përkatëse, po përcjell me saktësi të gjitha obligimet që ka kompania.

Deri tani, unë kam këtu listën e gjatë të gjitha kompanive nën-kontraktuese dhe furnizues të Behtel&Enkës, që nënkupton se diku rreth 300 kompani kanë marrë angazhimet e tyre dhe rreth 68% të punëtorëve lokalë janë të angazhuar në kuadër të numrit të përgjithshëm rreth 3.000 njerëz. Dhe, natyrisht të gjitha këto kompani, të gjithë këta njerëz marrin të ardhura dhe natyrisht që ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe në zbutjen e çështjeve tjera sociale.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, mund t'ju them me plot përgjegjësi që puna në autostradën do të vazhdojë me intensitetin e lartë çfarë është tani dhe informata e fundit nga vizita që kam pasur para dy ditësh, është se në segmentin e parë po asfaltohet kilometri i 18 dhe kështu do të vazhdojë deri në përmbyllje të obligimit të parë, që në fund të vitit të kemi 38 kilometra në qarkullim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri ka një kundër-replikë me zotin Beqiri. Kërkoj falje që s'ta dhashë kur e kërkuat fjalën menjëherë!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti Haliti!

Më tepër një sqarim se sa replikë, edhe më tepër me opinionin publik se sa me...

Sa i përket Ligjit të Prishtinës, ju e dini se kemi punuar në atë drejtim dhe përcaktimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, është që të kemi një ligj për kryeqytetin, të standardeve evropiane perëndimore dhe jo ligj i mentalitetit të së kaluarës, pra i qeverisjes monopoliste.

Në anën tjetër, sa i përket asaj që e potencuat, ju e dini ne jemi miq të mirë, por dëshiroj të theksoj shumë qartë që përsëri të ftoj t'i pyetesh partiakët apo bashkëpartiakët tuaj, ish-ministra dhe ish-presidentin, unë e di që të pati mbetur pak merak, për t'u bërë pjesë e qeverisë së kaluar, por partia jote ka vendosur që të mos jesh ti për shkak të dështimeve pesëvjeçare që të kanë ndodhur në kryeqytetin, pra në Prishtinë. Në anën tjetër, nuk mund ta mohojë askush se komunën e Prishtinës, para dite e keni shndërruar në seli të partisë të LDK-së, pas dite selinë e LDK-ës e keni shndërruar në autoritet komunal. Dhe, se a kemi investuar apo jo, unë të them, infrastruktura në Prishtinë, kryesisht apo shumica janë investime të Qeverisë së Republikës së Kosovës në katër vjetët e fundit, qoftë rrugore, qoftë të shkollave apo e angazhimeve dhe investimeve tjera. Nga paaftësia e autoriteteve komunale vitin e kaluar, nga Komisioni Evropian, janë humbur 14 milionë euro të cilat janë transferuar për investime në Mitrovicë, ndërsa, janë tepruar 18 milionë euro në vitin e kaluar, pra në Prishtinë.

Prishtina nuk e ka atë komoditet të ngufatjes së zhvillimit dhe investimit, sepse të humben 14 milionë euro e të teprohen 18 milionë euro nga paaftësia e Prishtinës i ka 18 milionë probleme, jo t'i teprojnë 18 milionë euro, për t'i investuar në rrugë, në shkollë, kanalizime, ujësjellës, në ndriçim e të tjera, kështu që vetëm desha t'ia sqaroj zotit Beqiri, në mënyrën më miqësore dhe më shoqërore të mundshme. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Zoti Beqiri, ka të drejtë në replikë!

ISMET BEQIRI: Së pari, edhe unë tash po të them miqësisht, po s'e kishe fjalimin ashtu. E dyta, kallëzoju këtyre që Hajredini, zëvendësi, t'i shkroi do fjalë dhe mirë t'i përkujtoi, por gabimisht ti shkruajti.

Sa i përket ligjit të mentalitetit të së kaluarës, mos zoti Thaçi, sepse ai mentalitet i së kaluarës, edhe unë pajtohem që ka kaluar, por mos u thirrni në diçka që s'qëndron.

Sa i përket dështimit 5 vjeçar, ju aludoni, ne kohen kur unë kam qenë kryetar komune, por të kanë treguar votat. Ka për të mbetur merak, asnjëherë s'do ta marrësh Prishtinën, në këtë formë qysh e ke të qasjes, këtë veç mund ta enderros dhe nuk ka qenë objekt diskutimi sot Prishtina, as nuk është komuna e Prishtinës dhe nuk është korrekte për t'u marrë me këtë. Edhe këtë e bëjmë kur të doni temë. Sa i përket, se është para dite seli, e komunës e pasdite partiake, po ju nuk keni nevojë për seli të partisë hiq se çdo gjë e keni shenderruar PDK tash në Qeveri, atje i zhvillon aktivitetet partiake, kështu që mos u merr me atë punë.

E dini, zoti kryeministër shumë mirë, që ju keni dashur, ministri i juaj i atëhershëm i financave, për t'ia marrë Prishtinën, një pjesë të tokës tek Pallati i Rinisë dhe këtu ka qenë arsyeja pse ata 14 milionë euro janë shkuar diku tjetër, por ky është spekulim Komuna i ka humb ato para, sepse nuk mund t'ia merrni atë pjesë dhe pikërisht Pallati i Rinisë është pengesë që ju nuk e beni të mundur nxjerrjen e ligjit për Prishtinën dhe e keni prolonguar Ligjin për Prishtinën. Dhe, vërtet mua më vjen mirë që i paske zgjidhur të gjitha problemet e Kosovës dhe ju i keni numëruar 18 milionë probleme në Prishtinë.

Unë ju siguroj se me punët që po bëhen në Prishtinë, ju edhe 18 milionë vjet s' keni për ta marrë Prishtinën. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Mirë. Zoti kryeministër, kundër replikë edhe një herë dhe ju kisha lutur që ta mbyllni këtë çështjen e Prishtinës, minutazhi është, unë nuk mund të interpretoj Rregulloren, përveç ashtu siç është.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ne nuk jemi në fushatë elektorale dhe dëshiroj që kjo interpelancë të mos kalojë në debatet elektorale. Por, edhe diçka mund të them, se ato që i thashë janë realitete, të cilave nuk mund t'u ikë askush. Prishtina dhe Kosova është e vogël dhe njihemi secili me secilin dhe respektohem secili nga secili, por është edhe fakt të cilin e mohove tani, ajo se a ke mund të jesh ministër a jo, ka vendosur partia jote dhe sinjorisht ta them kështu ka qenë. Ndërsa sa i përket selive të partive politike...

(Ndërhyrje e Ismet Beqirit)

Mirë de, Ismet, tash unë dëgjova, ose kisha kërkuar nga kryesuesi që ta japë fjalën kur ta përfundoj, pastaj. OK! I nderuar Ismet, faleminderit për kërkimin e faljes që e bëre!

I nderuar Ismet,

Sa i përket selive të partive politike, është e vërtetë, asnjë nga këto parti politike që janë prezente në sallë, nuk kanë seli të partive politike, nuk kanë seli. Pse s'kanë? Përsëri pyetja për ju dhe Kuvendin Komunal të Prishtinës. Duke u nisur nga Partia Demokratike e Kosovës, AKR, të gjitha partitë e komuniteteve, Partia e Drejtësisë, Lista" Ibrahim Rugova", "Vetëvendosja", AAK dhe krejt partitë tjera politike. Ne nuk kemi seli të partive politike, sepse ju si Kuvend komunal, pa të drejtë, në mënyrë shumë diskriminuese në raport me të tjerët dhe favorizuese dhe jo ligjore, i keni ndarë mbi një hektar tokë në qendër të Prishtinës, për selinë e partisë suaj. Ndoshta e rrezoni edhe stadiumin, e bëni seli a ndonjë ndërtim të lartë, nuk dihet, kështu që, për këtë arsye s'kemi seli. Ju uroj juve seli, por ju ftoj që t' i trajtoni të gjitha partitë njëjtë, për t' iu ndarë hapësira, sepse zhvillojmë demokracinë, partitë. Ju, edhe pse mund të ndërtoni seli të madhe, ju uroj që të ndërtoni, ju ftoj t' i trajtoni të gjithë barabar, por edhe objekti dhe pllakat dhe kulmet e mëdha nuk i zhvillojnë partitë. Ne nuk kemi seli, por kemi ide. Ju keni pllakën, urime!

KRYESUESI: Unë do t'ia jap zotit Beqiri, fjalën për replikë, por dua t'ju lus të dy palët, në këtë rast edhe zotin Beqiri dhe zotin kryeministër që ta thërrasim një seancë ose një mbledhje tjetër për këtë çështje, se e kemi krejt një çështje që ka të bëjë me rrugët dhe ne kemi hyrë, tani jemi barrikaduar te Prishtina. Zoti Beqiri, besoj se s'e keni gjatë dhe ta mbyllim. Faleminderit!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

E para, para opinionit po i them kryeministrit që nuk është e vërtetë që LDK-së i është ndarë një hektar vend për seli. Analizo, se këshilltarët, a po e sheh që s'po të kallëzojnë drejt, i jane ndare 30 ari dhe unë kam qenë kryetar e. Unë ju dëgjova, tash më dëgjo. Unë kam qenë kryetar dhe atje në komune ekzistojnë procesverbalet, në mbledhje kam thënë, cilado parti që bën kërkesë do t' i ndahet truall nese ka mundesi. Asnjëherë kërkesë prej asnjë partie s'kemi pas. E para.

E dyta, zoti kryeministër, ju e keni selinë, se e keni uzurpuar menjëherë pas luftës, selinë në qendër dhe më të mirë se të Prishtinës, domethënë të LDK-së në këtë rast. Gjithashtu edhe partitë tjera, është e vërtetë që i kanë dhe atëherë kam thënë, po e përsëris se po më shtyn të kthehem pas, për diçka që s'është dashur, e kam thënë cilado parti që të bëjë kërkesë, ka për t' iu ndarë. Nuk keni bërë, se i keni kushtet më të mira, në atë vend që e keni uzurpuar, e dinë të gjithë qytetarët. Pajtohem plotësisht që ky është vend i vogël dhe e njohim secili- secilin dhe po e përsëris tash me mikrofon, zoti kryeministër, nuk qëndron ajo rreth qeverise dhe kur të doni unë ua argumentoj, unë kam pasur së paku dy herë ofertë prej partisë time të jam ministër dhe jam shumë i lumtur që s'kam qenë pjesë e Qeverisë të cilën e udhëhoqi ju. Jo për ndonjë mllef, por kam llogaritur se unë nuk jam

person, kuptohet kam qenë kryetar i Prishtinës, por nuk jam person që hy diku sa për të zhvatur e kush po zhvat e po e keqpërdor pushtetin, ka organe që duhet t' i hetojn dhe verifikojn keto dhe unë jam krenar për punën që e kam bërë, prandaj nuk bëhem pjesë e kurrfarë pazareve dhe këtë po e them publikisht, asnjë merak nuk më ka mbetur edhe kjo është diçka që është e ditur publikisht, zoti kryeministër. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Zoti Thaçi e ka fjalën edhe një herë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ismet, sa i përket kërkesës për seli të partive politike, unë besoj dhe e di që, së paku Partia Demokratike ka bërë kërkesë, s' është trajtuar. Tash nëse e keni zvogëluar në 30 ari, e keni filluar ndonjë ndërtim në ata 70 ari tjerë, është diçka tjetër edhe ato me leje ose pa leje, ndërsa unë ju ftoj që autoritetin komunal, të fituar nga qytetarët, të mos shfrytëzohet në kuptimin një partiak, por t' i krijohet kushte e mundësi, ne mund të jemi konkurrent politik, por çdo parti duhet t' i ketë kushtet, mundësitë dhe komoditetin për punë.

Për këtë arsye, unë ju ftoj të dilni mbi interesat partiake në drejtim të kësaj çështjeje. Sa i përket, a ke qenë a nuk ke qenë, unë të kisha ftuar... të kisha ftuar të mos i fyesh kolegët tuaj. Kjo është, duke u nisur nga presidenti Sejdiu.

KRYESUESI: Kundër- replikë e fundit, unë po ju them që asnjërit më nuk ua jap fjalën. Ju faleminderit! Ka të drejtë në kundër- replikë, një minutë.

ISMET BEQIRI: Zoti kryeministër,

Unë do t'ua sjellë me shkrim vendimin për ndarjen e atyre 30 ari dhe nëse ka të vërtetë në të që thoni se ka qenë 1 hektar dhe është zvogëluar në 30, unë jap përgjegjësinë para gjithë opinionit, por edhe ju do të duhej të kërkonit falje. Unë do t'ua sjellë me shkrim datën kur ka marrë vendim Kuvendi komunal. Urdhëroni e keni zotin Veseli atje shef grupi, ka qenë edhe atëherë, kjo është e vërteta, prandaj nuk është e vërtetë ajo që thoni ju. Unë do ta sjellë me shkrim, e kam obligim. Nuk e kemi zvogëluar, ai është vendim i para disa vitesh dhe unë partiakët, bashkëpartiakët e mi asnjëherë nuk i kam fyer, e as nuk do t' i fyej, as presidentin, mos tentoni, se me këto lojëra ju nuk mundeni të ngjallni ndonjë telashe, sepse keni dëshirë të tillë. Nëse keni luajtur në këtë letër më herët, harrojeni këtë punë më. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Rregullorja e thotë që kryeministri dhe ministrat sa herë ta kërkojnë fjalën, duhet t'ua japim, kështu që kur ta ndryshoni.

Zoti kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ismet, unë e kam vetëm një pyetje. Pse asnjë partie tjetër politike në Prishtinë nuk i është ndarë hapësira për ndërtimin e selive të tyre, kur kërkesat ju kanë ardhur dhe janë refuzuar dhe është ndarë hapësira vetëm për partinë tuaj ku ju keni qenë kryetar i Prishtinës?

Unë, nëse dëshiron mund të hapim debat edhe sa i përket basenit në Gërmi. Mund të hapim edhe sa i përket, ju e dini dhe jeni kompetent se, jo, jo mund të hapim debatin edhe sa i përket basenit në Gërmi, para se të bëheni kryetar i komunës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Vazhdojmë me deklaratimet e grupeve parlamentare.
Zoti Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

ADEM GRABOVCI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryeministër,

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Së pari dua ta falënderoj kryeministrin e vendit për gatishmërinë e treguar në vazhdimësi, sa herë që u kërkua nga ndonjë deputet për të ngritur dhe trajtuar ndonjë çështje që është me interes për qytetarët e vendit.

Grupi Parlamentar i PDK-së, mbështet debatin për interpelancë lidhur me projektin me kapital për qytetarët e vendit. Ne sot na bën të ndihemi vërtet mirë që po flasim për kryeveprën e zhvillimit ekonomik të Kosovës, për Rugën e Kombit, e cila jo rastësisht, me vendim të kryeministrit, mban emrin e ish-presidentit Rugova.

Si për çdo debat, ashtu edhe për këtë interpelancë, jemi për të diskutuar dhe për të dhënë vlerësimin lidhur me atë që vlerësohet interes i përbashkët.

Ne, parimisht nuk jemi për politizim të projekteve jetike që prekin direkt zhvillimin ekonomik të vendit, sidomos projektet që prekin qytetarët e vendit prej të cilave kanë përfitime direkte në realizimin e tyre. Por, ky është edhe një momentum i duhur që t'u tregojmë i duhur që t'u tregojmë qytetarëve të Kosovës, se Kosova po realizon një ëndërr të saj të kamotshme, e cila nënkupton krijimin e një shteti të ri modern.

Dëshiron apo jo dikush këtë shtet që sot mund ta quajmë shtet në zhvillim, ne e vlerësojmë se me projektet e tilla po krijohen kushte dhe hapësira për zhvillim ekonomik dhe kjo fal politikave të mirë menaxhuara të Qeverisë së vendit. Projekti i cili ka filluar a me ndërtimin e autostradës Vërmicë –Merdar, i financiar direkt nga taksapaguesit kosovar, padyshim është projekti më i favorshëm që ka bërë Kosova ndonjëherë në historinë e saj.

Duke bërë projektin më të favorshëm edhe për rajonin, këtë projekt e kanë mbështetur vazhdimisht miqtë tanë ndërkombëtar, duke ditur rëndësinë e këtij projekti që ka për zhvillimin politik dhe ekonomik të vendit. E dimë të gjithë, që qysh në fillim të këtij projekti, ka pasur hezitime dhe mendime për dhe kundër për fillimin e punimeve.

Ne jemi të vetëdijshëm se disa s' kanë besuar në mundësinë e realizimit të projekteve në përmasa ndërkombëtare, sepse nuk ishte e lehtë të realizoheshin projekte të tilla. Të njëjtit s' kanë besuar as në çlirimin dhe pavarësimin e vendit, sepse as kjo nuk ishte e lehtë. Tendencat për moslejimin e ndërtimit të autostradës, kanë qenë të shumta, si nga brenda ashtu edhe nga jashtë. Disa e politizuan këtë projekt dhe menduan shumë

politikisht, duke vështirësuar realizimin e tij. Këto mendime apo ide shumë të dëmshme për interesin nacional, i goditi diçka që gjeneroi pozitivitet. Vullneti i mirë i qeverisjes kundër këtyre tendencave të pakuptimta, na bëri më të fuqishëm në realizimin e kësaj ëndrrë që i gëzohet çdo qytetar i vendit, e besoj shumë edhe prej jush që jeni sot në këtë Parlament.

Punimet që po bëhen në këtë projekt, nga kompania amerikano-turke Bechtel&Enka, nuk do të kishin mundësi të realizohen me sukses, pa vendosmërinë tonë për ndërtimin e shtetit modern.

Të nderuar kolegë,

Kosova sot ka nevojë për idenë e ekonomisë së tregut, duke respektuar parimet e ekonomisë së lirë e jo ekonomi të planifikuar dhe centraliste. Kosova sot ka nevojë për ide kreative për ndërtimin e shtetit, ka nevojë për ide politike të integritetit, duke i dhënë shtytje zhvillimit politik, shoqëror të vendit.

Kosova ka nevojë, nevojën e bashkimit të kombit në Evropën e bashkuar, duke i arritur synimet në realizimin e qëllimeve përmes parimeve bashkëkohore si dhe materializimin e projekteve me interes nacional.

Ne konsiderojmë se mbi këto parime, është ndërtuar filozofia shtet-ndërtuese e qeverisjes sonë, andaj t'i mbështesim pa rezervë për realizimin e tyre, sepse këto janë parimet qytetare dhe demokratike.

Ne si Grup Parlamentar, jemi për transparencë, jo vetëm në këtë rast konkret, por për të gjitha rastet e mundshme, por kurrësi nuk jemi që në emër të transparencës, të ndërpriten apo të kërkohen dhe të pengohen realizimi i projekteve me interes nacional. Andaj, thirrja në mostransparencë, në këtë rast, nuk është asgjë as më shumë, as më pak, vetëm shumë zhurmë për asgjë.

Të gjithë ata që thirren në mostransparencë, të këtij projekti, duhet të dinë dhe t'i lexojnë ligjet vendore dhe parimet e marrëveshjeve mbi të cilat lidhen kontratat ndërkombëtare. Po të lexoheshin mirë ligjet dhe, nuk do të kishim këtë transparencë, sot. Ligji për qeverisje, për qasjen në dokumente zyrtare, nuk e ka penguar dhe nuk e pengon askënd që të shkojë të kërkojë, të lexojë dhe të dijë gjithçka sipas ligjit në lidhje me këtë projekt kapital, me interes nacional për vendin dhe qytetarët e tij.

Andaj, kërkojmë të jemi më të vëmendshëm kur cenohen interesat e qytetarëve të vendit, nga pakujdesia e egojeve partiake apo tekeve individuale.

I nderuar kryesues,

I nderuar Kabinet qeverisës,

Ne si Grup Parlamentar falënderojmë parashtruesin e kësaj interpelance që na mundësoj edhe sot, para qytetarëve të Kosovës, të shpalosim medaljen e artë të këtij projekti. Nëse ka diçka që përputhet 100% në mes të Qeverisë dhe vullnetit të popullit, pas çlirimit dhe shpalljes së pavarësisë së vendit, është pikërisht Rruga e Kombit, e cila

na qon drejt integritetit kombëtar, regional dhe më gjerë. Kjo vepër do të gjenerojë zhvillim ekonomik dhe integritet politik në mes shteteve në rajon dhe më gjerë, ku përfituesi kryesor do të jetë Kosova. Për këtë vepër, qytetarët, pa dallim, kanë vetëm një lutje dhe një kërkesë - kur dhe si të përfundojë sa më shpejtë realizimi i këtij projekti?

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo është historia e re e Kosovës dhe ne si Grup Parlamentar i bashkëngjitektimi vullnetit të qytetarëve, që për asnjë çmim dhe asnjë moment, të mos pengohen punimet për realizimin e vullnetit të qytetarëve të vendit, pavarësisht interesave të ndokujt që ky projekt mund edhe t'i pengojë. Ne sot po kërkojmë fuqishëm që këtij projekti t'i jepet shtytje përpara e të përfundojë sa më shpejtë që të jetë e mundur, sepse po na presin projekte të ngjashme, me interes për jetën dhe qytetarët e vendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: I nderuar kryesues,

Në këtë interpelancë është thirrur kryeministri i Kosovës. Ai duhet të jetë këtu edhe ato sa më urgjent, përndryshe ne nuk bëjmë interpelancë pa kryeministrin prezent. Kjo lojë duhet të ndërpritet qysh tani.

KRYESUESI: E kam në konsideratë mendimin tuaj.

Deputeti Fatmir Limaj e ka fjalën.

KRYESUESI : Më fal, unë po ju informoj, “Vetëvendosja” i ka 14 minuta, (pa nervozë) i kanë mbetur. Unë ua jap fjalën për këto 14 minuta, kushdo që të paraqitet. Nuk kam kurrgjë me askënd. Ju faleminderit!

Zoti Limaj, e keni fjalën!

FATMIR LIMAJ: Faleminderit, zoti kryesues,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po besoj se po kthehem në temë, ishalla!

Mendoj që është obligim dhe detyrë e jona që ta shfrytëzojmë këtë interpelancë, që të japim informacione, të japim disa informacione, të japim disa nga informacionet që ne i kemi dhe i shërbejnë kërkesës për interpelancë, e cila po besojmë që e ka për qëllim, për të cilin është vështirë për t'i informuar edhe njerëzit që janë të interesuar, por edhe për t'i sqaruar shqetësimet e mundshme të cilat kanë ardhur nga një debat i vazhdueshëm për projektin e autostradës.

Unë po flas në cilësinë e ish një ministrit edhe tash të deputetit, njeriut i cili ka marrë pjesë në këtë proces të formulimit të kësaj kontrate.

Më lejoni që së pari, në pika të shkurta, t'i them disa fjalë, mendoj se ministri Mujota i tha, por t'i ripërsërisim, sepse kjo çështje pastaj kaloi në seli e mbi seli, siç ndodhi, gjë që është normale në Parlament, ndodhin gjëra të tilla. Historiati i projektit të fillimit të autostradës është i qartë dhe dihet kur ka filluar, mendoj se këtu nuk ka nevojë shumë të humbim kohë. Me vetë faktin e fillimit të këtij historiani, ka treguar se sa është e rëndësishme dhe e nevojshme për vendin tonë që të kemi një projekt të tillë.

U tha këtu që qysh në vitet, 2001, 2002, 2003, pastaj ka vazhduar deri në hartimin e ashtuquajtur, hartimin e një projekt- dijani për fillimin e autostradës. Dhe, Qeveria e kaluar, ju e dini që një nga prioritetet e saj që ka fituar zgjedhjet dhe premtimet elektorale, ka pasur që do ta bëjë, do t'i fillojë punimet e autostradës. Kjo funksionon në demokraci, mbi bazën e atij premtimi merr vota dhe prioritetet i përcakton secila partia vetë, mbi bazën e tyre prioritetëve, zhvillon projektet, sepse iu ka premtuar qytetarëve. Sikur të mos kishte një dëshirë të qytetarëve, po të ishin kundër qytetarët e autostradës, nuk do t'i votonin në atë kohë, prioritetet tona, do të votonin prioritetet tjera. Dhe, kjo është esenca, baza e demokracisë dhe e synimit të partive politike të cilat shkojnë te elektorati për të marrë votën.

Prandaj, duke vazhduar, duke tentuar për të krijuar një kulturë të kontinuitetit të qeverisjes, pavarësisht kush ka qenë dhe kush do të jetë, për çështjet të cilat janë me interes nacional duhet të vazhdojnë, ne e kemi vazhduar aty ku ka mbetur me autostradën në atë kohë.

U tha këtu është, ka qenë një kompani BPI Consulting, e cila ka bërë, ka qenë e kontraktuar për të bërë projekte. Dokumentacionin dhe dosjen e keni në Ministri, të cilën mund ta gjeni çdo kohë, projekti dhe kontrata nuk është përmbushur. E tha edhe ish, e tha ministri, nuk është përmbushur që është e vërtetë. Kontrata as 20% nuk është përmbushur e atij projekti, janë dhënë mbi 500 milionë. Kjo mund të shihet në dosje. Dhe, një gjë që këtu po krijojmë përshtypjen që këtu njerëzit çdo gjë që është bërë për këtë projekt, çdo gjë prej A deri në Zh: letrat, dokumentacioni ekziston, dosja, kush do, kreu procesi siç ka shkuar, sepse bëhet fjalë për diçka shumë serioze.

Kompania për një mungesë të projektit të plotësuar tërësisht, mungesa gjeologjike, të cilat unë mund t' i përmend, për shembull çka i ka munguar projektit? I ka munguar shqyrtimi gjeo-mekanik, projekti detal dhe profilit të rrugës, ka munguar projekti detal i kyçjeve dhe i kryqëzimeve të autostradës, ka munguar projekti i pajisjeve të rrugës, në realitet projektet e urave nuk po korrespondojnë me nivelin e rrugës dhe nuk janë në përputhje me projektin e rrugës dhe ka munguar në tërësi projekti i tunelit nga AJA BPI. Kjo është, kjo ka qenë gjendja, dhe ne kemi vazhduar pastaj me rrugën që projekto dhe ndërto. Për hir të së vërtetës, për hir të seriozitetit, duhet të jemi të qartë që informacionet, burimet t'i verifikojmë mirë. Nuk bënë projekt kompania Bechtel&Enka. Projektimin e kësaj pjese, projektimin, mungesat ato që janë, që shihen, projektimet i bën një kompani kroate dhe një franceze, dhe ato janë të specializuara për projektim dhe pastaj kompania ndërton dhe ato i mbikëqyr Qeveria e Kosovës, të dyja projektimet.

Dua të hyj te, dua të futem pastaj te vetë kontrata. Ka pasur analiza të shumta. Dua t'ju them, të nderuar kolegë, ta shfrytëzoj rastin, unë nuk kam pasur rastin që ta them në publik, por dua të them që ne kemi parë versionin e kontratës që e kanë ngjitur, e kanë nxjerrë njerëzit, përfaqësuesit e “Vetëvendosje”-së për interpelancë, dhe unë dua t'ju them që është një draft i kontratës. Gjatë procesit të negociatave, janë diku rreth 30 drafte, që është normale në procesin negociator, ju e dini sikur draftet politike edhe kjo është njëjtë, gati thuaja e njëjta. Rreth 30 drafte janë punuar, janë shkatërruar derisa ka ardhur në një, në këtë kontratë që e kemi sot. Prandaj, ato çka unë kam parë në media, mendoj që ju e keni një nga ato draftet të cilat kanë qenë në konsultim e sipër. Nuk them që nuk ka gjëra të cilat nga ato drafte, ka brenda edhe në kontratë, por nuk mund ta marrim një kontratë përfundimtare, sepse ka gjëra të cilat nuk janë, edhe unë do të mundohem të jap disa nga ajo që unë e di.

Po flitet shumë për transparencën e kontratës, prej ditës së parë, është thënë kështu, që të mos e keqinterpretojmë edhe para mediave edhe kudo që mu ka dhënë rasti, besoj qëndron edhe sot, jam i bindur që nuk ka arsye për ta ndryshuar. Kontrata e Bechtel&Enkës është në përdorim dhe është e lejuar secili institucion, secili qytetar dhe gazetar, kushdo që është i interesuar mund të shkojë, ta shikojë dhe ta analizojë, por nuk mund që ta disponojë, sepse kemi kufizime ligjore, pra ta disponoj nuk mund. Besoj se kjo qëndron edhe sot.

Se sa ka telashe dhe probleme ajo kontratë, institucionet të cilat kujdesen se a ka pasur apo nuk ka pasur shkelje ligjore, ato e kanë vazhdimisht në dispozicion atë kontratë. Ne edhe nëse duam këtu, një kontratë e tillë voluminoze, e cila për herë të parë, ndërkombëtare, nuk mund ta zbërthejmë, duhet ekspertë për ta zbërthyer deri në fund. Në mund të bëjmë politikë, lojë llafesh, sikur që kemi bërë, mund të vazhdojmë, për të dhënë një përgjigje meritore, ku ka telashe, ku ka probleme, janë vetëm ekspertët e fushës së caktuar për ta zbërthyer një kontratë të tillë. Prandaj, ju them përsëri, në opinion janë prezantuar pjesët të draftit të cilat kanë qenë në bisedim e sipër. Po thotë, 30, mbi 30 drafte janë biseduar derisa ka ardhur në nënshkrimin e kontratës.

Është edhe raporti i kompanisë- Consulting kompanisë. Shikoni, unë e kuptoj grupin i cili e ka ngritur interpelancën dhe i cili nuk ka informacione. Por, ne që duam t'i marrim meritat, duhet t'i marrim edhe përgjegjësitë bashkë. Prej A-së, prej ditës së parë dhe në fund, Qeveria e Kosovës, Komiteti Ndërmintor, së bashku e kemi udhëhequr këtë proces, kur kemi qenë në koalicion. Dhe, jam i bindur që për aq sa kemi ne informacione, ka informacione edhe ish aleati ynë në Qeveri, sepse kemi punuar së bashku me kolegët. Ministrat të cilët kanë qenë në Komitetin ndërmintor, kanë marrë pjesë në negociatë, kanë parë draft- kontratë, kanë marrë pjesë në përfundimin e kontratës dhe mbi të gjitha, para se të miratohej ajo kontratë, është votuar në Qeverinë e Kosovës vendimi për miratimin e kontratës dhe është urdhëruar nga Qeveria e Kosovës, që drejtori i prokurimit të Ministrisë së Transportit, ta nënshkruajë, për faktin që kjo kontratë është e pranueshme.

E tash dua të hyj në detale për t'u treguar disa nga përparësitë e kësaj kontrate, që besoj përsëri po e ndiej obligim ta them, sepse pash se këtu shumë pak kemi folur konkretisht për këtë temë, e unë mendoj se është me interes për shqiptarët duke ditur që ky rast është pikërisht për interes të qytetarëve që të informohen.

Kontrata Bechtel&Enka, në qoftë se dëshirojmë ta krahasojmë me kontratën që po bëjnë firmat e Kosovës në rrugën Sllatinë- Orllat, çka të thoni, keni të drejtë, sepse nuk është kontratë e njëjtë, nuk mund të bëhen krahasime të tilla fatkeqësisht. Po flasim për një kontraktor ndërkombëtar, cilat kanë qenë parametrat që ne e kemi marrë? Jemi munduar të shkojmë në rajon.

Shembujt e rajonit.

Gjithmonë duhet marrë model, është e njëjtë sikur sot të thuash, Prishtinën ta krahasosh me Parisin, nuk krahasohet. Parisi duhet krahasuar me Berlinin, por jo me Prishtinën, prandaj edhe ne kemi marrë mostrën ose kemi shikuar në rajon, si ka funksionuar edhe si janë ndërtuar autostradat, në çfarë kushtesh, në çfarë kontrata kanë ndërtuar, mbi bazën e tyre kemi ardhur deri te zgjidhja?

Prandaj, më lejoni ta marr një shembull të kontratës së Bechtel&Enkas në Kosovë dhe asaj në Shqipëri.

Kontrata e Republikës së Shqipërisë me kompaninë Bechtel& Enka dhe kontrata e shtetit të Republikës së Kosovës me Kompaninë Bechtel& Enka.

Nën 1, në Republikën e Shqipërisë, kontrata shkruan kështu: “Për çdo lëvizje brenda kontratës, është paguar kosto profiti i cili ka qenë 8%, që në total potencialisht ka rritur koston deri në 8% të vlerës të kontratës” Kjo është në kontratën në shtetin shqiptar.

Doganat, a janë paguar nga Republika e Shqipërisë?

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdojani...!

FATMIR LIMAJ: Në kontratën e Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, nuk do të paguajë profit për lëvizjen brenda kontratës, përveç tek variacionet dhe shumat e përkohshme, prej këtyre variacioneve dhe shumave të përkohshme janë shpëtuar së paku 20 milionë euro, që ekzistojnë në kontratën e shtetit shqiptar.

Është gjetur zgjidhja doganore dhe janë shpëtuar 10 milionë euro, domethënë te ne e kanë obligim ta paguajnë doganën, që nuk është në shtetin shqiptar.

Kostoja e kapitalit indirekt në shtetin shqiptar, në kontratën e shtetit shqiptar, me Bechtel&Enkën është 1 milion e 700 mijë euro. Kostoja- kapitale indirekte me kontratën e Kosovës, është 1 milion euro. Dhe, nëse e marrim totalin, del diku rreth 25 milionë e 200 mijë euro, janë shpëtuar.

Në kontratën e nënshkruar nga shteti shqiptar, çmimi i kontratës, pozicionet e sasisë, ju kanë nënshtruar normës të inflacionit brenda çdo periudhe inflative.

Ekspertët tanë, kanë përjashtuar, domethënë, në Ministrinë e Transportit, në Qeverinë e Kosovës, nuk është paraparë dhe nuk kanë lejuar që në kontratë të jetë, e kanë përjashtuar inflacionin vjetor për 36 muaj. Për 36 muaj Kosova nuk ka asnjë obligim të përcjelljes së inflacionit. Në llogaritim, sepse ashtu është kontrata që për 36 muaj të përfundojë kontrata e autostradës. Nëse ka vonesa, ia pafshin fajin, Qeveria duhet të rrijë afër të zbatojë kontratën, duhet të qëndroj afër, sepse kemi kontratën me Rumaninë që 5 vjet. Në 2007-ën ka filluar e Bechtel&Enkas në Rumani, 58 kilometra janë lëshuar tani, për sa vite po i bie këtu, 5 -6 vjet. Normalisht që kostoja ka shkuar 2 miliardë, sepse dikush duhet ta paguajë dëmin dhe penalltitë atje. Në qoftë se na jemi, dhe vazhdojmë sikur është bërë për 38 kilometra për të cilat po flitet, kur u tha 24 është punuar për ta hapur këtë terren për 35 km, 24 orë për t'ia hequr kanalizimet, për t'ia hequr rrymën, problemet e shpronësimit, çdo gjë është bërë që të përgatitet që të mos kemi ne pengesa që nesër ta paguajmë penalltinë. Dhe, këtu i falënderoj dy komunat, Prizrenin, Suharekën dhe qindra njerëz që nuk janë sot dhe nuk shihen para kamerave të cilët kanë punuar që për 38 kilometra, të mos kemi asnjë vonesë. Dhe, për ata kemi këtë afat parakohor dhjetëmuor, sepse asnjë pengesë nuk e ka pasur kompania për realizimin e punëve. Shpresoj se kështu do të vazhdohet, por këtu duhet një përkushtim i madh.

Shteti shqiptar, në kontratën e Bektel&Enkas ka qenë i detyruar në gjithë segmentin e autostradës, që i kanë shkaktuar probleme makro-fiskale. Qeveria e Republikës së Kosovës, nuk është e obliguar në gjithë trasenë e autostradës. Ajo do ta kontrollojë ndërtimin nëpër seksione sipas instruksioneve të saj. Kemi ministrin e Financave, në qoftë se Ministrin e Financave, në qoftë se ministri i financave thotë, me letra që unë nuk kam para, në çdo moment mund t'i ndërpresë punimet.

Siguresat financiare, jam i bindur që ministri do t'ju thotë më mirë, të cilat mendoj që është kulmi i krejt kësaj. Çmimi është e vërtetë, është kontrolluar me 120%. Po a mund të rritet çmimi? Në qoftë se nuk mbikëqyret implementimi i kontratës, në qoftë se nuk rrihet afër implementimit të kësaj kontrate, mund edhe të devijojë, secila kompania është e interesuar të ketë më shumë punë. Në qoftë se kujdesemi me e implementimin e kontratës, nuk ka mundësi të rritet çmimi, sepse ka obligime kontraktuale. 40% e kompanive të Kosovës kanë të drejtë të jenë nënkontraktorë. Sot po ndiej fjalë po sa janë, qysh janë, ku janë nënkontraktorë, edhe kjo varet nga mbikëqyrja e implementimit edhe nga vetë puna e nënkontraktorëve, kjo është punë biznesi për të cilën vetë duhet...

I thashë disa pika. Po dua të dal edhe te dy fjalë tjera, pesha dhe rëndësia e autostradës. Mos t'i përziejme

KRYESUESI: Zoti Limaj, duhet deputetët ta deklarojnë, a po ua vazhdojmë kohën?

FATMIR LIMAJ: Unë po i shfrytëzoj minutat e Grupit Parlamentar të PDK-së.

KRYESUESI: Në rregull!.

FATMIR LIMAJ: Analizat, ju kisha lutur, FMN-në, Bankën Botërore, mos i përzini me autostradën. Banka Botërore prej ditës së parë ka qenë pjesë e pandashme në këtë proces, ka observuar. FMN-ja, nëse do të kishte problem, kishte bërë vjet e jo sivjet, rreth kësaj. Çështja financiare me kohë është thënë që mund të shkojë përmes buxhetit dhe kredive. Besoj se secili e ka të qartë, është thënë 100 herë se veç me buxhet të Kosovës, kjo autostradë vështirë është për t'u përballuar, por do të gjenden edhe rrugë tjera të financimit, kreditimit. Dhe, sot i keni në Ministrinë përkatëse dy- tri letra - dëshmi nga institucionet financiare ndërkombëtare, të cilat janë të gatshme t'i japin kredi këtij vendi, me kredi të buta për ta financuar autostradën, në qoftë se ky vend dëshiron t'i marrë, kështu që edhe këtë, besoj ministri e ka në dosje të autostradës.

Kosova, pesha dhe rëndësia u përmend këtu një analizë e KOV-it. Mos të flasim me analiza e 2003-s. Mos harroni, Shqipëria ka ecur, e ka bërë pjesën e vet të autostradës. Çfarë analize ka mundur të nxjerrë dikush në vitin 2003, kur ne kemi kaluar nga Kukësi, e dini çfarë rruge? Çfarë analize e koston ekonomike mund të nxjerrë me atë rrugë që ka qenë dikush në Shqipëri? Shkoni nxirreni sot koston dhe bëni analizën ekonomike, sepse nuk kish kuptim kjo autostradë po të mos ish përfunduar nga pjesa shqiptare. Ne duhet të shfrytëzojmë rastin të falënderojmë: sakrificën, mundin, përpjekjet e Qeverisë dhe popullit shqiptar të shqiptar të Shqipërisë, të cilët më shumë se sa për vete këtë rrugë edhe atë investim, dhe djersën e tyre e kanë bërë për Kosovën, për t'i hapur korridor Kosovës .

Ata kanë dhënë djersën e tyre, tatimpaguesit shqiptarë që ta mundësojnë të hapin korridorin shtetit të Kosovës, për të pasur dalje në deti dhe për t'u lidhur me botën. Dhe, ne këtu po flasim se a është dashur apo nuk është dashur 70-80 kilometra, 90 kilometra në Kosovë, ne sakrifikojmë për vetën tonë. Është projekti i parë në historinë e Kosovës, jo sot, dje, historinë e Kosovës, së është nisur , është menduar, është punuar nga shqiptarët e Kosovës dhe po paguhet nga vetë ne, i pari në krejt historinë e këtij vendi, sa ekzistojmë ne këtu. Një projekt politik shqiptari e ka pasur "Lidhja e Prizrenit" dhe projekti ekonomik, është autostrada i nisur nga vetë, nga djersa dhe puna jonë. Unë mendoj kështu pa glorifikime e patetizma.

Projekti, gjë tjetër, korridori i Kosovës, Kosova ka qenë tërësisht e izoluar. Dua të them që ju keni rastin për të shkuar përsëri në Bruksel. Nuk e di kush është në komisione përkatëse, nuk mund të thuash të kesh para për të ndërtuar autostrada, pa pasur lejen e Brukselit. Rrjeti i infrastrukturës rrugore, korridoret një herë përcaktohen. Po fitove, e merr të drejtën, por nuk fitove edhe nëse ke para, ju nuk mund të ndërtoni autostradë pa pasur lejen e Brukselit, sepse korridoret tashmë po bëhen transevropiane. Edhe kjo është në SITO.

Qeveria para se ne dhe ne e kemi vazhduar pastaj, kemi arritur që t'i fitojmë dy korridore shumë të rëndësishme ndërkombëtare. Këtë rrugë ta bëjnë korridor ndërkombëtar dhe rrugën tjetër, Shkup, Pejë, Mali i Zi, në vitin 2010 e kemi fituar, si

korridor ndërkombëtar dhe është në hartat e SITO-s është në hartat e transportit evropian.

Kosova nuk ka qenë në hartën evropiane, sa i përket rrugëve. Për herë të parë Kosova është futur në hartën evropiane dhe e kemi nxjerrë nga ky izolim. Mos pritni efekte ekonomike sot. Këto projekte i ndërtojnë përjetësisht, përgjithmonë dhe mbesin këtu.

Ju kisha lutur të nderuar kolegë për këtë vend ka shumë gjëra që po shkatërrojnë, shumë gjëra që po mundojnë, por mos të bëjmë debat për atë që po ndërtohet e që do t'i mbesin këtij populli, por të këqyrim për ato që po na ikin dhe po na shkatërrohen e që nuk po i shohim, e kurrë nuk kemi për t'i parë, e po dëmtojmë përditë këtë vend. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Është mirë që kryeministri është kthyer, nuk është mirë të ikë, nuk është mirë që ta përsërisë zanatin e moçëm.

Sidoqoftë, këtu zoti kryeministër, akuzove të tjetër për urrejtje, unë po të them ty që ti ke urrejtje ndaj të tjerëve. Akuzove të tjerët që kanë mllef dhe këtë mllef tëndin, qysh po e shoh sot, nuk e kam parë asnjëherë më herët, nuk e di pse ke kaq mllef. Akuzove të tjerët dhe për fyerje, ti je kah fyen, po i akuzon të tjerët edhe për jo transparencë, po i akuzon të tjetër edhe që janë kundër kombit, po i akuzon të tjerët që janë për ndërprerjen e Rrugës së Kombit. Nuk jemi për ndërprerjen e Rrugës së Kombit, merre vesh, jemi për ndërprerjen e hajnisë në emër të kombit. Ky është problemi, kjo është domosdoshmëria.

Po ashtu, përmende edhe deficitin në të kaluar, kujdes zoti kryeministër, ktheu pak në të kaluarën, këqyr kush ka më tepër deficit se sa të tjerët, shihe nëse do historinë, për t' i hyrë historisë, atëherë thirr ti ndonjë interpelancë për historinë e jo ne të thërrasim ty në interpelancë për historinë.

Ndër akuzat që po na bëhen neve, është akuza për publikimin e kontratës. Në të njëjtën kohë po thuhet që kontrata është vetëm një draft. A thua, ju them juve, çka dallon kontrata reale nga ky draft, shuajeni? Çka dallon esencialisht kontrata reale nga ky draft?

Po, në anën tjetër para se të na akuzoni për publikimin e kësaj kontrate apo të këtij draft-kontratës, siç ju e quani, atëherë mos harroni se dikush tjetër po ju akuzon juve për këtë kontratë në disfavor të Kosovës, sa i përket çmimit dhe kostos së lartë të papërbalueshme.

Pra, nuk po kërkojmë ndërprerjen e autostradës, por ne po kërkojmë ndërprerjen e keqpërdorimeve, po kërkojmë ndërprerjen edhe të politizimit ashtu siç ju po i akuzoni të tjerët që po e politizojnë këtë çështje, ne po ju akuzojmë juve që ju po e politizoni

autostradën. Për këtë autostradë kemi nevojë të gjithë, për këtë autostradë kanë nevojë të gjithë qytetarët e Kosovës edhe ata që do të vijnë pas nesh, por mos harroni, mos u sillni si pronarë të autostradës, as të buxhetit të Kosovës, sepse ju nuk e keni sjellë këtë autostradë nga Broja, as buxhetin. Buxhet i Kosovës i takon qytetarëve të Kosovës, të cilët e paguajnë shumë shtrenjtë. Pra, mos u sillni si pronar të autostradës dhe të buxhetit të Kosovës dhe t'ju thoni qytetarëve që ne po ua japim, sepse po të kishim dashur edhe nuk ua kishim dhënë hiq. Mos u sillni as si pronar të lirës së vendit, sepse liria nuk i takon juve, liria i takon të gjithë vendit dhe gjithë qytetarëve të Kosovës. Mos u sillni as si pronar të pavarësisë së Kosovës, sepse këtë çmim të pavarësisë së Kosovës, e kanë paguar shqiptarët e Kosovës, shekuj të tërë.

Ju akuzuat këtu edhe për zhurmë. E këtu pajtohem se vërtet ne po bëjmë zhurmë dhe do të bëjmë zhurmë sa herë që dikush të kërkojë që ne të heshtim para padrejtësive dhe para keqpërdorimeve. Pra, ne po bëjmë zhurmë dhe do të bëjmë hala edhe më shumë zhurmë dhe do t'ia prishim qetësinë atyre që të kërkojnë qetësi në manipulim.

Në të njëjtën kohë, më lejoni që të mos të përqendrohem shumë te karakteri i autostradës, sepse kolegët e mi do të flasin, por unë do të marr vetëm një theks të karakterit të autostradës. Autostrada e quajtur, e ashtuquajtur Morinë-Merdar, nuk po vazhdon të mbetet Morinë-Merdar, autostrada për momentin është Morinë – Orllat. Si e tillë po i ndërrohet karakteri, sepse po kyçet në të njëjtën vi me një magjistrale, siç është magjistralla Prishtinë – Pejë. Pra, autostrada tash për tash nuk është Morinë – Merdar.

Në anën tjetër, nëse ju e quani autostradë të kombit, Morinë – Merdar, mos harroni që po përmenden dy toponime që lidhen me dy shtete të ndryshme, pra. Ne e quajmë një autostradë ndërkombëtare, ju nuk mund të thoni që po e bashkojmë kombin edhe kah Morina edhe kah Merdarja. Rruga e Kombit është hapur qysh moti, zoti kryeministër, mos harro se këtë rrugë nuk e ke hapur ti i pari, Rrugën e Kombit e kanë hapur disa shokë tonë, të mi dhe të tutë, këtë e di shumë mirë, rrugën e Kombit e kanë hapur edhe shumë njerëz të tjerë që sot mungojnë në vend, e kanë dhënë jetën, pra mos u paraqitni edhe pronar i historisë së tyre edhe pronar i hapjes së Rrugës së Kombit. Mos harro se ata që e kanë hapur kombin, e kanë paguar gjak në atë rrugë dhe në atë kufi, sot janë jo fort larg këtij vendi.

Kallëzoju atyre se kush e ka hapur rrugën, kallëzoju atyre që kanë plagë nga hapja e asaj rruge para 12-13 vjetëve.

Po ashtu në fund, më lejoni t'ju them edhe një herë që nuk kemi tendencë ta ndalim rrugën, nuk kemi tendencë ta ndërpremë rrugën e komunikimit, kemi tendencë ta ndalim qarkullimin e keqpërdorimeve në emër të, në vend të qarkullimit të mjeteve në këtë rrugë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Imri Ahmeti.

IMRI AHMETI: Ju faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Justifikimi i ndërtimit të rrugës, normalisht që nuk kontestohet dhe mendoj që përfundimisht duhet ta kuptojmë të gjithë, por nën pretekstin këtij justifikimi, nuk mund të maskohet mundësia e abuzimit në nevojën e ndërtimit të kësaj rruge, nuk do të duhej të përshpejtohej as mënyra e financimit, as kostoja e financimit, as ndryshimi i trasesë, as mënyra e shpronësimit dhe shumë çështje të tjera që lidhen me këtë projekt.

Procedurat e përzgjedhjes, shkaqet e përzgjedhjes të këtij konzorciumi, kompania konsulent dhe puna e deritanishme apo e kësaj kompanie izraelite si u zgjodh kjo kompani, mënyra e shpronësimit dhe shumë detaje të tjera të këtij projekti, u thanë dhe mendojë janë enigmë të pa zbërthyer, por unë do të ndalem kryesisht tek devijimi i autostradës nga Qafa e Dules për Orllat, për të cilën nuk dëgjova shumë fjalë as nga ish ministri, zoti Limaj që momentalisht doli.

Ky vendim i Qeverisë për ndryshimin e trasesë, vjen bashkë me një përgjigje se kjo po bëhet për arsye të kinse të koston financiare. Në fakt, paraprakisht nuk janë bërë publike baza ligjore e këtij vendimi të Qeverisë, kur e kemi parasysh faktin se ky projekt është me ndikim të theksuar në rregullimin hapësinor të Kosovës. Pastaj, cili studim dhe cilat fakte janë më të fuqishme që e rrëzuan studimet e ekspertëve të gjitha fushave lidhur me hartimin e projektit dhe përcaktimit të trasesë bazuar në koston e ndërtimit, ashtu edhe në komponentin e zhvillimit dhe të përfitimit të ekonomik.

Cila do të jetë kostoja vjetore, financiare dhe ndikimit në zhvillimin ekonomik nga devijimi i trasesë dhe mosshfrytëzimi i autostradës nga pjesët qendrore të Kosovës, nga pjesët lindore dhe jugore të vendit, por edhe nga shtetet fqinje juglindore.

Çfarë ndikimi do të ketë devijimi i autostradës në zhvillimin ekonomik të zonës të trekëndëshit ekonomik, tani më mjaft të zhvilluar që përfshin pjesën qendrore të Kosovës, do të thotë mes Prishtinës, Ferizajt dhe Lipjanit?

Cilat janë faktet që me devijimin e trasesë të autostradës e arsyetojnë humbjen e mundësisë që Kosova të lidhet me korridorin e tetë dhe përmes tij, të integrohet në rrjetin e rrugëve me rëndësi ndërkombëtare dhe sidomos integrimin infra strukturor të rajonit jashtë kufirit lindor dhe perëndimor të Kosovës?

Në koston financiare, bazuar në ndryshimin e trasesë a është vlerësuar dhe pse nuk publikohet për opinion shtimi i theksuar i pronave për shpronësim?

A është llogaritur se për çdo metër katror të tokës për shpronësim, i paguhen me miliona kompanisë vlerësuese të përzgjedhur nga Ministria e Financave me çmimin më të lartë, pastaj rritja enorme e shumës të kompensimit për shpronësim, bazuar në rritjen e sasisë dhe kualitet të tokës dhe në anën tjetër, njëkohësisht zvogëlim i theksuar i tokës bujqësore.

Asnjë nga këta dhe shumë parametra të tjerë, në fakt nuk janë marrë parasysh sepse, siç duket arsyetja vendimtare e përcaktimit të trasesë për qeveritarët ka qenë vendlindja e tyre ku duhet domosdoshmërisht të kalojë traseja.

Ndoshta është pak qesharake, por me të drejtë qytetarët theksojnë: “Po të ishte kryeministri nga Lipjani apo nga Shtimja, sigurisht autostrada do t’i binte andej kah ishte e paraparë, andaj rezulton fakti se lejimi i trasesë paraqet një shembull tipik të shfrytëzimit të pushtetit për interesa regjionale klanore në dëm të projektit, në dëm të zhvillimit ekonomik dhe të interesit të qytetarëve të Kosovës. Produkt i kësaj kryeneçësie, pavarësisht pasojave, del edhe reflekton detyrimisht përjashtimin ose, thënë më së buti, detyron qytetarët e Kosovës qendrore, pjesën lindore dhe jugore të vendit, por edhe të shteteve fqinje jug-lindore të shëtisin deri në Orllat për t’u kyçur në autostradë ose do të shfrytëzojnë alternativa tjera.

Në fakt, gjithë përpjekjet e institucioneve të Kosovës prej kohës kur është dhënë ideja e ndërtimit të autostradës edhe për të vazhduar pastaj Qeveri pas qeverie në Kosovë, traseja e autostradës ishte e planifikuar dhe e aprovuar nga Dula – Shtimje e Lipjan, për të vazhduar në Merdar.

Traseja e mëparshme e aprovuar dhe zyrtare, që do të duhej të kalonte nëpër komunën e Lipjanit, realisht kalonte në zonat e koncentruara dhe të planifikuara të biznesit. Kjo zonë e studiuar dhe e planifikuar në planin hapësinor të komunës së Lipjanit dhe e integruar në planin hapësinor të Kosovës, për shkak të pozitës gjeografike dhe për arsye të afërsisë me kryeqytetin, të afërsisë me rrjetin hekurudhor dhe me aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës dhe, para se gjithash, kjo zonë ishte një nyje lidhëse me Shkupin dhe rajonin e Preshevës, respektivisht korridorin e tetë dhe të dhjetë, u shndërrua në një zonë atraktive për investitorët vendorë dhe të huaj, por ajo që po synon të bëjë Qeveria me devijimin e trasesë, është se po i lufton investimet e planifikuara të koncentruara në trekëndëshin ekonomik të Kosovës qendrore, ku ky devijim synon të anashkalojë plotësisht këtë zonë.

E vërteta është se autostrada u devijua nga planifikimi i paraparë vetëm në momentin e hapjes së tenderit, me arsyetimin se kompania i ka paraqitur dy variante të trasesë dhe menjëherë shtrohet pyetja - sipas cilës trase është shpallur tenderi për autostradën dhe sipas cilit projekt kanë konkurruar kompanitë tjera, dihet që janë afërsisht 30 kompani dhe si është e mundur që vetëm Bechtel & Enka të paraqesë aplikim me një version plus për devijim të autostradës.

Unë nuk do të ndalem te çështjet e çmimeve, sepse besoj u thanë shumë çështje, por megjithatë më lejoni në fund ta përmbyll këtë çështje, duke abstrahuar idenë që përmes idesë dhe nevojës që Kosova të ketë ndërtimin e autostradës së re për Shkup, po provohet të relativizohet dhe të bastardohen pakënaqësitë që ka prodhuar devijimi i kësaj autostrate Vërmicë – Orllat, aq më keq ky devijim i autostradës prej Dules në Orllat paraqet devijim të gjithë hartës rrugore të Kosovës edhe të njëjtën kohë paraqet devijim të autostradës që po planifikohet të fillojë për Shkup.

I gjithë ky marifet, përfundimisht, për shumicën e kosovarëve autostrada mbetet vetëm nga Duhla për Vërmicë dhe herët a vonë Kosova do të ketë nevojë të planifikojë vazhdimin e kësaj autostrade. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri e ka kërkuar fjalën, zoti Thaçi!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë potencova, i nderuari deputet, edhe më herët nevojën dhe domosdoshmërinë e devijimit të trasesë dhe e ritheksoj edhe një herë, ky është një korridor ndërkombëtar, jo çështje e lagjeve tona prej nga vijmë dhe unë nuk vi nga Orllati, secili ne vijmë nga një lokalitet i caktuar i Kosovës, sikur që jetoni ju, edhe unë jetoj në Prishtinë dhe mendoj se është pak sa jo e nivelit të komunikimit për të zbritur kush nga ka ardhur në Prishtinë apo jeton dhe si jeton në Prishtinë. Për mua është një vendlindje, ajo është Republika e Kosovës dhe çdo cep i saj ka rëndësinë e vet të njëjtë, si vendlindja juaj, sikur vendlindjet e të tjerëve, por edhe e imja. Pra, vendlindja e gjithë neve është Kosova dhe vetëm kur të kuptojmë kështu, atëherë do të punojmë të gjithë për të mirën e vendit dhe unë e çmoj edhe punën tuaj personale.

Devijimi ka ndodhur për shkak se do të duhej kursyer mbi 300 milionë euro dhe natyrisht do t'i kemi 7-8 minuta më tepër udhëtim. Këto kursime natyrisht se do të shfrytëzohen qysh janë shfrytëzuar, për rritjen e pagave për mësimdhënësit, policët, shërbyesit civilë, punëtorët e shëndetësisë, invalidëve të luftës, familjet e dëshmorëve, pjesëtarët e FSK-së dhe ju këtu i dini. Nëse kërkohet interpelancë, flasim edhe për këtë çështje dhe të gjitha çështjet tjera që janë preokupuese.

Ndërtimi i autostradës në drejtim të Shkupit nuk është fjalë boshe, nuk është propagandë, është realitet dhe shprehje e interesit do të shpallet në ditët e ardhshme dhe kjo autostradë në këtë kohë të krizës globale financiare po fillon, do të thotë nga Prishtina në drejtim të Shtimjes, Lipjanit, Ferizajt, Kaçanikut, Hanit të Elezit. Edhe ky është korridor ndërkombëtar, nuk është punë e lagjeve tona se ku jetojmë dhe ku kemi lindur, kështu që arsyeja ka qenë thjeshtë kursimi i mbi 300 milionë eurove dhe natyrisht do t'i kemi këta 7-8 minuta më tepër...

Mos ndërtimi i autostradës është humbje e kohës për një shekull të tërë që e kemi humbur si komb. Tash mund të bëni pyetje edhe sa i përket, të akuzoni edhe për xhaminë e Prishtinës. Unë e kam dhënë edhe pëlqimin atëherë për katedrale, por nëse kërkohet interpelancë, flasim edhe për xhami, se Ismeti me siguri nuk do të pajtohet, por edhe sa i përket asaj hapësire që është vonuar së hapuri, do të thotë të gjitha çështjet që ju pretendoni t'i ngritni, i ngrisim, i diskutojmë, nxjerrim konkluzione të përbashkëta në interes të përbashkët, se po ngatërrohen nganjëherë, do të thotë e filluat me autostradë, dolët te flamujt, prej flamujve dolët në çështje tjera të Prishtinës deri te bazeni, tash te xhamia, Ismet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, ka të drejtë zoti Ahmeti, në qoftë se e dëshiron fjalën.

IMRI AHMETI: Faleminderit, kryesues!

Nuk dëshiroj të shpenzoj kohën me replika të tilla, megjithatë për një çështje që unë e ngrita dhe poenta ime ishte, a ka pasur studim dhe, nëse po, cili ka qenë, pse nuk është bërë publik, kush e ka bërë për këtë devijim të autostradës. Kjo ishte poenta e gjithë diskutimit tim.

Dhe, çështja tjetër është, nuk do të duhej relativizuar dy autostradat njëri me tjetrin. Ne kur flasim për lisa, të flasim për lisa, ne flasim për lisa, ju flisni për fshisa. Dhe ka një thënie në popull, zoti kryeministër, ne e dimë që ju e dini, që ne e dimë që nuk është ashtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri, ma merr mendja...!

ISMET BEQIRI: Singërisht, më vjen keq prej deputetëve, por zoti kryeministër, është e drejtë e juaja, mua më vjen keq prej kolegëve të mi deputetë, të Grupit tim parlamentar. Mos u merr me gjëra që s'qëndrojnë. Po ju nuk jeni ai që keni dhënë leje për katedrale, e ke gabim. Mos i dezinformo njerëzit. Atë lokacion e ka caktuar Kuvendi Komunal i Prishtinës. Dhe sigurisht edhe për xhami do ta caktojë. Mosni në këtë mënyrë, sepse s'fitohen poenët politikë dhe nuk e di – sillesh, sillesh, ... të zë kerri, ose merr në thua përsëri ose tek unë, ose tek komuna. Nuk e ke asnjë arsye dhe nuk e di, ju po e devijoni debatin, po e shndërroni në diçka tjetër. Prandaj, mos u merrni me nevojat e qytetarëve në këtë rast, që kanë nevojë imediate, e sikur ju jeni ai, po merreni shpëtimtar i tyre. Ju nuk keni lidhje në kuptimin e asaj të kompetencës as me xhami, as me katedrale. Juve nuk ju lypet leje, se s'jeni ai që jepni lejet ose s'i jepni lejet. Prandaj, po e thoni, unë nuk di çka ka lidhje tash bazeni! Po merreni me gjëra, që mua po më vjen keq, po devalvon i gjithë debati. Singërisht, edhe unë po e shtroj pyetjen – asnjë të vetmin mllef nuk e kam, po unë po e vërej tek ju, nuk po ju kuptoj, ose normalisht është pjesë e lojës tuaj politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Thaçi e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë veç ju kisha ftuar, singërisht, nëse dëshironi të diskutoni edhe për autostradën në drejtim të Shkupit, të kërkonit interpelancë apo Qeveria mund të kërkojë debat. Puna më e lehtë e mundshme dhe më ndihmuese e mundshme do të jetë edhe për Qeverinë, edhe për Kuvendin, edhe për krejt autoritetet komunale që do të merren edhe me shpronësim prej Shtimje e drejt Lipjanit, Ferizajt, Kaçanikut dhe Hanit të Elezit. Dhe unë dëshiroj të gjithë të involvohen në këtë proces ndihmues, se unë e di që nuk jeni kundër ndërtimit të autostradës, së paku flas për Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Ndërsa, sa i përket ndryshimit të trasesë, ai autoritet që ka marrë vendim për ndërtim, e ka marrë edhe vendimin për ndryshim të trasesë. Ndërsa, sa i përket katedrales dhe xhamisë, unë kam pyetje nga Bashkësia Islame se pse autoritetet e Prishtinës nuk e japin lejen për ndërtimin e xhamisë, dhe natyrisht se nuk është në autoritetin tim të kthej përgjigje. Dhe kjo ishte, do të thotë pse vonohet përgjigja.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Idriz Vehapi e ka fjalën!

IDRIZ VEHAPI: I nderuar zoti kryesues,
Zoti kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,
Të nderuar deputetë,

Hapat më të rëndësishëm në projektet kapitale shtetërore tashmë janë bërë. Autostrada Morinë – Merdar është një nga projektet që ofron shpresën e qytetarit të Kosovës për një lloj standardi jetësor dhe për një lloj të veçantë emocioni kulturor, shpirtëror të qytetarit tonë që e merr të kuptueshëm apo të nënkuptueshëm, varësisht nga çfarë koncepti, perceptimi dhe konteksti politik.

Autostrada nuk ka pasur alternativë, prandaj edhe nuk ka kuptim që për çfarëdo qëllimi praktik opozitar të diskutohen joshjet dhe frika për të qenë e besueshme pashmangshëm atë që e thotë dhe atë që e ofron të menduarit alternativ apo kritika opozitare, si koncepton politik.

Ne duhet të flasim për argumentin që ka vlerë dhe ndikim. Kjo autostradë ka ofruar në kohë e hapësirë dinamiken e komunikimit të njësive politike, ekonomike e kulturore në mes Shqipërisë dhe Kosovës. Pra, nga një periudhë e një përshtatjeje të trazuar në mes dy njësive kombëtare, po hyjmë në një integrim të natyrshëm e të motivueshëm, duke i jetuar emocionet e jetësimit të autostradës për çdo ditë e çdo orë.

Vështirë është të kuptojmë thelbin e kësaj çështjeje, se ku do të dalë ndonjë mendim që do të dijë çdo gjë për autostradën. Mos ndoshta duke besuar se po thyhen shpresat e qytetarëve për këtë pritje të përfitojë pushtet me një promovim të filozofisë së dëshprimit. Efektet e mendimit që mohon gjithçka të mirë e të mbarë, mund të jenë të përziera me pasojat e mosgjetyes së fushave dhe problemeve ku mund të shfaqet mendimi opozitar i fortë e i mprehtë.

Të nderuar deputetë,

Me këtë nuk po mohojmë idenë për një kontroll detaj të gjithë kompleksit të çështjes së ndërtimit të autostradës. Është kompetencë e mekanizmave monitorues të autostradës, të cilët kanë përgjegjësinë e hartimit të raporteve të qarta dhe detaje për të gjithë procesin e monitorimit të projektit. Në këtë kontekst, ne duhet për aq sa mundemi dhe dimë, t'i analizojmë raportet që vijnë nga këta mekanizma dhe të kërkojmë të dimë për çështjet për të cilat dikush mund të dyshojë ose do që të informohet më shumë për këtë proces.

Në anën tjetër, ne duhet të jemi të vetëdijshëm se duke bërë zhurmë të pa artikuluar, hyjmë në një gabim të rëndësishëm, dekurajojmë qytetarët dhe trembim të gjithë investitorët që duan të investojnë në Kosovë. Mos me këtë përpiqemi të rrisim më shumë numrin e atyre që mohojnë punën që është duke u bërë të atyre që punojnë mirë e mbarë. Zhurmat mund ta tërheqin vëmendjen e atyre që tash mund të jenë bërë gati për të punuar apo për të investuar në Kosovë.

Tashmë e shohim se është ngulmuar në disa hamendësime, sa neve na kërkohet t'i pranojmë si të vërteta, por ka fare pak gjasë të hamendemi nga pellgjet e informacioneve

të papërqendruara, nëse debati për autostradën nuk shtrohet në esencën e vet. Kush e di se me këtë debat a po garantohet sukcesi apo pengesa.

Autostrada Morinë – Merdar do të sjell përfitime në planin politik, ekonomik e kulturor. Ekspertët e ekonomisë, institucionet financiare kanë theksuar vlerën dhe domosdoshmërinë e këtij projekti, duke pasur parasysh edhe çështjen e kostos së shpenzimeve për ndërtimin e autostradës, përfshirë këtu edhe shpronësimin e tokave private.

Se sa ka të ngjarë kjo të jetë e kushtueshme nën vlerën e kontratës ose sa mund të tejkalojë vlerësimin e kontratës, tashmë kjo çështje është e kryer. Tash kur autostrada është duke u ndërtuar, nga dikush kërkohet të kthehemi prapa, ta ndërpresim atë e të bëjmë rillogaritje për leverdinë dhe koston e ndërtimit të saj, ose apriori thuhet se ndërtimi i autostradës nuk do të bëjë asgjë për përmirësimin e statusit ekonomik të Kosovës, duke marrë këtë dikush këtë si një opsion politik të favorizuar për vete.

Të nderuar deputetë,

Përgjigje dhe mendim i përshtatshëm për ne është që t'i qasemi me kujdes nëpërmjet gjykimeve e analizave jo politike për të siguruar që ky projekt të përmbushë pritjet tona realiste, të përfundojë me sukses dhe të bëhet një realitet i prekshëm dhe i ndjeshëm në përputhje me planet e ndërtimit të saj, duke garantuar mbikëqyrje, monitorim dhe vlerësim të saktë dhe konsistent të punëve sipas projektit për të pamundësuar çfarëdo lloj mundësie për keqpërdorim apo degradim të cilësisë së ndërtimit të saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

Ajo që do të pyes në lidhje me autostradën Vërmicë-Merdar, është e natyrës krejtësisht teknike, pyetjet janë konkrete dhe nga kryeministri duam përgjigje konkrete.

E para është çështja e prokurimit. Sipas Ligjit për prokurim publik, është e domosdoshme që të jenë së paku 3 ofertues. Në deklarinimin pak më parë të ministrit, tha që kanë qenë 6, 7. Ky është manipulim, meqenëse kjo ka qenë shprehja e interesit, ndërsa kur bëhet fjalë për prokurim, kanë qenë 2 ofertues.

Sipas nenit 30 a) pika 4, kjo është dashur të anulohet. Neve po na intereson ta dimë dhe të na publikojnë se si e kanë arsyetuar këtë para AKP-së, meqenëse sipas nenit 30 a) pika 5, këta janë të obliguar ta arsyetojnë anulimin e kësaj kontrate – mos anulimin e kësaj kontrate.

Dhe, tjetra është, pse kanë vazhduar kështu kur dihej shumë qartë asokohe që çmimi po del në 1 miliard dhe është parashikuar fillimisht në 400 milionë.

Pika tjetër ka të bëjë me mbikëqyrjen. Edhe sipas ligjit të ndërtimit, edhe sipas çdo praktike në botë, edhe në të kaluarën, edhe sot, çdo ndërtim që bëhet qoftë me parangjime publike, qoftë me investim të ndokujt, është e domosdoshme ta ketë mbikëqyrjen si palë

të tretë. Edhe ndërtesat madje historike, ta këqyrim hamamin e Prishtinës, i cili është ndërtuar në shekullin XV, ka pasur organ mbikëqyrës.

Autostrada, pak parëz ministri tha që ka mbërri në kilometrin e 18 të asfaltimit. Dua ta djë kështu, saktë, qysh ka për t'u bë pagesa, kur nuk ka organ mbikëqyrës, atë zall e zhavorr, krejt që janë qitur nën atë asfalt, kush i matë, ku janë ato të specifikuara. Kjo është plotësisht në kundërshtim, kjo nuk ndodh kurrkund, thjeshtë.

Do të duhej pasur patjetër organin mbikëqyrës, të cilit i dorëzohen atestet e kontrollit të kualitetit. Parëz kryeministri manipuloi me betonin. Betoni i kujt do qoftë prodhimi, vlerësohet përmes atesteve. Të gjitha kompanitë ndërtimore që janë në Kosovë kanë prodhuar beton të kualitetit të lartë dhe këto ndërtesa që janë ndërtuar dhe që, ta zëmë, Komisioni Evropian i ka investuar të gjitha me ateste, janë vlerësuar ato klasa të betonit, që janë deri në 40, 50 e tutje. Pra, këtu nuk kemi të bëjmë...

Tjetra është, pra po më intereson si do të bëhet pagesa, kur nuk ka mundësi të bëhet matja, sepse pala e tretë tek tash ka filluar të punojë. A e dini vetëm një gjë, që kjo çka do të thotë, kjo është lëndë për prokurorinë. Pra, këtu ndodh problemi, këtu duhet të shtrohet problemi.

Çështja tjetër është çështja e shpronësimit. Qysh është e mundur ta marrë kompania Imobilia sh.p.k. ofertën me çmimin me vlerën 0.4 euro për metër katror, e që kjo i bie 4.000 euro për hektar. 4.000 euro për hektarë krejt ofertuesit tjerë janë kanë shumëfish më të lirë. Vlerësimi që të kushtojë 4.000 euro për hektarë, këtu s'ka kuptim hiq.

Tjetra. Qysh mundet ta marrë punën kompania e cila nuk është e licencuar në Kosovë. Kjo është në kundërshtim të plotë me ligjin. Ka konkurruar, nuk i ka pas dy inxhiniera, i ka pasur vetëm një, ka marrë licencë për rrugë të zakonshme, por jo për autostradë. Ky është prapë injorim i ligjit.

Tjetra. Po flasim për kompanitë private. Një ndër pasojat më serioze të mënyrës së realizimit të autostradës, është pikërisht mundësia dhe mënyra e tillë e cila po i çon kompanitë vendore drejt falimentimit.

Tash atyre s'iu ka mbetur rrugë tjetër, sepse krejt buxheti është i orientuar në autostradë, që po kërkojnë rrugë nëpërmes buxheteve komunale ku shpeshherë i ke nga 50, 60 kompani të cilat konkurrojnë për një tender krejtësisht të vogël.

Të mos harrojmë se gjatë 3 viteve të fundit janë investuar 350 milionë euro nga kompanitë vendore në importim të makinerive për baza të asfaltit, për gurthyes dhe për baza të betonit. Krejt këto investime janë bërë në ymyt, në shpresë të autostradës. Po, e tash!

Maqedoninë po ua marr shembull. Në Maqedoni, Kompania Enka, po ashtu ka marrë rrugë, ka marrë rrugë dhe ka dashur t'i futë edhe ajo makineritë e veta të asfaltit, nuk i kanë lejuar. Kanë pasur licencime të licencave të veta, është dashur ta marrë asfaltin prej

kompanive maqedone. Ne po i çojmë kompanitë tona drejt bankrotit. Pra, i kemi 26 baza të asfaltit, të cilat kanë për të mbetur, fatkeqësisht, të gjitha pa punë.

Dhe kur u përmend lista parëz e kompanive, duhet shikuar mirë atë listë, le ta deklaron, se ne e dimë atë listë, veç tash së fundit, janë tri kompani të cilat e kanë marrë para një jave pak më serioze një ofertë, që është prapë ofertë jashtëzakonisht e vogël dhe kjo ka ndodhur pas publikimit të kontratës. Pra, kompanitë tjera aty në listë krejt i kanë qesharake ato kontrata, do të thotë paratë e mëdha nuk shkojnë te kompanitë vendore.

Tjetra. Parëz u përmend çështja e kontratës, draftit apo kjo. Ne e kemi edhe kontratën finale të nënshkruar nga Nexhat Krasniqi dhe asnjë pikë, asnjë presje nuk ndryshon prej këtij drafti që e keni ju.

Po ashtu desha edhe një herë të lidhem te çështja e zbulimeve arkeologjike të cilat janë shkatërruar. A ka farë ndjesie këtu a po jo, apo veç hyhet kështu thjeshtë sikur që të gjitha zbulimet arkeologjike që kanë një vlerë ne i marrim, i shkelim, a po di.

Unë nuk po e zgjas më tepër, sepse minutat na kanë mbetur pak.

KRYESUESI: Faleminderit! Po, ministri Mujota e ka kërkuar fjalën për një sqarim.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, i nderuar kryesues! I nderuari Liburn, në tri çështje dua të të përmirësoj. Besoj se nuk e keni bërë me një qëllim të caktuar, por ndoshta s'keni pasur informatën e saktë.

E para, e keni ngatërruar çështjen e Bechtel&Enkës si kontraktues për ekzekutimin e punimeve në autostradë me kompaninë mbikëqyrëse për punimet e autostradës. Prandaj, ju keni referuar çështjes së kompanisë për mbikëqyrjen e autostradës në mënyrë të gabuar. Unë po ju informoj tani publikisht që puna e parë që kam bërë si ministër, pas marrjes së detyrës, ka qenë anulimi i procesit të tenderimit të mëparshëm, sepse nuk ka pasur kontraktor të përgjegjshëm dhe në afatin rekord brenda tre muajve kemi ardhur deri te përzgjedhja e kompanisë.

Ndërsa, për të hequr dilemën, mbikëqyrja e autostradës ka ekzistuar nga fillimi pa ndërprerë dhe ekziston edhe tani dhe të gjitha çështjet profesionale po mbarohen nga Ministria dhe ekspertët e Ministrisë, bashkërisht me të gjithë profesionistët e tjerë dhe tani kompania e përzgjedhur do të vazhdojë punën sipas ligjit dhe sipas obligimeve të kontratës plotësisht. Puna më e rëndësishme që është bërë në këtë moment është kjo dhe do të vazhdojë të kryhet me saktësi. Çështja e angazhimit të kompanive si nënkontraktorë, unë ua solla një listë të gjatë, e fundit që e kemi marrë dhe është shumë e saktë, është shumë e saktë, madje – madje për të mos e keqpërdorur foltoren, kam edhe informata që zëri më i fuqishëm që vije, nuk po ju referohem juve, për këto ankesa, vije nga zëdhënësit e kompanive që mund të jenë në Kuvend, nuk i referohem asnjërës veç e veç. Por, kjo nuk është çështja, nuk është tema. E rëndësishme është që kontratës po i përmbahemi 100% me angazhimin e kompanive vendore, me angazhimin e fuqisë

punëtore dhe të dyja palët janë serioze në këtë drejtim, prandaj nuk është mirë të manipulojmë me publikun. Faleminderit!

KRYESUESI: Po, replikë, Liburni!

LIBURN ALIU: Replikë, të shkurtër! Unë e kam të qartë që mbikëqyrësit e Ministrisë janë andej pari, po me ligj duhet pasur palë të tretë mbikëqyrëse e cila e vlerëson punën, jo ata mbikëqyrës. Ne po e vëmë në dyshim kontratën këtu, po e vëmë në dyshim në mes Qeverisë dhe këtu. Nëse këtë vënie në dyshim, ti mundesh të ma arsyetosh me mbikëqyrësit që i ka Ministria, është pikërisht ajo ku unë desha që ti pikërisht këtu të dalësh.

KRYESUESI: Kundër-replikë? Faleminderit!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Pikërisht e keni thënë të njëjtën gjë që duhet ta dinë publiku. Pikërisht është çështja se autostrada është mbikëqyrur vazhdimisht dhe do të vazhdojë të mbikëqyret nga ekspertët vendorë, pavarësisht përzgjedhjes së kompanisë ndërkombëtare. Absolutisht, secila palë e ka të drejtën e vet dhe përgjegjësinë e vet në raport me kontratën, prandaj jemi shumë të lumtur që tani është zgjidhur ky problem dhe kjo histori ka përfunduar. Prandaj, edhe një gjë t'ju them që çështja e mbikëqyrjes është përfunduar, kompania do të nënshkruajë kontratën së shpejti, ekspertët tonë bëjnë punën tonë, tani do ta bëjnë vazhdimisht deri në përmbyllje të kontratës, sepse është obligim dypalësh.

Dhe çështja... Të lutem, ndoshta është rregull që të dëgjohemi. Të gjitha çështjet janë të regjistruara, janë të shënuara, janë të vërtetuara dhe do të jenë të vërtetuara vazhdimisht gjatë gjithë punimeve, prandaj kompania mbikëqyrëse ndërkombëtare do të jetë vetëm një nga obligimet e kontratës e cila tash është përmbushur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën! Dhe, kërkoj falje që e kam vonuar!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit kryesues, megjithatë!

Para se të kaloj në temë, unë kisha dashur t'ju them, të nderuar kolegë deputetë, se zhvendosja e debatit nga ana e kryeministrit dhe futja në lojë e disa deputetëve, normal se shkon në interes të po kryeministrit.

Prandaj, të kthehem në temë dhe të reflektojmë në një edukatë, siç e kërkon edhe vetë Parlamenti.

Ndonëse ndërtimi i autostradës Vërmicë-Orllat është e ardhmja, ishte dashur të jetë Merdar, por në realitet është ky, është e ardhmja jonë, e ardhmja e gjeneratave që do të vijnë pas nesh. Mostransparenca e Qeverisë, përkundër përpjekjeve dhe insistimeve të vazhdueshme të opozitës dhe të qytetarëve të Republikës së Kosovës, vërtet është e pakuptimtë dhe si e tillë do të thosha se në radhë të parë nuk i bën nder ekzekutivit të vendit dhe aq më pak kryeministrit Thaçi.

Kontrata në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe kompanisë Bechtel&Enka, ishte dashur urgjentisht të bëhet publike, sepse për këtë në radhë të parë janë të interesuar qytetarët – tatimpaguesit e Kosovës dhe konsideroj se në këtë drejtim ata kanë të drejtë të pamohueshme dhe krejt të natyrshme, gjithçka ndërlidhet me punën dhe ndërtimin e saj.

Si mund të jemi kundër ndërtimit të këtij projekti kapital kombëtar, kundër të ardhme sonë, mirëpo ne kemi të drejtë t'i dimë të gjitha detajet rreth këtij projekti. Një gjë e tillë është në interesin e të gjithëve, në radhë të parë në interesin e të gjitha institucioneve tona. Prandaj, konsiderojmë se mos bërja publike e të gjitha informacioneve rreth ndërtimit të autostradës është mbi të gjitha e pashpjegueshme.

Dokumenti i zbulimit ditë më parë, flet më së miri për gjendjen e pakuptimtë dhe alarmante në mbarëvajtjen e këtij projekti madhor. Për sa kohë Qeveria e Republikës së Kosovës nuk publikon kurrfarë dokumenti tjetër rreth mbarëvajtjes së punimeve në autostradë, atëherë kjo mbetet e vetmja kontratë publike e lidhur në mes Qeverisë dhe kompanisë Bechtel&Enka, rreth së cilës ne kemi të drejtë të jemi të shqetësuar edhe si deputetë, por edhe si qytetarë të Republikës së Kosovës, sepse këtë mbi të gjitha e kemi obligim kushtetues, qytetar e moral.

Sipas asaj që kemi parë dhe dimë rreth autostradës, përkatësisht kontratës me kompaninë Bechtel&Enka, është se kontrata pikësëpari i përmbush para se gjithash interesat e vetë kompanisë Bechtel&Enka dhe e rëndon maksimalisht buxhetin edhe ashtu të varfër të Republikës së Kosovës. Pra, shtrohet me të drejtë pyetja - në çfarë niveli ndodhet aktualisht interesi i Kosovës dhe qytetarëve të saj?

Mendojmë se kjo kontratë është kryekëput e njëanshme, ku Bechtel&Enka është përfituesi më i madh në këtë rast, ndërsa humbësi është bartësi i të gjitha obligimeve tjera, në këtë rast Qeveria e Kosovës. Ndërkaq, humbësit më të mëdhenj janë qytetarët e Kosovës, mbi të cilët natyrisht sot e përgjithmonë do të bie barra kryesore si tatimpagues.

Zoti kryeministër,

Tendencat tuaja të vazhdueshme për t'u paraqitur si shpëtimtar i qytetarëve të këtij vendi, të përgjakur nëpër shekuj, nuk të bëjnë nder, sot e përgjithmonë. Nderi dhe meritat për autostradën dhe për lirinë e këtij vendi iu takon qytetarëve, absolutisht të gjithë qytetarëve brez pas brezi, atyre që me gjakun e tyre që moti filluan t'i hapin rrugët e kombit, qoftë edhe nëpër malet tona që rrënjët i kanë të ujitura me gjak.

Historia është e lashtë, është rrugë që ka filluar shumë vite e dekada para nesh, rrugë e sakrificës sonë të përbashkët si komb. Ajo nuk i duron dot teket dhe kryeneçësitë tona të sëmura, ajo nuk është përjashtuese, por në vazhdimësi unifikon sakrificën që sfidon vite e shekuj me radhë.

Dhe, krejt në fund, ne dhe qytetarët e Kosovës nuk jemi kundër ndërtimit të rrugës së kombit. Kjo duhet të jetë e qartë. Ne jemi kundër keqpërdorimeve dhe abuzimeve

marramendëse që aktualisht po vazhdojnë të ndodhin në emër të “Rrugës së kombit”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju në njërën anë po kërkonit të koncentrohemi në çështjen që është kërkuar interpelanca, në anën tjetër po flisni për histori. Thërrisni interpelancë apo debat edhe për histori, flasim prej Lidhjes së Prizrenit apo ilirëve e tutje, kur të doni, si të doni. Meritor për liri, pavarësi dhe zhvillim janë të gjithë qytetarët e Kosovës mbi çdo parti, ky është qëndrimi dhe vizioni im politik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Armend Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit shumë, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar dhe i respektuar kryeministër i vendit, ideator i “Rrugës së kombit” dhe të zhvillimit ekonomik të vendit,

Nuk po di çfarë lëvdata tjera të të jap, sepse edhe vetë debati sot tregoi se cili është serioziteti edhe i interpelancës së thirrur nga Lëvizja “Vetëvendosje”, po edhe i përgjigjes që ju po i jepni deputetëve dhe qytetarëve të vendit përmes kësaj interpelance.

Pak a shumë e thanë edhe kolegët e mi dhe ndoshta unë nuk do të ndalem, por dy gjëra më bënë përshtypje. Një mendim i ish ministrit Limaj, apo fjalimi i tij dhe ish ministrit të tanishëm, po edhe i vetë juve si kryeministër, nuk korrespondon me projektin dhe me temat që u trajtuan këtu. Tash lindin dilemat dhe dyshimet me shumë vend, për mua dhe të gjithë deputetët, besoj që këtu ka diçka që fshehët pas kësaj kontrate.

E dyta, është shumë interesant se si ka mundur Bechtel&Enka të futet në mendjen e Qeverisë së Kosovës dhe të aplikojë me dy plane shtesë.

E treta, kemi pasur një privatizim të pronës shoqërore, sidomos në pjesën që lidhet me Malishevën dhe pjesën deri në Orllat dhe pikërisht andej i bien shpronësimet dhe kalon traseja.

E treta, nuk kam pyetje për ju kryeministër, por për ministrin e Infrastrukturës, të tanishëm, dhe të Transportit, sepse e prezantoi një listë, tha e kam një listë të kompanive që kanë fituar në tender, sepse po t’ju bëj pyetje, jam i bindur që ju zotoheni se nuk jeni të ndikuar nga parapolitika apo ata që i fitojnë tenderët dhe unë mendoj dhe këtu e them publikisht, se shumica e atyre tenderëve që janë të fituar nga ato kompani, janë financues të Partisë Demokratike të Kosovës. Dhe aty mund të na i paraqet ndoshta edhe në letër, edhe me emër.

Dhe e treta, është që shumica e atyre kompanive qëndrojnë edhe eksponentë apo ndoshta familjarët e qeveritarëve, ish qeveritarëve, por edhe të deputetëve të Partisë Demokratike të Kosovës, s’po them edhe të komandantëve, se ka edhe komandanta shumë, atëherë del

edhe ajo. Faleminderit shumë! Unë nuk kam diçka tjetër dhe s'po ua marr kohën kolegëve të mi.

KRYESUESI: Zoti Mujota e ka fjalën, për të sqaruar!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: I nderuari Armend, unë dua të sqaroj vetëm një gjë. Është keqkuptim ndoshta, por nuk janë tenderët që i jep Ministria për të punuar me Bechtel&Enkën, janë nën-kontraktuesit që lidhin kontratën me Bechtel&Enkën, besoj që do ta dalloni këtë punë, ndërsa lista prej 302 kompanive që kanë punë është e plotë këtu dhe mund t'ia jap secilit që dëshiron. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po, mbasi ta përmendi emrin, ke të drejtë. Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, shumë! Unë pikërisht atë çka po dua, për hir të transparencës, ta kemi listën si deputetë dhe atëherë i heqim edhe dyshimet tona. Nëse unë jam gabim, jam shumë i vetëdijshëm dhe i përgjegjshëm që e pranoj nëse jam gabim. Por jam i bindur që 40% të asaj shume që i bie afër 300 milionë, është shumë e madhe dhe ne kemi informata, jetojmë në Kosovë, zoti ministër, e dimë kush qëndron prapa atyre kompanive, edhe nëse kontraktohen nga Bechtel&Enka i kemi ankesat edhe nga kompanitë tjera, edhe nga qytetarët, edhe nga komuniteti atje që është vendor dhe në të gjitha këto, prandaj ky është shqetësim real, nuk është hipotetik, sepse nuk e kisha thënë pa e pasur një bazë paraprakisht.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mujota e ka fjalën!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Pa dashur që të caktoj ndoshta një farë lloj diskutimi që s'merr kuptim të drejtë, por kur thoni 300 milionë, ndoshta apo i referoheni gjithë kontratës. Të jeni të sigurt se kompania Bechtel ka lidhur kontratë, ndërsa punët i lidhë me kompanitë si nën-kontraktues. Nuk mund t'i referohen kësaj shifre.

Dhe çështja tjetër, 40% i kompanive nën-kontraktuese ekziston sot, numri i punëtorëve që punojnë është mbi 2.000, që është pra 68% dhe këto janë çështje që janë shumë serioze dhe konkrete. Ndërsa, meqë më dhatë rastin, të tërheq vëmendjen diçka publikisht.

Me gjithë dëshirën tonë si institucione, si popull, që kompanitë vendore të jenë të përgjegjshme, të jenë serioze, të jenë me kualitet, me mbikëqyrje dhe me çështje tjera ashtu si duhet për të pasur punë më serioze, fatkeqësisht realiteti është ndryshe. Dhe, publikisht po them, alarmi është ndezur për të gjitha kompanitë e pa përgjegjshme, të cilat nuk bëjnë punë cilësore dhe të cilat do të kenë planifikime në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër replikë, zoti Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Unë prapë po e them, sepse nuk jam ekspert i kësaj fushe. Unë po flas nga ato çka i ka thënë kryeministri i vendit. 4.000, 5.000 punëtorë ka thënë, nuk ka

thënë 2.000, zoti ministër. Kjo është ajo çka unë po flas, çka Qeveria ka thënë dhe zotimet të cilat nuk po i përmbushni. Kjo është ajo çka ne po kërkojmë. Nëse ke interpretim jo tjetër, ose nëse nuk je i informuar nga ish ministri, është tjetër çështje, sepse ne e pamë edhe nga fjalimi që nuk korrespondon ajo çka e tha Limaj dhe ajo çka e thoni ju.

KRYESUESI: Zoti Mujota, sqarim shtesë!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Nuk besoj se do ta shndërrojmë në debat personal, është e vërtetë, por kryeministri nuk e ka përdorur shifrën 4.000 punëtorë. Kemi thënë që tash kompania është në pikun e ndërtimeve, me 3.000 punëtorë, prej tyre rreth 2.000 janë punëtorë lokal, që marrë në përqindje ka ardhur diku 68% dhe kjo qëndron. Prandaj, të mos merreni me çështje që janë shumë të sakta dhe shumë të ditura. Kjo është ajo!

KRYESUESI: Faleminderit! Po, urdhëroni! Zoti kryeministër e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ky është sqarim për të gjithë, jo vetëm për pyetjen e deputetit.

Deri tani, deri në këtë periudhë të punimeve që po flasim për kohën dhe gjatësinë e autostradës, punojnë 3.100 punonjës, prej tyre...

(Ndërhyrje)

Po, mirë de! Deri më tani punojnë 3.100 punonjës, prej tyre 68% vendorë, punëtorë lokalë, ndërsa deri në përmbyllje, natyrisht se do të punojnë me zgjerimin e punimeve dhe me fillimin e seksionit 5 nga Qafa e Dulës deri në Orllat, do të rritet numri i punëtorëve vendorë, do të rritet edhe numri i kompanive nën-kontraktore lokale dhe në kuadër të kësaj do të rritet numri i fuqisë punëtore vendore. Deri më tani, mbi 40 kompani vendore, me këta 2.000 e më tepër punëtorë, punojnë në autostradë, pra ky ka qenë edhe një nga standardet e kontratës, participimi i biznesit vendor dhe kjo është lehtësi dhe ndihmesë për komunitetin e biznesit vendor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Afrim Kasolli. “Vetëvendosja” i ka edhe 4 minuta, Partia Demokratike 7, AKR-ja 9 minuta, “6+” 7, LDK-ja 9, AAK-ja 7, SLS-ja 15, deputetët pa grup parlamentar 12 minuta.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kur kompania Bechtel&Enka u premtua se do ta fillonte punën, propaganda ishte shumë e madhe. U tha se do të hapen mijëra vende pune dhe se do të zbatohen standarde ndërkombëtare, por gjërat sot duken krejtësisht ndryshe, vendin e dikurshëm të shpresave e ka zënë dëshpërimi dhe këtu jam i detyruar të prezantoj mendimet e disa punëtorëve: “Jemi të detyruar të punojmë 10, 12 madje deri 15 orë në ditë, kurse për këtë punë paguhemi për 70 centë për orë, punojmë me tri ndërrime, turri i natës paguhet njëjtë sikurse ai i ditës, siguria na mungon. Pushim kemi vetëm një herë në dy javë, që i bie dy

herë në muaj, kurse ushqimi është nën çdo nivel dhe standard, thuaja se jemi në Azi, ushqehemi vetëm me oriz dhe atë gjithmonë me frikë sa i përket origjinës dhe kualitetit. Dhe për më tepër jemi të shkatërruar fizikisht, psikologjikisht dhe moralisht”, kurse ky shkatërrim madje vërehej edhe në fytyrat dhe shpërfytyrimet që i kishin pësuar kjo kategori e shoqërisë, ishin këto vetëm disa nga rrëfimet rrëqethëse të atyre qenieve të mjera e pa fuqishme përball mosmbrojtjes institucionale dhe juridike nga fuqia mbishfryëtzuese e kësaj kompanie dhe ajo që është më skandaloze, ka të bëjë me faktin se kjo veprimtari e Bechtel&Enkas është në kundërshtim si me Ligjin e punës së Kosovës, ashtu edhe me standardet ndërkombëtare. Është e ditur se në Kosovë orari i plotë i punës zgjatë 40 orë në javë. Neni 23 i paragrafit 1 të Ligjit të punës thotë se në rastet e jashtëzakonshme, me rritjen e vëllimit të punëve dhe në raste tjera të domosdoshme, me kërkesën e punëdhënësit punëtori duhet të punojë më së gjati se orari i punës më së shumti deri në 8 orë, kurse punëtorët në kompaninë Bechtel&Enka punojnë më shumë se 70 orë në javë.

Pra, këtë punë prej 48 orëve jo, por prej 70 orëve nuk e shoh si diçka të domosdoshme e as si diçka të jashtëzakonshme, por si një shfrytëzim të pastër të punëtorëve dhe abuzim me të drejtat e tyre, veçanërisht kur dihet se puna mbi orar paguhet dy fish në gjithë botën e civilizuar, e kur i pyesim zyrtarët qeveritarë për çështjen e çmimit të zhavorrit se pse ai është dyfish më i shtrenjtë se zakonisht, e këtu po citoj njërin nga ... morale të kësaj Qeverie, të rekrutuar kohën e fundit, Ilir Mirenën, para disa ditësh, thotë se këtu po ndërtohen autostrada me standarde ndërkombëtare e jo rrugë lokale. Atëherë, shtrohet pyetja, pse nuk po zbatohen këto standarde edhe sa i përket të drejtave të punëtorëve? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Deshishku!

HASHIM DESHISHKU: I nderuari kryesues, Haliti!

I nderuar zoti kryeministër Thaçi,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Rreth realizimit të projekteve të mëdha gjithmonë ka dilema se a janë nisur në kohën e përshtatshme, a kanë mund të realizohen ndryshe dhe në mënyrë më të përshtatshme të financimit dhe, në fund, çfarë do të jenë efektet dhe si do të jetë kthimi i investimeve.

Padyshim se dilemat e këtilla vazhdimisht do ta përcjellin edhe autostradën “Ibrahim Rugova”. Madje, vetëm t’ju përkujtoj se përpjekjet për të gjetur formë të jetësimit të këtij projekti datojnë që nga momenti kur kjo ide doli nga presidenti historik i Kosovës, doktor Ibrahim Rugova.

Ndonëse për një kohë i tërë problemi ishte vetëm temë e debateve, por në vitet e pas luftës u bënë edhe disa vlerësime e hulumtime të cilat u finalizuan në prill të vitit të kaluar, kur edhe nisën punët. Disa zhvillime më të reja në vend që të eliminohen dilemat dhe shqetësimet, ato i bënë edhe më të mëdha. E kam fjalën për vendimin e Qeverisë për të ndryshuar trasenë e autostradës, e cila bie ndesh me vendimin e Kuvendit të Kosovës të

7 qershorit të vitit 2008, kur është përcaktuar traseja si zonë e interesit të veçantë ekonomik.

Ky vendim nxit edhe dy shqetësime të tjera. I pari, ka të bëjë me mospërfilljen e vendimit të këtij Kuvendi, meqenëse ndryshimi i trasesë nuk ka mund të bëhet pa iniciativë të re dhe fakte të reja. Kjo nuk ka ndodhur.

I dyti, është problemi më i madh që me ndryshimin e trasesë seriozisht po rrezikojmë që autostrada të humbë statusin e korridorit ndërkombëtar. Janë shkelur kushtet teknike dhe ato të sigurisë, posaçërisht se autostrada Durrës-Prishtinë-Merdar është definuar si pjesë e rrjetit ndërkombëtar – Korridori 7.

Ky vendim është marrë në nivele ndërkombëtare, atë të Bashkimit Evropian, kurse harta e korridoreve ndërkombëtare është aprovuar nga SITO. Nuk e di a është marrë leje nga SITO për ndërrimin e kësaj traseje.

Shqetësimi im është i arsyeshëm. Ja faktet: Ndërhyrja e autostradës në rrugën Prishtinë-Pejë, përkatësisht në segmentin 20 kilometërsh Arllat-Sllatinë, ndryshojnë rrënjësisht kushtet teknike dhe ato të sigurisë. Nga autostrada e mbyllur, bie në autostradën në standardin e saj të hapur, mungon rruga paralele dhe kjo pjesë do të jetë fyt i ngushtë për shkak të komunikacionit të dendur. Me një mesatare ditore prej 20.720 kalime të matura në vitin 2007, kjo kalon standardin mesatar për ndërtimin e autostradës, e cila është e arsyeshme nëse në ditë qarkullojnë 12.000 automjete. Rrezikohet humbja e statusit të korridorit ndërkombëtar, kur dihet se korridoret nuk i kanë për qëllim lidhjet ndërurbane, por sigurojnë transport ndërkombëtar, me shpenzime më të ulëta, kohë më të shkurtër, pa ndërprerje të trasesë dhe me kritere të sigurisë së kyçjeve vetëm në vende të parapara. Traseja e re nuk respekton këto standarde.

Studimet e mëhershme kanë pasur parasysh këto standarde, janë studiuar disa variante dhe asnjëra prej tyre nuk ka paraparë ndërprerjen e kontinuitetit të korridorit. Po ashtu është përkrahur varianti pa tunele, pa ndryshuar fare trasenë. Tash si arsyetim për ndryshimin e trasesë përmendet kostoja e ndërtimit. Por, ku është kostoja e shfrytëzimit të saj, korridori prej Dulës kah Malisheva e deri në Prishtinë është i gjatë 43 kilometra, ndërsa prej Dulës nëpër Shtimje e deri në Prishtinë është 31 kilometër, pa tunele.

Pse asnjëherë nuk është krahasuar kostoja e këtyre dy drejtimeve apo është krahasuar, por këtë unë nuk e di. Apo ndoshta ndërtuesi e ka imponuar trasenë e re për shkak të terrenit më të përshtatshëm. Gjithashtu, me këtë devijim nuk respektohet kriteri për qasje të barabartë të regjioneve në Kosovë, në korridoret ndërkombëtare. Regjioni i Gjilanit është izoluar tërësisht. Për fat të keq, ende janë të pranishme edhe plotë dilema e dyshime të tjera. Kurrë nuk është bërë publike e as që është hapur debat rreth studimit të fizibilitetit të autostradës.

Nën dy, kurrë nuk janë bërë publike modalitetet e kontraktimit të punëve, sado që thuhet se për shkak të sekretit afarist që ka konzorciumi Bechtel&Enka, gjërat nuk mund të bëhen publike. Megjithatë, po harrohet se kjo autostradë financohet nga paratë e

tatimpaguesve të Kosovës, ndërkaq Qeveria ka obligim ligjor t'i raportojë tatimpaguesve për mënyrën se si po shpenzohen paratë e tyre.

Në kohën e përkeqësimit të stabilitetit buxhetor, dyshoj se Qeveria do të sigurojë para për financimin e autostradës, apo në të kundërtën, mosinvestimin e autostradës dhe të na fusë në krizë buxhetore shtetin tonë.

A ka Qeveria ndonjë llogari rreth mënyrës së kthimit të këtij investimi, a do të ndodhë kthimi përmes ndikimit të autostradës në përmirësimin afatgjatë të ambientit për biznes, apo ndikimi në zhvillimin ekonomik do të jetë i pranishëm vetëm gjatë kohës së realizimit të saj.

Ndërkaq, nëse autostrada nuk arrin që të reflektojë në ngritjen ekonomike, atëherë ajo do të mbetet vetëm një përmendore e kësaj Qeverie, asgjë më shumë, apo ajo më shumë do të jetë në interes të fqinjëve, të cilët janë ekonomikisht më të fuqishëm dhe me këtë autostradë atyre iu ofrohet edhe një mundësi më shumë për depërtim në detin Adriatik.

Me këtë rast unë do të potencoj edhe disa çështje që duhet të reflektohen në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale të vendit. Është premtuar, edhe pse u cek edhe më herët, se 40% të punëve do të kryhen me kompanitë nënkontraktuese nga Kosova. Në këtë rast, unë po citoj vetëm atë që është thënë publikisht nga zyrtarët e Qeverisë, meqenëse dokumenti kur është prezantuar për opinion. Nëse kjo është e saktë, atëherë kompanitë kosovare do të realizojnë 280 milionë nga kostoja e kësaj autostrade, që thuhet se është 700 milionë. Kjo nuk është shifër për nënçmim, ndonëse kam dyshim se investitori, në këtë rast Qeveria, mund të ndërhyjë dhe kompanisë implementuese t'ia imponojë nënkryerësit të punëve. Por, kërkoj nga Qeveria që t'ia imponojë punëkryerësit, ta respektojë kontratën që 40 përqindëshi të jenë nënkontraktuese firmat kosovare.

Ne do të duhej të ishim të lumtur nëse vërtet gjërat zhvillohen sipas këtij proporcioni, posaçërisht se pos efektit material, kompanitë kosovare fitojnë edhe një eksperiencë të madhe për realizimin e projekteve të mëdha të infrastrukturës, siç është autostrada, por me një kusht që punët të kontraktohen me çmime të arsyeshme. Po ashtu është thënë se këtu do të gjejnë punë 4.000 punëtorë. Edhe kjo është një përparësi e vështruar nga aspekti social mirëpo, për fat të keq, ka ankesa të shumta të atyre që punojnë në këtë punishte, si për kompensimin material, po ashtu edhe për mënyrën e trajtimit të këtyre nga punëdhënësi. Në këtë pikë inspeksioni i punës, por edhe sindikatat duhet të jenë më efikase, të merren me hallet e punëtorëve, mirëpo kyçja e tyre në këtë problem nuk guxon të reflektojë në dinamikën e punëve, por që kompania punëkryerëse të respektojë ligjet dhe standardet e Kosovës. Ajo këtë obligim e ka marrë, edhe me kontratën e nënshkruar, së paku kështu kanë deklaruar zyrtarët qeveritarë.

Dhe, në fund, dhëntë zoti që ky projekt të përfundojë sa më shpejt dhe të ndalen këto debate, se çdo investim që është i mirëseardhur për qytetarët e Kosovës dhe të gjithë qytetarët e Kosovës do ta shfrytëzojnë këtë autostradë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Thaçi, kryeministri, e ka fjalën!

KRYEMINSITRI HASHIM THAÇI: Unë nuk besoj në asnjë rrethanë që ky projekt do të mbetet përmendore premtuese qeveritare, por do të jetë shëmbëlltyrë e kontributit gjithë qytetarë, mbipartiak, interes shtetëror. Në anën tjetër, disa prezantime se gjëja profesionale, nuk janë të sakta dhe burojnë nga mos informimi i duhur, nuk besoj qëllimkeq. Ka qenë, është dhe mbetet prioritet edhe i imi, edhe i Qeverisë së Republikës së Kosovës thellimi i partneritetit me komunitetin e biznesit dhe kjo po ndodh dhe nëse ka investime që shihen në publik dhe më transparente në ndonjë projekt se sa ky i autostradës, unë nuk besoj që ka ndodhur ndonjëherë në Kosovë, por ne do të jemi këtu, do të diskutojmë dhe do t'i përgjigjem çdo pyetje dhe dileme tuaj, por edhe dilemave që ne mund t'i ngrisin për çështje krejt të ndryshme, qoftë edhe për... megjithëse sa i përket kësaj autostrade nuk e kemi as edhe një dilemë. Por, që të kemi informacione edhe më të duhura, unë të nderuar deputetë, të gjitha partive politike ju ftoj, derisa e gjithë bota po viziton dhe po mrekullohet nga ajo autostradë, ta vizitoni edhe ju, deri sa edhe përfaqësuesit e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara e vizitojnë dhe e përgëzojnë Kosovën për këtë projekt, edhe të gjithë ambasadorët e Bashkimit Evropian, atëherë mos dënjoni edhe ju, shkoni e shihni punën në terren, besoni keni për të ndryshuar kuptimin e qasjes më pozitive sa i përket projektit, ose kur të shkoni për Shqipëri për vikende, ndaluni pak, pesë minuta, dhjetë minuta, gjysmë ore... Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Florin Krasniqi e ka fjalën!

FLORIN KRASNIQI: Deputetë, ju lutem, sa herë që kemi këso gjërash të rëndësishme, mos na shndërroni Kuvendin në kanaxheq, të bëni kështu biseda, kundër biseda.

Unë do t'i referohem një faqeje të kontratës, është faqe 2/29. thotë, shprehimisht: “40 milionë i jepen kompanisë turke”, realisht vëllezërve të Hashim Thaçit “për ta prurë makinerinë në Kosovë”. Çka do me thënë kjo? Lihen qindra, ndoshta mijëra makineri të Kosovës, të blera prej kontraktorëve edhe taksapaguesve të Kosovës, lihen të rrinë për të prurë makinerinë prej Turqie... 40 milionë, prej kah i bien ata.

Pika e dytë, atyre iu jepet 1 milionë në muaj dhe po i përdori ato turqizmat që janë pjesë e traditës tanë, me i sajgisë – se janë jabanxhi, me i sajgisë vëllezërit e tij turq. Në asnjë mënyrë, asnjëherë, dua ta bëj një koment, se ky tash çohet e thotë ky është kundër Turqisë. Populli mik turk na u ka gjetur në ditët më të vështira, është popull mik turk, e unë kam shumë respekt për ndihmën që populli mik turk ia ka dhënë Kosovës. Po, jo t'ia japim 40 milionë euro të taksapaguesve të Kosovës e ta lëmë makinerinë e taksapaguesve, të kontraktorëve që këto makineri i kanë blerë me fajde të dhëna prej bankave dhe institucioneve qeveritare. Me fajde! Ka njerëz në këtë Kosovë që kanë blerë makinerinë me 16% interes, me shpresë se një ditë do të punojnë diku, me shpresë se do të gjejnë një punë të vogël, do të jenë në ... kontraktor i kësaj kompanie. 22 vjet punoj punë publike në qytetin më të zhvilluar në botë – Nju Jork, 22 vjet.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! E kreve!

Fjalën e ka deputeti Berat Buzhala!

BERAT BUZALA: I nderuar kryesues,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,

Shumëçka u tha këtu edhe prej kryeministrit dhe prej ish ministrit Limaj dhe mnsitrit Mujota. Një gjë kisha dashur për të kujtuar. Nuk kanë kaluar shumë vite, as shumë qeveri para kësaj, ku shoqëria jonë ishte e izoluar për javë të tëra prej civilizimit, sepse në afërsi të Kaçanikut disa kubikë dhe ishin shembuj dhe kishin bllokuar arterien e vetme përmes së cilës Kosova komunikonte me pjesën tjetër të botës. Ishte kjo një situatë tragjike, sepse edhe bizneset dhe qytetarët ishin dëmtuar jashtëzakonisht shumë. Nuk mund të shkonin as deri në Shkup, por ishte komike ta shihnim një qeveri që përpëllte me disa kolica dhe.

Ne sot këtu në Kuvendin e Kosovës fatbardhësisht nuk po debatojmë, nuk po diskutojmë e as nuk po shahemi për rrugë të bllokuara. Kosova sot si kurrë më parë në histori, është e lidhur me rrugë në mes veti, por edhe me botën. Atë shembullin e asaj rruge të bllokuar me disa kolica dhe, kjo Qeveri por edhe të gjithë ne të tjerët duhet ta harrojmë sa më shpejt. Ai model i qeverisjes çfarë ka qenë, nuk guxon të merret si krahasim e me gjasë as nuk po merret.

Mund të diskutojmë këtu gjerë e gjatë nëse çmimet e ndërtimit të rrugëve kanë qenë apo jo konkurruese, mund të diskutojmë nëse kualiteti i rrugëve është më i mirë i mundshëm, mirëpo një gjë nuk mund të diskutohet – prej vitit 2008 kur Partia Demokratike e Kosovës, fillimisht me Lidhjen Demokratike të Kosovës, e tash me Aleancën për Kosovën e Re, nuk do ta bllokojë më qytetarin e Kosovës. Në vendin tonë ka zbarkuar kompani elite botërore, si kompania Bechtel&Enka, mirëpo këtu po ndodhin edhe çudira edhe marrëzira në të njëjtën kohë. Sa më shumë që po i afrohet dita kur njëri prej segmenteve të “Rrugës së kombit” do të përfundojë dhe kësisoj përfundimisht Shqipëria dhe Kosova do të lidhen me njëra - tjetrën në mënyrën më moderne të mundshme, aq më shumë po shtohet nervoza.

Unë nuk e di se si do të përjetohet prerja e shiritit. Si gazetar pata shkruar dhe pata kritikuar para disa vitesh subjekte të caktuara politike në Shqipëri që e sulmonin kryeministrin e atjeshëm, Sali Berisha, për mënyrën se si po e ndërtonte “Rrugën e kombit” në pjesën shqiptare. A nuk po ju duken sulmet që po bëhen kundër kryeministrit Thaçi dhe të gjithë atyre që e udhëheqin projektin, të njëjta. Këtu ndryshojnë vetëm emrat e sulmuesve dhe të të sulmuarve.

Nën flamurin e transparencës financiare po provohet të hidhet në ajër një projekt që para se gjithash është interes nacional. Nëse qëllimi i kritikave është mbrojtja e buxhetit të vendit nga abuzimet potenciale, atëherë pse nuk ndiqen rrugë të tjera për ta bindur Qeverinë që ta publikojë këtë kontratë. Ky vend ka edhe ligje, edhe gjykata. Do të ishte në interesin e të gjithëve, para se gjithash në të mirën e qytetarëve që për interesa të dyshimta politike të mos njolloset projekti më kapital që ka ndodhur ndonjëherë në vendin tonë. Mirëpo, sipas të gjitha gjasave, ky është çmimi që duhet ta paguajnë

projektet e mëdha dhe ky është çmimi që duhet ta paguajnë edhe realizuesit e këtyre projekteve. E rëndësishme është që karvani të ecën dhe të mos ndalet prej zhurmës eventuale që vjen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën, nënkryetar i Kuvendit! Një minutë e gjysmë!

SABRI HAMITI: Ka qenë aktive partia, ma ka lënë vetëm një minutë e gjysmë, po s'është me rëndësi.

Unë, zoti kryeministër, do të jem konkret, pyetje shumë shkurt. Në kontratën tuaj, sepse unë e kam parë një tekst, që më duket “Vetëvendosja” e ka vë në kutitë tona, në kontratën tuaj a është kontrata për rrugën Morinë – Merdar, nëse thuhet Merdare, s'është, se është sllavisht, shqip është Merdar, apo është kontratë për Morinë-Prishtinë? Në të dyja rastet, sa kilometra i ka ajo rrugë dhe sa është pazari për të?

E dyta, nëse ka devijuar rruga te Malisheva dhe vjen te Orllati, a e mendoni rrugën Orllat - Prishtinë këtë ekzistuese me Pejën, që do të jetë një tip zëvendësimi i trasesë së planifikuar në fillim dhe sa kilometra mendoni që i merrni këtu, domethënë.

Dhe, e treta, në kontratën tuaj, Bechtel & Enka a shkon sipas trasesë së dizajnuar, të vizatuar, apo rrëmihë e masandej e bën planin mbas rrëmihjes? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ramiz Lladrovci! Më fal, Ramiz! Kryeministri po e dëshiron fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar zoti Hamiti...

(Ndërhyrje, S. Hamiti: Jo, vetëm përgjigjen!)

Mirë de, po u bërë inxhinier prej kritikut letrar! Kjo, mirë! OK! OK!

(Ndërhyrje)

Është korridori Morinë, në drejtim të Merdares. Deri në Merdar, natyrisht.

(Ndërhyrje)

Nuk e di a i bie nëpër fshatin tuaj në Dumnice, duhet ta shikojmë.

(Ndërhyrje)

Nuk e di, por do të përfitojë e gjithë Kosova. Ndërsa, sa i përket angazhimeve tjera, ne kemi diskutuar edhe më herët, por nuk ishte prezent, prandaj unë qëndroj në ato qëndrime që i prezantova gjatë tërë ditës sot këtu. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamiti, replikë dy minuta!

SABRI HAMITI: Përgjigjet nuk i mora, por unë megjithatë kam respekt për kryeministrin dhe ma merr mendja, pa stilizime, qysh i bëra konkrete, një herë tjetër do t'i dëgjojmë përgjigjet në këto pyetje.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ramiz Lladrovci e ka fjalën!

RAMIZ LLADROVCI: I nderuari nënkryetar,
I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Sqarimet rreth kontratës së lidhur me konzorciumin Bechtel&Enka për autostradën Vermnicë – Merdar, si një kontratë mjaft e përfolur nga opozita në të gjitha këta muajt janë të domosdoshme dhe mendoj se kërkesa për interpelancë ishte e qëlluar.

Mungesa e numrit të deputetëve në seancë apo mungesa e përkohshme e kryeministrit, nuk është justifikim se interpelanca nuk duhet të mbahet.

Mendoj se deputetët duhet t'i adaptohen ritmit të punës së Kuvendit dhe jo Kuvendi t'iu adaptohet atyre. Gjithashtu, shpresoj se kryeministri dhe zoti Limaj e ministri Mujota dhanë sqarime të mjaftueshme dhe të sakta rreth kësaj kontrate shumë të përfolur në të gjithë këta muaj nga opozita.

Normal që secili qytetar i Kosovës ka të drejtë të dijë atë që është kërkuar në këtë interpelancë, sa ka kushtuar kjo kontratë dhe si po realizohet ajo, sepse është një nga projektet më të mëdha të shtetit të Kosovës deri më sot. Andaj, ju ftoj për debat të koncentruar në temën e sotme më shumë se sa fjalë boshe e retorikë politike.

“Rruga e kombit” si të gjitha projektet e mëdha nacionale është përfolur shumë, diku me të drejtë e diku, natyrisht, pa të drejtë e pa argumente nga subjektet e ndryshme politike.

Mendoj se krahas kësaj, ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës do të duhej të përcjellim edhe një mbështetje të fuqishme për këtë projekt gjigant.

“Rruga e kombit” është një arterie qendrore e zhvillimit ekonomik të vendit dhe një linjë e rëndësishme e lidhjes ekonomike dhe zhvillimore të kombit tonë në tërësi, ashtu edhe të kombeve tjera të rajonit.

Andaj, nga kjo foltore do t'ju ftoja, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës nga gjitha taborët politike, që të mos e politizojmë rrugën e madhe të zhvillimit të vendit. Kjo nuk do të thotë që të mos ketë debate për këto tema të mëdha, por mendoj se nuk do të duhej t'i banalizojmë debatet e tilla.

Gjithashtu, fjalori i diskutimeve për rrugën të mos shndërrohet në fjalor rruge e debati të ruaj nivelin e tyre, duke pasur parasysh se po flasim për një projekt më jetik të vendit.

Sot nga kryeministri i vendit, po e përsëris, edhe nga zoti Limaj e ministri Mujota dëgjuam argumente të sakta rreth këtij projekti, kurse nga ju, kolegë të nderuar, pres të dëgjojmë debate të qytetëruara, sepse po flasim dhe po trajtojmë një projekt që është rruga e zhvillimit dhe e qytetërimit të mëtejshëm evropian të shqiptarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Hamza e ka fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Unë do t'i qasem këtij problemi nga këndi ekonomik. Na ka rënë rasti të dëgjojmë se ky projekt ka arsyeshmëri, e tjera, e tjera, mirëpo nuk ka arsyeshmëri ekonomike. Dua t'ua jap një të dhënë zyrtare, që krahasuar me periudhën deri sa është kryer njëra pjesë e këtij projekti, që është në pjesën e territorit të Republikës së Shqipërisë dhe situata tani kemi një rritje të qarkullimit të mallrave në pikën kufitare të Vërmnicës për 130% dhe kjo është një indikator që tregon se ka ulë koston e bizneseve, se bizneset i ka orientuar t'i shfrytëzojnë portet e Shqipërisë dhe sigurisht se kjo do të ndikojë në rritjen e profitit për bizneset.

Përmes investimeve në këtë projekt ka ardhur edhe deri te ngritja e investimeve kapitale. Vetëm viti 2011, në krahasim me vitin 2010, pritet që të ketë 26% rritje të investimeve kapitale. Përmes rritjes së investimeve kapitale do të ketë rritje ekonomike, përmes rritjes ekonomike do të ketë edhe gjenerim të punësimit.

U tentua, se nuk mund të ngatërrohen, mirëpo u tentua që të përzihet kostoja e ndërtimit të rrugës me koston totale të projektit, që përfshin edhe shpronësimet. Janë gjëra të ndara.

U përmend Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. Sa i përket relacioneve me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe këtij projekti, buxheti i rishikuar i vitit 2010, dua t'ju rikujtoj, ka qenë në harmoni dhe përputhshmëri të plotë dhe plotësisht i harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe ky projekt ka qenë pjesë e buxhetit të vitit 2010.

U përmend çështja e financimit. Është situatë jashtëzakonisht e mirë, edhe pse s'është e lehtë, pse ky projekt ka mundësi që të ndërtohet nga të hyrat e rregullta të buxhetit të Kosovës, nga buxheti i Kosovës, të gjithë pajtohemi, që mbushet me taksat e të gjithë qytetarëve të Kosovës. Janë taksat e tyre. Prandaj, nuk ka kredi, nuk ka ngarkesë me kamata shtesë, të cilat kishin për të rrjedhur për financimit të këtij projekti.

U përmend transparenca. Ky projekt, që është projekti më i kushtueshëm në historinë e Kosovës, është pjesë e tabelave të buxhetit, është pjesë e Ligjit të buxhetit, një dokument i cili është publik dhe i cili është aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Shpenzimet të cilat ndodhin për këtë projekt janë shpenzimet e raportuara në raportet të cilat Ministria e Financave është e detyruar t'i hartojë dhe publikojë, dhe këto të dhëna se

sa janë shpenzuar para për këtë projekt, janë të dhëna publike, janë pjesë e raporteve edhe vjetore, edhe periodike të cilat aprovohen në këtë Kuvend.

Dhe dua, krejt në fund, të theksoj se për vitin 2010, janë paguar 107 milionë euro, deri më tani janë paguar 105 milionë euro dhe nuk ka pasur asnjë mosmarrëveshje në mes punëkryerësit dhe punëdhënësit sa i përket çështjes së pagesave dhe çështjeve tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë, nuk ka kohë për një pjesë të deputetëve të Partisë Demokratike që kanë mbetur pa diskutuar, sepse është shpenzuar minutazhi. Të tjerët e kanë shpenzuar, kanë mbetur dy grupe të cilat nuk janë paraqitur të flasin. Tani, sipas Rregullores e ka fjalën kryeministri dhe më vonë përfaqësuesi – propozuesi i interpelancës. Zoti Thaçi, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryesues Haliti!

Faleminderit prej të gjithë deputetëve për debatin konstruktiv dhe besoj frytdhënës, megjithëse kishe nganjëherë edhe ngatërresa vërtet më profesionale, që më tepër kanë krijuar huti, se sa ndonjë qartësi.

Unë dëshiroj edhe një herë të sqaroj dhe ritheksoj fuqishëm se kjo është një kontratë ndërkombëtare, sipas standardeve ndërkombëtare dhe jo e nivelit lokal, është projekti më i rëndësishëm në historinë e Kosovës dhe më i madhi në historinë e Kosovës, është projekti i meritës dhe vlerës së gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, është projekti i munguar, është projekti që distancon të kaluarën e errët të Kosovës dhe hap perspektivën për të ardhmen zhvillimore dhe integruese të Kosovës, është projekt transparent plotësisht i konkurrencës së lirë dhe fillimisht kanë qenë shumë konzorciume që kanë marrë pjesë në proces, pastaj ka qenë lista e ngushtë dhe natyrisht me meritë të plotë është shpallur fitues konzorciumi Bechtel&Enka si konzorciumi më i lirë, më i mirë dhe një konzorcium shumë prestigjioz ndërkombëtar botëror.

Prandaj, nuk dua të bëhen nga asnjë anë ngatërresa, që disa vlerësime të niveleve lokale të pretendohen të nxirren edhe vlerësime të projekteve të nivelit ndërkombëtar. Projekti i ndërtimit të autostradës do të jetë një projekt që do të përmbyllet nga ana jonë në Merdar, ndërsa do të punohet me intensitetin e planifikuar, e theksova edhe më herët, tani jemi rreth 12 muaj para planit për shkak të angazhimeve të shumanshme dhe të gjitha kapaciteteve të konzorciumit dhe të nënkontraktorëve lokalë. Do të vazhdojë të mbetet prioritet i rëndësishëm partneriteti për inkorporimin e komunitetit të biznesit vendor në këtë projekt madhor sipas kontratës së nënshkruar nga autoritetet përkatëse.

Në anën tjetër, do të vazhdohet që për projektin Prishtinë – Shkup të punohet intensivisht dhe të përmbyllet me kohë edhe shprehja e interesit, edhe shpallja e fituesit, edhe fillimi i punimeve.

Ndërsa, në fund, më lejoni përsëri t'ju falënderoj për gjithë këtë korrektësi, natyrisht edhe pyetjet të cilat i keni ngritur, që unë dua të besoj se kanë qenë të sinqerta dhe me interes

për opinionin publik, por në të njëjtën kohë ne do të jemi gjithmonë të përgjegjshëm që të jemi në Kuvend për t'u përgjigjur në gjitha çështjet, ndërsa dua të bëj përsëri një qartësim për të satën herë, sepse ka ngatërrim në qasjet e ndryshme.

Parlamenti i Republikës së Kosovës apo Parlamenti i Kosovës kurrë nuk ka marrë vendim për ndërtimin e autostradës apo të autostradave. Ky është vendim i Qeverisë dhe kur po thuhet nganjëherë është devijuar nga vendimi i Parlamentit, kjo nuk qëndron. Kemi diskutuar në Parlament, por vendim nuk kemi dhe ky është realiteti.

Krejt në fund, unë ju ftoj që së paku në 40 kilometërshin e parë që do të përmbillet në fund të tetorit apo në fillim të nëntorit, do të varet edhe nga koha, por nëse bie shi, mos na akuzoni neve si Qeveri, së paku, të marrim pjesë të gjithë të bashkuar, sepse është rruga e të gjithëve. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas Rregullores, fjalën e ka propozuesi i interpelancës, pesë minuta i keni afat, zoti Visar!

VISAR YMERI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Pas debatit që e pamë sot këtu në këtë interpelancë të kërkuar nga Lëvizja "Vetëvendosje" për çështjen e autostradës, më duhet edhe një herë që ta rikapituloj këtë rikonfirmim që ia bëri kryeministri asaj që ne e kemi thënë përherë për Qeverinë e tij dhe për të, që janë absolutisht jo serioz dhe të pa përgjegjshëm ndaj qytetarëve të Kosovës, ndaj Kuvendit të Kosovës dhe ndaj mënyrës se si këta veprojnë dhe keqpërdorin apo i përdorin paratë publike. Pra, edhe këtu e pamë se kishte interes kryeministri që më shumë ta devijojë debatin në çështje tjera, të cilat nuk ishin temë e interpelancës, se sa për interpelancën dhe ky hezitim apo ngurrim i tij që të debatojmë për interpelancën ashtu siç duhet, pra për tri orë, tregon se ka shumë për të fshehur.

Po ashtu, kryeministri e konfirmoi edhe një gjë tjetër, që e thashë unë në fillim të fjalës time, pra që e ka një gjendje, të them ashtu, patologjike për ta shtrembëruar përherë të vërtetën. Nëse e keni lexuar tekstin që e ka paraqitur Lëvizja "Vetëvendosje" për interpelancë, askund nuk përmendet fjala "ndërprerja e ndërtimit të autostradës", ndërkohë që ti dy herë e the se ne kërkojmë ndërprerjen e autostradës apo ndërprerjen e ndërtimit në autostradë. Pra, kjo tregon që thjeshtë ose nuk kuptoni çka lexoni, ose nuk e keni aftësinë për të riprodhuar atë që e lexoni dhe atë që e dëgjoni drejt.

Po ashtu, Bechteli nuk është investitor, por përfitues dhe ka dallim shumë të madh ekonomik në këtë që po e thoni, kryeministër.

Për sa i përket transparencës. Pra, disa herë është thënë këtu që projekti është më transparent, që është zbatuar ndonjëherë në Kosovë. Po, kur flitet për transparencën, veçanërisht nga ministri Thaçi, vërtet është vështirë të kuptohet se çka mendon ky me transparencë. Nëse me këtë mendon se projekti për të cilin po flasim është, shihet dhe është duke u zbatuar, atëherë ky prapë po e jep një përgjigje e cila nuk i është kërkuar. Askush kurrë nuk e ka vë në dyshim nëse autostrada ka filluar të ndërtohet dhe askush

kurrë nuk e ka vë në dyshim që ajo është duke u ndërtuar. Po, nuk është kjo transparenca e cila po kërkohet këtu.

Transparenca e domosdoshme në këtë rast apo në secilin rast të shpenzimeve dorëshlira të parasë publike, nuk është fakti që projekti po zbatohet, por çfarë është ai dhe si po zbatohet. Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës është jashtëzakonisht jo transparente. S'e kanë publikuar kontratën, s'e kanë publikuar as edhe një dokument të vetëm që ka të bëjë me për zgjedhjen e kompanisë në periudhën kontraktuese, negociatat me Bechtel&Enkën, komunikimi me kompaninë e VSH-së e dokumente tjera të rëndësishme për këtë projekt. Pra, këtu disa herë kryeministri e përmendi që nuk jeni të informuar për këtë çështje. Po mirë, ne këtë po e kërkojmë, na informo, silli dokumentet që t'i shohim, të jemi të gjithë të informuar. Nuk është këtu çështja a është kontratë ndërkombëtare apo nuk është kontratë ndërkombëtare.

Neni 120 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të cilën e keni miratuar ju vetë, thotë që shpenzimet publike dhe mbledhja e të hyrave publike duhet të bazohet në parimet e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparencës. Askund këtu nuk përjashtohen kompanitë ndërkombëtare. Pra, pse po i përjashtoni.

Për fund, unë ju bëj thirrje që këtë mocion të interpelancës ta votoni për shkak se ky është i rëndësishëm në shumë aspekte për qytetarët e Kosovës, po veçanërisht është i rëndësishëm edhe për Kuvendin e Kosovës.

Ne po e shohim dhe Qeveria na e ka dëshmuar disa herë, e edhe me këtë rast, që përdorimi i parasë publike ose kur vjen puna te përdorimi i parasë publike, këta janë jashtëzakonisht të pa përgjegjshëm ndaj qytetarëve, ndaj të drejtave dhe interesave të tyre.

Prandaj, është e domosdoshme që Kuvendi ta mbajë këtë përgjegjësi dhe ta disiplinojë Qeverinë në këtë drejtim. Rrjedhimisht, në bazë të nenit 44 paragrafi 4 pika d) të Rregullores së Kuvendit, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” i fton deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës të votojnë mocionin me rekomandimet në vijim, janë katër sosh, shumë të thjeshta dhe po i lexoj shpejt e shpejt.

1. Qeveria e Kosovës të publikojë menjëherë gjithë dokumentacionin në lidhje me autostradën Morinë – Merdar, posaçërisht të gjitha rekomandimet dhe këshillat e kompanisë këshilluese EVERSHEDES, rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare financiare, si dhe procesverbalet e negociatave të Qeverisë së Kosovës me konzorciumin në fjalë.
2. Kuvendi i Kosovës ta angazhojë një grup ekspertësh për vlerësimin dhe rishikimi në kontratës që do t'i japë rekomandimet e veta brenda 30 ditëve.
3. Komisionet përkatëse të mbajnë dëgjime publike me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë për të vlerësuar detajet e ndryshme të kontratës.

Në bazë të rekomandimeve të këtyre komisioneve dhe të grupit të ekspertëve Qeveria e Kosovës të kërkojë menjëherë rishikim të kontratës në seksionet e mbetura të autostradës, posaçërisht në pjesët e kontratës që e dëmtojnë interesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës siç janë çmimet për njësi, nënkontraktimi i kompanive vendore, pagesat dhe të drejtat e punëtorëve të punësuar nga Bechtel&Enka dhe çështje tjera që u ngritën këtu.

Për këtë rishikim, Qeveria duhet të raportojë para Kuvendit në afat prej 90 ditësh nga aprovimi i këtij mocioni, dhe

4. Për shkak të rrezikut fiskal që i kanoset Republikës së Kosovës, Qeveria e Kosovës të raportojë çdo tre muaj para Kuvendit të Kosovës për shpenzimet dhe pagesat në lidhje me autostradën, si dhe të prezantojë plane për tre muajt e radhës për sa i përket këtij projekti.

Ju ftoj që ta votojmë këtë mocion për shkak se ky mocion e fuqizon Kuvendin karshi Qeverisë dhe karshi duarve të lira që tash i ka Qeveria për t'i keqpërdorur paratë publike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas të dhënave që i kemi, kohën e kanë shpenzuar të gjithë deputetët. Në sallë nuk ka deputetë të mjaftueshëm për votim, po presim që...

Atëherë, në sallë kemi 61 deputetë, që është kuorum i mjaftueshëm për votim. Ju lus, ju pa kartelë pastaj votoni, veç tregoni “për” apo “kundër”. Po ne kështu vizuelisht e kemi bërë numërimin, edhe pse këtu prezent po thotë se janë 64 me kartela, por si duket i kanë harruar kartelat. Prezenca fizike është 61 deputetë në sallë.

Mundësia me konstatua kush s’është, e imja nuk është. Po them, me këtë tabelën që e kam përpara, prandaj ju lus që të përgatitemi për votim dhe votojmë tani.

(Ndërhyrje)

A një nga një po doni! Bën edhe ajo.

(Reagime, sugjerime)

Atëherë, ju i dëgjuat propozimet e Lëvizjes “Vetëvendosje”, që e ka propozuar Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” mocionin. Po vazhdojmë me votimin një nga një. I kemi katër propozime.

(Ndërhyrje)

Si? OK. Atëherë, e juaja është që të vendoset, nuk vendoset e jona. Atëherë, votojmë në bllok për të gjitha katër pikat e mocionit të Grupit Parlamentar. Përgatitemi për votim, votojmë kush është për pikat e propozuara të mocionit dhe kush është kundër. Lus regjinë të bëhemi gati, votojmë tani:

Sa janë pa kartelë? Tre. Jeni “për”, apo “kundër”? Jeni “për” mocionin apo “kundër” mocionit?

Atëherë, me ngritje dore, kush është “për” nga këta që s’kanë kartelë, janë tre veta pa kartelë.

Asnjë!

Kush është “kundër”? 4.

Atëherë, konstatoj që propozimi nuk miratohet. Janë 35 vota “kundër”, 1 “abstenim” dhe 19 vota “për”.

Mendoj se kjo pikë e rendit të ditës u krye. Kemi edhe katër shqyrtime të para të ligjeve. A doni të shkojmë në pauzë? Atëherë, shkojmë në pauzë dreke deri në 15:30.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Atëherë, të nderuar deputetë, besoj që keni kaluar në drekë mirë! Po vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës. Edhe pse kuorum të mjaftueshëm për votim nuk ka, ne do t’i lexojmë dhe do t’i diskutojmë projektligjet me qëllim që në fund të seancës së sotme t’i votojmë një nga një të gjitha. Dhe, në qoftë se s’ka kuorum, prapë e lëmë për seancën e ardhshme votimin.

Pra, vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dizajnin industrial

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime për shqyrtim, në parim.

Ftoj ministrin Blerand Stavileci, që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti Stavileci, e keni fjalën!

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të paraqes shkurtimisht arsyet për ndryshimin e Ligjit për dizajnin industrial.

Zyra e pronësisë industriale e Republikës së Kosovës, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës ligjore për ndërtimin e një sistemi efikas për sigurimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në Republikën e Kosovës, sistem i cili ka në qendër të tij mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të pronës intelektuale, përkatësisht asaj industriale, në këtë raste, ka hartuar dhe paraqet për miratim Projektligjin për dizajn industrial.

Megjithëse në sferën e mbrojtjes së pronës industriale në Republikën e Kosovës janë arritur përparime të mëdha, në ligjin aktual janë vërejtur disa mangësi sa i përket zbatimit dhe mbrojtjes së të drejtave të dizajneve industriale dhe harmonizim jo i plotë i ligjit aktual me standardet e BE-së në këtë sferë, prandaj duke u nisur nga kjo, është hartuar ky projektligj i ri për dizajnin industrial.

Ky projektligj është hartuar në bazë të direktivave evropiane dhe marrëveshjeve e konventave ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë në nivel më të gjerë.

Me Projektligjin e ri është thjeshtuar procedura e regjistrimit të dizajneve industriale, që përbën një lehtësi për biznesin, sepse është eliminuar vlerësimi i shkallës së risisë dhe karakterit individual të aplikacionit për regjistrimin e dizajnit industrial.

Janë përcaktuar qartë dispozitat që kanë të bëjnë me aplikimet nga pronarët e jashtëm dhe dispozitat të cilat kanë të bëjnë me regjistrimi ndërkombëtar të dizajnit industrial, të cilat do të hyjnë në fuqi nga dita e pranimi të Republikës së Kosovës në Marrëveshjen e Hagës.

Janë ndryshuar dhe përmirësuar dispozitat për dizajnin industrial dhe aplikimet e tyre, si objekte të pronës industriale e që kanë të bëjnë me të drejtën e transferimit të licencimit, dizajnit si objekt i pengut, konfiskimit dhe falimentimit.

Gjithashtu, Projektligji përmban dispozita të reja sa i përket zbatimit të të drejtave të dizajnit industrial dhe procedurat civile-juridike për mbrojtjen e tij, të cilat janë në përputhje të plotë me direktivën e zbatimit të BE-së, që përbën ndryshim pozitiv nga ligji aktual.

Ndikimet e pritura nga hyrja në fuqi dhe zbatimi i Ligjit për dizajnin industrial janë të natyrës pozitive, sepse harmonizimi i ligjeve nga sfera e pronësisë industriale me direktivat e BE-së do të ndikojë në lehtësimin e procesit të anëtarësimit të Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare të sferës së pronës intelektuale.

Të nderuar deputetë,

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji dhe me qëllim të zbatimit dhe mbrojtjes së të drejtave të dizajnit industrial nëpërmjet të avancimit të infrastrukturës ligjore në lëmin e pronësisë intelektuale në përgjithësi, ju rekomandoj që këtë projektligj ta shqyrtoni dhe miratoni në këtë seancë. Faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani, të nderuar deputetë, pas prezantimit të ligjit nga ministri, hapim diskutimin. Fjalën e ka kryetari i Komisionit funksional për Zhvillim Rural, Ekonomi, Infrastrukturë, Tregti, Industri, deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Zhvillim, Ekonomi, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 28.6.2011, shqyrtoi në parim Projektligjin për dizajn industrial dhe pas shqyrtimit në parim ka vlerësuar se

Projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim, në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të grupeve parlamentare, të Grupit Parlamentar të PDK-së, prapë Zenun Pajaziti, besoj të njëjtën gjë do ta thuash edhe për këtë.

ZENUN PAJAZITI: Është pak më ndryshe, zoti kryesues! Faleminderit shumë!

Zyra e pronësisë industriale në Kosovë, sikurse edhe zyrat homologe të shteteve në regjion, kanë nevojë për t'i përmbushur disa detyrime nga direktivat që dalin nga legjislacioni dhe institucionet përkatëse të BE-së. Po ashtu, edhe përmbushin detyrimet në kuadrin e anëtarësisë të Zyrës së pronësisë industriale të Kosovës në organizatat botërore të pronësisë industriale..., prandaj përmes këtij ligji, unë mendoj që tashmë veç krijojmë kushtet dhe bëhet eliminimi i mangësive ekzistuese që ekzistojnë në këtë fushë. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet në parim këtë projektligj dhe do të angazhohemi maksimalisht që të jetë sa më shpejt i aprovuar dhe me kohë në dispozicion të institucioneve që e zbatojnë këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,

Të nderuar ministra,

Sfera e pronësisë industriale, pjesë e së cilës janë edhe dizajnet industrialë, paraqet njërën ndër sferat më të rëndësishme të ekonomisë, e në veçanti në fushën e mbrojtjes së investimeve.

Aktualisht kjo sferë është e mbuluar me Ligjin për dizajnin industrial të vitit 2005. Jemi të vetëdijshëm se periudha pesëvjeçare, implementimi i këtij ligji ka vërtetuar mangësitë, të cilat besojmë se do të evitohen me projektligjin e ri, i cili hapë rrugë për implementimin e direktivave evropiane të pronësisë industriale dhe të cilat do të mundësojnë qasje më të lehtë në mbrojtjen e pronës industriale në Kosovë.

Projektligji për dizajnin industrial duhet të krijojë kushte më të favorshme për mbrojtjen dhe regjistrimin në Zyrën për pronësi industriale, si dhe mirëmbajtjen e pronësisë industriale, në mënyrë që të ecët më tutje në përmirësimi në klimës së biznesit, si parakusht për investime, qofshin ato vendore apo të huaja. Avancimi i infrastrukturës ligjore në këtë fushë ka ndikimin e vet praktik në identifikimin dhe eliminimin e produkteve të falsifikuara, të cilat dëmtojnë rëndë jo vetëm konsumatorin, por edhe zhvillimin ekonomik.

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë dhe duke marrë parasysh se edhe legjislatura e kaluar e ka shqyrtuar një herë këtë projektligj dhe e ka miratuar, Grupi Parlamentar i LDK-së në parim e përkrah dhe kontributin e vet do ta japë në komisionet parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e përkrah në parim këtë ligj, duke pasur parasysh rëndësinë që ka mbrojtja e të drejtave apo të dizajnit industrial. Natyrisht që kontributin tonë do ta japim nëpër komisionet përkatëse që do të merren me shtjellimin e këtij ligji, por fillimisht vetëm kisha dashur të cek rëndësinë që ka dizajni industrial dhe veçanërisht mbrojtja e tij për ekonominë e vendit dhe veçanërisht për prodhimin në vend. Pra, është e domosdoshme që të sigurohemi që ky ligj do ta mbrojë, ashtu siç duhet, prodhuesin vendor dhe jam nga pak skeptik për këtë tendencë të aprovimit të ligjeve në Kosovë, të cilat përherë i barazojnë prodhuesit e jashtëm me ata vendorë dhe, në të vërtetë, me qenë se jemi në këtë gjendje ekonomike në çfarë jemi, duhet sa herë që dizajnojmë ligje dhe përpilojmë e miratojmë ligje, duhet ta kemi në fokus dhe t’i japim rëndësi të veçantë prodhuesit vendor dhe interesave të prodhuesit vendor.

Për sa i përket dizajnit industrial, këtu në Kosovë ky do të aplikohet fillimisht në shumë pak raste, meqenëse kemi shumë pak industri, mirëpo natyrisht që ligji nuk duhet të shikohet vetëm në efektet e tij të menjëhershme apo afatshkurtra, por edhe në ato afatgjata. Është e rëndësishme që Kosova të jetë pjesë e komunitetit ndërkombëtar që merret me këtë çështje dhe shpresoj se ky ligj do ta hap këtë rrugë për Kosovën, por duhet po ashtu ta kemi parasysh që ato dëme të mundshme që mund t’i vijnë ekonomisë së Kosovës nga përpilimi i dobët i një ligji, duhet t’i shmangemi doemos për shkak se po e shohim që me këtë tendencë të fshehtësisë dhe të njëjtshmërisë së të gjithë akterëve në treg, zakonisht ata që veprojnë në Kosovë dhe ata që mund t’i sjellin përfitime Kosovës, po humbin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, Grupi Parlamentar i AAK-së, deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe ne si Grup Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrahim në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Selmani!

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Koalicioni për Kosovën e Re e ka shqyrtuar Projektligjin për dizajnin industrial dhe duke marrë parasysh se ky projektligj është në Raportin e progresit 2010 dhe paraqet pengesë direkte për klimën e bizneseve dhe ardhjen e investimeve, njëkohësisht edhe mbrojtjen e konsumatorëve, ku në këtë projektligj janë paraparë edhe disa direktiva të BE-së, Koalicioni për Kosovën e Re e përkrah në parim Projektligjin dhe gjithë kontributin për këtë projektligj do ta japim në komisionin parlamentar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! SLS, deputeti Milosavljeviq!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

I Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke razmotrila je Nacrt zakona o industrijskom dizajnu i mi u načelu podržavamo ovaj zakon.

KRYESUESI: Faleminderit! “6+”, deputeti Damka!

FIKRIM DAMKA: Sayın meclis başkanı,

Kosovada ekonominin hızlı gelişmesinin sağlamak açısından ve burda yatırımcının güvenli bir şekilde çalışmalarını sağlamak üzere getirilen yasalar arasında önemli bir yere sahip olan Sanayi tasarım yasasını dikkatle incelediğimiz belirtmek istiyorum.

Yasa kosovada çalışan ciddi şirketlerin kendi üretmiş oldukları ürünlerin tasarımının kendi haklarının içerisine almaları ve piyasada ürünün tek bir şirkete ait olduğunun belirlenmesi son derece yatırımcılar açısından öneme sahiptir.

Bu şekilde şirketlerin daha fazla yeni tasarımları ortaya koymaları için hukuksal zemin yaratırken bu tasarımlara ve Ar-Ge ayrıcalıklı miktarların artacağına inanmaktayız

Yasanın bazı maddelerinde değişiklikler ile ilgili tekliflerimizi komisyona ileteceğimizi bildirirken 6+ PG adına kanun tasarısını desteklemekteyiz.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, votimin e lëmë për në fund. Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të dritës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për patenta

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim, në parim. Ftoj ministrin Blerand Stavileci, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit, edhe një herë, i nderuari kryesues!

Të nderuar dhe të çmuar deputetë,

Objektivat e Qeverisë së Kosovës për ngritjen e një mekanizmi efektiv për mbrojtjen e pronës intelektuale, gjegjësisht të asaj industriale me qëllim të harmonizimit të plotë të ligjeve që rregullojnë mbrojtjen e pronës industriale me standardet më të larta të BE-së, para jush paraqesim miratimin e këtij ligji, i cili përbën tri nga ligjet bazale të pronësisë industriale.

Ky ligj është hartuar në bazë të direktivave evropiane dhe të marrëveshjeve e konventave ndërkombëtare që rregullojnë sferën e pronës industriale.

Projektligji i ri thjeshtëson dhe lehtëson procedurat e regjistrimit të patentave. Licenca e detyrueshme është rregulluar me dispozita të cilat janë në harmoni të plotë me aktet ndërkombëtare, ku caktohet organi kompetent për dhënien e licencës së detyrueshme. Janë vendosur dispozitat të cilat kanë të bëjnë me shpikjet sekrete dhe procedurat e regjistrimit të tyre. Është specifikuar qartë me dispozita aplikimi me pronarë të jashtëm, të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi i patentave në Zyrën e pronësisë industriale të Republikës së Kosovës.

Dispozitat të cilat kanë të bëjnë me regjistrimi ndërkombëtar të patentave do të hyjnë në fuqi nga dita e aksesimit të Republikës së Kosovës në Konventën Evropiane të Patentave.

Gjithashtu, Projektligji përmban dispozita të reja për sa i takon zbatimit të të drejtave të patentës, procedurat civile-juridike për mbrojtjen e të drejtave të patentës, të cilat janë në përputhje të plotë me Direktivën e zbatimit të BE-së, përfshirë këtu të drejtën e transferimit, licencimit, pengut, konfiskimit dhe falimentimit që përbëjnë ndryshim pozitiv krahasuar me ligjin aktual.

Me hyrjen në fuqi të këtij projektligji, ndikimet e pritura janë të natyrës pozitive sepse harmonizohen plotësisht me ligjet nga sfera e pronës industriale me direktivat e Bashkimit Evropian, lehtësohen procedurat për mbrojtjen dhe regjistrimin e patentës në Republikën e Kosovës, plotësohet një nga vërejtjet e Raportit të progresit për Kosovën dhe ndikon gjatë procesit të anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian dhe në organizatat e tjera ndërkombëtare në sferën e pronës intelektuale.

Të nderuar deputetë,

Edhe një herë, duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji dhe duke pasur parasysh nevojën e avancimit të kuadrit ligjor në lëmin e pronësisë industriale në përgjithësi, propozoj që ky projektligj të shqyrtohet dhe miratohet në parim në këtë mbledhje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të komisionit, zoti Pajaziti e ka fjalën!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Zhvillim, Ekonomi, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar me datën 28.6.2011 në parim këtë projektligj. E ka vlerësuar se projektligji i vlerëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim, në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputeti Pajaziti, besoj.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Aktualisht ekziston një ligj për patenta dhe në bazë të Raportit të progresit të Komisionit Evropian për Republikën e Kosovës për vitin 2010, ku është kërkuar harmonizimi i mëtejshëm i infrastrukturës ligjore të pronësisë industriale dhe në bazë të ekspertëve të

Projektit Asistencë teknike të Zyrës së pronësisë industriale, Projekti i financuar nga Komisioni Evropian në kuadër të Programit IPA për ngritjen e kapaciteteve teknike të institucioneve të Kosovës, është vlerësuar se duhet të hartohet një ligj i ri dhe i cili do të jetë në harmoni me aktet më të larta ligjore të BE-së dhe të plotësojë disa mangësi të cilat kanë ekzistuar në ligjin ekzistues, pra në ligjin në fuq i.

Prandaj, ne jemi të interesuar qetësisht që të punojmë sa më shpejt, me gjithë mbështetjen që e kemi edhe nga institucioni – ministria përkatëse që e ka sponsorizuar, po edhe nga ekspertë të ndryshëm që janë të interesuar dhe janë rreth nesh për të na ndihmuar që sa më shpejt këtë ligj ta kemi, në mënyrë që në raportin tjetër të progresit ta kemi këtë sfidë të eliminuar fare.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do të angazhohet në punën sa më të shpejtë të këtij projektligji, pra në parim ne e mbështesim dhe jemi të zotuar që të punojmë sa më shumë në të. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Zharku e ka fjalën!

LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,

Duke marrë parasysh se pronësia industriale është një nga fushat bartëse të zhvillimit të ekonomisë së një vendi, Grupi Parlamentar i LDK-së beson se zhvillimi dhe ngritja e një sistemi efikas të mbrojtjes së pronës industriale duhet të jetë ndër prioritetet e rëndësishme të institucioneve tona. Në kuadër të ngritjes së këtij sistemi hyn edhe rishikimi dhe përmirësimi i legjislacionit në sferën e mbrojtjes së pronës industriale, me qëllim të harmonizimit të plotë të tij me standardet e BE-së në sferën e pronës intelektuale.

Projektligji i ri thjeshtëson procedurat e regjistrimit të patentave, që paraqet një lehtësi për bizneset, janë rregulluar licencat e detyrueshme të cilat janë në harmoni me kriteret ndërkombëtare të kësaj sfere dhe në këto dispozita është përcaktuar edhe organi kompetent për dhënien e licencës së detyrueshme dhe rastet se kur mund të jepet një licencë e tillë.

Projektligji përmban dispozitat të cilat kanë të bëjnë me shpikjet sekrete dhe procedurat e regjistrimit të këtyre shpikjeve, si dhe janë specifikuar dispozitat që kanë të bëjnë me aplikimet me pronarë të jashtëm të të drejtave që rrjedhin nga regjistrimi i patentave në Zyrën për pronësi industriale.

Po ashtu, Projektligji përmban edhe dispozita lidhur me kushtet që kanë të bëjnë me përfaqësimin e të huajve në procedurat para Zyrës së pronësisë industriale, si dhe regjistrimin ndërkombëtar të patentave.

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar përsëri këtë projektligj, i cili është miratuar edhe nga legjislatura e kaluar dhe në këtë fazë nuk ka vërejtje substanciale, prandaj në parim e përkrah dhe kontributin e vet do ta japë në komisionin funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Ymeri!

VISAR IMERI: Ju faleminderit!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e përkrah këtë projektligj në parim dhe do të angazhohemi në komisionet përkatëse për ndonjë vërejtje eventuale që mund ta kemi në nenet e veçanta specifike të këtij ligji.

Pak a shumë ato vërejtjeje që i thashë për dizajnin industrial, që janë vërejtje më shumë kështu parimore se sa që janë, domethënë, konkrete për ligjin, vlejnë edhe për këtë ligj për shkak të fushës së njëjtë ose pak a shumë të ngjashme që këto e mbulojnë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputetja Haxhiu.

TETUTA HAXHIU: Ju faleminderit, kryetar!

Edhe ne si Grup i Aleancës e përkrahim në parim këtë projektligj dhe do të angazhohemi që punën tonë ta fokusojmë në komisionin përkatës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Koalicioni Kosova e Re, fjalën e ka deputetja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re ka shqyrtuar Projektligjin për patenta dhe duke marrë parasysh se Ligji për dizajnin industrial, Ligji për patentat dhe markat tregtare janë një pako e ligjeve në të cilat ngarkohet Qeveria e Kosovës për çështjen e raportit të Komisionit Evropian dhe duke marrë parasysh rëndësinë e pronës industriale dhe të bizneseve, ngjashmëria dhe harmonizimi i këtyre ligjeve me standardet e BE-së jep mundësinë që ambienti biznesor dhe të gjithë akterët të cilët kanë nevojë për çështjen e patentit, të jenë më të favorizuar me këtë ligj.

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrah në parim Projektligjin dhe kontributin e vet dhe vërejtjet që i ka do të mundohet që në afatin më të shkurtër ky Projektligj të kalojë edhe leximin e dytë brenda seancës plenare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar SLS, deputeti Millosavljeviq.

SAŠA MILOSAVALJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Pročitali smo i izvršili analizu ovog Nacrta zakona. Ovde se radi o jednom veoma jasnom Nacrtu zakona, međutim i ovde su neizostavne primedbe kada je reč o korišćenju

pojedinih izraza ili pak je reč o lošem prevodu, ali Poslanički klub Samostalne liberalne stranke će podržati ovaj Nacrt zakona u načelu.

KRYESUESI: Ju faleminderit! “6+”, deputeti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Sayın meclis başkanı

Kosovada Ticaretin ve ekonominin sağlıklı bir zemin üzerine inşa edilmesi Şirketlerin ve bireylerin kendi bilgilerini ve fikirlerini bir şekilde korumaları açısından yasal düzenlemeler içerisinde Patent yasasının son derece önemli olduğunu görmekteyiz.

Şirketlerin Ar-Ge ayırmış oldukları paranın bir şekilde bu ürünün kendilerine ait olduğunu tasdik etmesini sağlayan bu yasanın bundan böyle şirketlerin araştırmaya ve yeni buluşlara daha fazla önem vereceğinin garantisi olacaktır.

Yasayla ilgili önerilerimizi komisyona iletceğimizi bildirirken 6+ PG adına yasa tasarısının desteklemekteyiz.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur për të diskutuar. Edhe pika e 6 e rendit të ditës votohet më vonë.

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komision funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, zotin Bajram Rexhepi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti Rexhepi, e keni fjalën!

MINISTRI BARJAM AREXHEPI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Më lejoni të prezantoj para jush Projektligjin për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, i sponsoruar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, është hartuar duke u bazuar në Strategjinë legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2011, dhe në pajtim të plotë me Rregulloren e Punës së Qeverisë, numër 01/2007.

Qëllimi i Projektligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera është mbrojtja e njerëzve, kafshëve, pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Fushëveprimi i këtij ligji është menaxhimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, zvogëlimi i numrit të fatkeqësive, parandalimi, si dhe zvogëlimi i numrit të viktimave dhe të pasojave të tjera nga fatkeqësitë e tilla.

Projektligji për mbrojtjeje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera parasheh shfuqizimin e Ligjit nr. 02/L-68 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, i cili është miratuar në Kuvendin e Kosovës më 6 prill 2006.

Arsyeja për hartimin e këtij projektligji konsiston në faktin se Ligji ekzistues për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera nr. 02-68, ka një numër të zbrazëtirave juridike, dhe gjatë zbatimit ka hasur në pengesa të shumta. Arsye primare për hartimin e këtij Projektligji, është edhe fakti se me këtë projektligj, përcaktohet përgjegjësia shtetërore e organizimit të sistemit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, si sistem unik dhe integral shtetëror.

Në ligjin në fuqi ka figuruar Forca e Mbrojtjes Civile, e cila është strukturë e organizuar në kuadër të shtetit dhe si e tillë nuk ka gjetur zbatim për arsye të shumë faktorëve. Kjo strukturë tani me Projektligjin e ri është zëvendësuar me termin: “Struktura për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë”. Po ashtu, me këtë projektligj definohej më qartë detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e organeve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe mënyra e emërimit të organeve përgjegjëse për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, në këtë nivel. Projektligji për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera është harmonizuar me Kushtetutën dhe instrumentet ligjore, të cilat janë pjesë direkte e zbatimit në Republikën e Kosovës, andaj ndryshimet dhe plotësimet në këtë ligj u janë përshtatur rrethanave të reja të krijuara në Republikën e Kosovës.

Hartimi i projektligjit është bërë në pajtim me procedurat e parapara dhe për këtë projektligj janë pranuar edhe deklaratat respektive nga Ministria e Financave dhe Ministria e Integrimit Evropian, në të cilat vërtetohet pajtueshmëria me acquis-communitaire.

Të nderuar deputetë,

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, nevojën e avancimit të kuadrit ligjor në këtë fushë, si dhe duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kërkoj nga ju miratimin në parim të këtij projektligji. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër!

Tani hapim debatin për diskutim në parim lidhur me projektligjin. Në emër të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri, Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputetja Vjollca Krasniqi e ka fjalën.

VJOLLCA KARASNIQI: I nderuari kryesues,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2011, shqyrtoi në parim Projektligjin për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqet këtë:

R E K O M A N D I M

Të miratohet në parim Projektligji për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Tani, në emër të grupeve parlamentare.
Në emër të Grupit Parlamentar PDK-së, deputeti Behar Selimi e ka fjalën.

BEHAR SELIMI: Ju Faleminderit, zoti kryesues!
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike pajtohet me rekomandimin e komisionit funksional që Projektligji për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të miratohen në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputetja Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe ka vlerësuar se është një projekt voluminoz, i përbërë diku nga 122 nene dhe si i tillë është i strukturuar dhe konceptuar bukur mirë në përmbajtje, por ka dallime në versionin shqip-anglisht dhe nuk ka korrektësi gramatikore gjuhësore, ashtu sikurse edhe ligjet tjera, por ne si anëtarë të Komisionit përkatës nga LDK-ja ju ftojme shumë sinqerisht që do të mundohemi që të japim kontributin tonë që ligji të jetë sa më funksional i jetësishëm, ta fuqizojmë atë dhe do të doja me këtë rast t’u heq brengën atyre që brengosen se deputetët deformojnë ligjet, se nuk do ta bëjmë një gjë të tillë ne.

Ky projektligj vlerësohet se nuk do të ketë shtesë administrative, por ka shtesë buxhetore indirekte pasi atakon gjithë shoqërinë kosovare, dhe këto natyrisht ndikime buxhetore që kanë të bëjnë me raste të fatkeqësive natyrore.

Ky Projektligj përcakton mënyrën e menaxhimit të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive tjera, reduktimin dhe zvogëlimin e numrit të tyre, përcakton formën e kompensimit apo edhe masat mbrojtëse. Ne, në parim si LDK do ta miratojmë këtë projektligj, mirëpo do të duhej të lexoj konkluzionet apo përfundimin në këtë projektligj që e jep Ministria e Financave, që thotë: “Departamenti i buxhetit

rekomandon Ministrinë sponzoruese, që në këtë rast është Ministria e Punëve të Brendshme, që të bëjë një vlerësim aq sa është e mundur të kostos së këtij projektligji, për të treguar obligimet që Qeveria pritët të marrë për fatkeqësitë e ndryshme dhe fatkeqësitë tjera. Pa një vlerësim të tillë, ne nuk mund të japim rekomandim pozitiv për aprovim të këtij projektligji, sepse në një anë Qeveria mund të krijojë obligime, e në anën tjetër nuk ka ndarje të qëndrueshme buxhetore, dhe thuhet: “Në fund të fundit, Qeveria mund të përcaktojë që ndarjet nga rezervat e paparashikuara të lidhen me plotësimin e këtyre nevojave dhe nuk mund të përdoren për qëllime të tjera”. Kjo fjali nuk do të duhej të ishte një projektligj të sjellë në këtë Kuvend, “në fund të fundit”, nuk e di kur do të jetë fundi. Sigurisht, Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave do ta dinë se prej çfarë rezervave apo prej cilit fond do të mbulohen kompensimet me rastin e fatkeqësive të ndryshme natyrore apo edhe fatkeqësive tjera. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar këtë projektligj, po ashtu kemi dhënë edhe kontributin tonë në komisionin përkatës dhe si të tillë e përkrahim në parim, duke vlerësuar se është një ligj shumë i rëndësishëm, por gjithashtu njëkohësisht dhe një ligj që kërkon bajagi punë për të ndërhyrë që ky ligj vërtet ta luaj rolin e vet. Njëkohësisht, ky ligj ka shumë nevojë të ndërhyhet edhe në harmonizimin me ligjet tjera, e duke u fokusuar sidomos në Ligjin për mbrojtjen nga zjarri, por si të tillë ne do të japim kontributin tonë në amendamentimin e këtij ligji dhe në parim e përkrahim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar i AAK-së, deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Ju faleminderit edhe një herë, nënkryetar!

Edhe ne, si Grup Parlamentar, e përkrahim Projektligjin për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputeti Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re, në parim e përkrah këtë projektligj dhe, ndërsa deputetët e këtij koalicioni do të mundohen që në komisionin përkatës ta japin kontributin e tyre për vërejtjet eventuale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit”!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Sasha Millosavleviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Kada je reč o ovom Nacrtu zakona, u našoj Poslaničkoj grupi izvršili smo analizu predloženog nacrtu i Samostalna liberalna stranaka, to jest Poslanički klub Samostalne liberalne stranke će podržati ovaj zakon uz načelu.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlametar “6+”, deputeti Kinolli, e ka fjalën.

ALLBERT KINOLLI: Ju faleminderit, i nderuari zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar “6+” ka shqyrtuar me kujdes këtë projektligj mbi mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe pasi që ky projektligj i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit, në parim e miraton këtë ligj, kurse kontributin e saj do ta jap në punën e Komisionit përkatës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Nuk ka të paraqitur të tjerë. Ministër, dëshironi...? Nuk dëshiron as ministri. E lëmë votimin për më vonë. Konsideroj që nuk ka diskutime të tjera.

Pika e tetë e rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për markat tregtare

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim. Ftoj ministrin Blerand Stavileci, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BLERAND STAVILECI: I nderuari kryesues,

Të nderuar deputetë,

Në kuadër të reformës së infrastrukturës ligjore dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale për lehtësimin e shërbimeve për biznesin, kemi hartuar Projektligjin për markat tregtare që ka rol të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit tonë, mbrojtjen e pronësisë industriale, si organi i vetëm në Republikën e Kosovës për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e markave tregtare.

Projektligji për markat tregtare rregullon një fushë të rëndësishme, me të cilën përcakton rregulla për mbrojtjen e markave tregtare, mbrojtjen e shëndetit të popullatës, mjedisit, krijimin e kushteve të favorshme për mbrojtje të investimeve, si vendore, ashtu edhe të jashtme.

Në projektligjin e propozuar specifikohet procedura më e thjeshtësuar për regjistrimin e markave tregtare në territorin e Republikës së Kosovës, pasi që është hequr ekzaminimi

në baza relative i regjistrimit të markave tregtare, i cili do të bëhet vetëm mbi baza absolute të refuzimit të regjistrimit të një marke tregtare.

Element i rëndësishëm i këtij projektligji është që përmban dispozita për zbatimin e të drejtave të markës tregtare, të cilat janë në harmoni të plotë me direktivat e BE-së, e cila ka të bëjë me zbatimin e të drejtave të markave tregtare, të drejtën e përdorimit të një marke të mëhershme tregtare, ku prova e përdorimit të saj mund të kërkohej me anë të kundërshtimit të regjistrimit gjatë fazës së regjistrimit të markës apo të fillohen procedurat për anulimin e një marke të regjistruar tregtare, të cilat dispozita ishin në ligjin e vjetër.

Miratimi i këtij ligji shkon në favor të plotësisht të prioritetit të Qeverisë sa i përket harmonizimit të legjislacionit të vendit tonë me atë të BE-së, do të eliminonte një nga vërejtjet e Raportit të Progresit për Kosovën të viteve 2009 – 2010 dhe ndikimi i tij në tregun e Kosovës do të jetë shumë i madh në eliminimin e produkteve të falsifikuara, të cilat dëmtojnë rëndë jo vetëm konsumatorin, por edhe zhvillimin ekonomik.

Të nderuar deputetë,

Edhe një herë, duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji, ju rekomandoj që ta shqyrtoni dhe miratoni në këtë seancë. Faleminderit, për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Tani hapim debatin për diskutim, në parim.

Kryetari i Komisionit funksional për Zhvillim, Ekonomi, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Zhvillim, Ekonomi, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.06.2011, e ka shqyrtuar në parim këtë projektligj dhe e ka vlerësuar që Projektligji për markat tregtare i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe ia rekomandon Kuvendit për miratim, në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani sipas radhës, kryetarët e grupeve parlamentare ose përfaqësuesit e grupeve. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetja Valbona Dibra e ka fjalën.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për markat tregtare. Projektligji për markat tregtare përcakton rregullat për mbrojtjen e markave tregtare, mënyrën e fitimit të së drejtës së markës tregtare, procedurat për regjistrim, ndryshimet në marka tregtare, ndërprerjen e vlefshmërisë, anulimin e markave tregtare dhe procedura tjera lidhur me marka tregtare.

Qëllimi i Projektligjit për markat tregtare është të përmbush dy funksione të rëndësishme ekonomike reciprokisht të varura, mbrojtja e konsumatorit në identifikimin e burimit të produkteve dhe të drejtën pronësore të bartësve të markës tregtare, duke kufizuar të drejtën e palëve të tjera që të kopjojnë prodhimet e tyre.

Projektligji e përcakton se çdo person fizikë ose juridikë, duke e përfshirë edhe autoritetet e themeluara sipas ligjit publik, mund të jenë pronarë i një shenje tregtare. Projektligji është në harmoni me direktivat e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

Grupi Parlamentar i PDK-së në parim e përkrah këtë projektligj dhe kontributin lidhur me këtë projektligj do ta japë në komisionet përkatëse dhe njëherësh fton edhe kolegët tjerë që ta përkrahin këtë projektligj, në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Zharku.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Projektligjin për markat tregtare. Shihet se kemi një avancim në krahasim me ligjin aktual, i cili është në fuqi dhe është ndier nevoja për ndryshime. Në parim, e përkrahim dhe s’kemi vërejtje substanciale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” përkrah në parim këtë projektligj dhe natyrisht se do të angazhohemi në komisione funksionale për vërejtje që i kemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i AAK-së, deputetja Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Po, kryesues, edhe ne e përkrahim në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Koalicioni për Kosovën e Re e ka shqyrtuar Projektligjin për markat tregtare dhe duke marrë parasysh se unë edhe pak më parë potencova se Projektligji për dizajnin industrial, Projektligji për patentë dhe Projektligji për markat tregtare janë projektligje të cilat janë të harmonizuara me standarde të BE-së për të mirën e biznesit në Kosovë dhe Grupi

Parlamentar për Koalicionin e Re e përkrah në parim këtë projektligj dhe do të mundohet në afatin kohor, në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, ky projektligj të shkojë në leximin e dytë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Millosavleviq.

SAŠA MILOSOVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Naša Poslanička grupa je detaljno poručila ovaj zakon sa svim proratnim dokumentima i objašnjenjima i u načelu podržavamo ovaj nacrt zakona.

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupit Parlamentar “6+”, deputeti Damka.

FIKRET DAMKA: Sayın meclis başkanı

Ticari markalar yasanın, Kosvada gerçekleşen ve bundan böyle gerçekleşecek ticaretin bu yasaya ihtiyaç duyduğunu ve bu yasayla çok geç kalındığını vurgularken dikatlice incelediğimizi de bildirmek istiyorum.

Kosovada bugüne kadar yapılan yatırımların ve gerçekleşen Ticaretin kanundaki eksiklikler nedeniyle ciddi uluslararası firmaların zarar gördüğünü, ve yatırımcıların en başta isminin korunması gerektiğinin altını defalarca cizen bazı ciddi firmaların başka ülkelere yatırımlarını kaydırdıkları bilinmektedir,

Firmaların en doğal hakkı olan kendi marka isimlerinin tescil edilmesinin ve bunun kanunen koruma altına alınmasının, bu şirketlerin hak idaa açısından son derece önemlidir.

Sadece şirketler açısından değil ama aynı zamanda tüketiciler açısından sahte ürünlerin kullanımının da engelleneceği ve tüketicilerin rahat bir şekilde marka bildikleri ürünleri satın alabileceklerini düzenleyen bu yasayla hem ticaretin artacağını hem de güvenli bir tüketici bilinci oluşacağını inamaktayız.

6+ PG bu yasa teklifinin desteklemektedir.

KRYESUESI: Faleminderit!

U kryen grupet parlamentare. Tani e ka fjalën deputeti Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: I nderuari kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në përgjithësi, ky ligj është mjaftë përmbajtësor dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse rregullon çështje të cilat ndërlidhen me marka tregtare, me regjistrimin dhe mbrojtjen e tyre në Republikën e Kosovës. Mirëpo, edhe përkundër asaj që u tha më lartë, unë i kam disa vërejtje të natyrës teknike në këtë projektligj.

Në faqen 18, neni 15, paragrafi 3 të ligjit, fjalia ku thuhet: “Kopja e certifikuar”, duhet të zëvendësohet me fjalinë “kopja e vërtetuar”, kjo për arsye se noterët të cilët i kanë marrë licenca dhe të shpresoj do të fillojnë në vitin 2012, në janar, ata unë certifikojnë por vërtetojnë kontrata.

Në faqe 23, neni 20, paragrafi 1, pjesa e fjalisë: “kur marka tregtare është e përfshirë në falimentimin apo në procedura të ngjashme”, kjo thuhet kështu në ligj, duhet të zëvendësohet me fjalinë. “kur pronari i markës tregtare është i përfshirë në falimentimin apo në procedura të ngjashme”, domethënë se nuk falimenton marka, por falimenton pronari, sepse markat tregtare nuk falimentojnë, edhe një herë po e përsëriti, po mund të falimentojë pronari i saj, natyrisht në qoftë se pronari i saj është shoqëri tregtare që i nënshtrohet procedurave të falimentimit.

Këto vërejtje janë parimore, por të cilat prekin në përmbajtje dhe të cilat përmirësojnë nenet përkatëse, të cilat janë të harmonizuara me ligje të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Edhe pika e tetë e rendit të ditës mbetet që të votohet më vonë.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës, që është:

9. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit të Ndhmës Juridike

Komisioni funksional për Legjislacion ka shqyrtuar Raportin vjetor të Komisionit të Ndhmës Juridike për vitin 2010 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin vjetorë të Komisionit të Ndhmës Juridike për vitin 2010 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Sipas radhës, janë kryetarët e komisioneve funksionale, në këtë rast do të duhej zoti Gashi, nuk di a ka autorizuar dikë a jo? Jo!

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete, Hadergjonaj, a e ka autorizuar dikë? Jo!

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për Ndhmën Juridike falas dhe në parim ka miratuar raportin e këtij komisioni, duke vlerësuar si një komision me rëndësi të veçantë, sepse ofron ndihmën juridike falas, që është një element i shtetit social, por njëkohësisht është edhe një standard i Bashkimit Evropian.

Në ndërkohë, Kuvendi e ka në lexim të dytë Ligjin për ndihmën juridike falas, kështu që ne mendojmë se me miratimin e këtij ligji do të rregullohet në mënyrë parimore çështja e ndihmës juridike falas.

Natyrisht, Grupi Parlamentar ka dy vërejtje parimore apo dy propozime që kjo ndihmë juridike falas të jetë konkurrenente me ndihmën juridike me pagesë apo të jetë konkurrenente me avokatinë, në atë mënyrë që të jetë edhe kualitative dhe njëkohësisht ne kemi kërkuar që kapacitetet e këtij institucioni të shtohen, të rriten dhe t'i përshtaten plotësisht natyrës së këtij institucioni.

Edhe një herë, Grupi Parlamentar e përkrah këtë raport.

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND DEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Komisionit për Ndihmë Juridike falas në Kosovë dhe mendojmë që sa i përket punës dhe efikasitetit të cilën e kanë paraqitur në raportin vjetor, ne jemi pjesërisht të kënaqur dhe mendojmë që ndihma institucionale dhe sidomos baza ligjore, e cila tashmë veç është duke u rregulluar me ligjin, sepse kjo deri më tani ka qenë e udhëhequr në bazë të një rregulloreje të UNMIK-ut, mendojmë që edhe punën do ta vë në funksion më të mirë për vitin 2011.

Komisioni për Ndihmë Juridike është i një rëndësie të veçantë sepse ofrohet falas dhe kjo tregon edhe arsyet dhe kompetencat mbi të cilat angazhohen edhe vetë punonjësit vendorë. Sa i përket asaj se cili ishte angazhimi i tyre, sidomos në fushat rreth asaj se kush e shfrytëzon ndihmën juridike falas në Kosovë, këtu shihet që ka pasur një përparim duke marrë parasysh vitet paraprake, sepse qytetarët me nevojë në Kosovë nuk kanë qenë të njoftuar se mund ta shfrytëzojnë këtë ndihmë juridike, e cila është edhe e drejtë e garantuar kushtetuese.

Ne e përkrahim këtë raport vjetor, i cili është kështu, edhe pjesën financiare të paraqitur nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe mendojmë që kontributi tash maksimal duhet të jepet në ligjin, i cili vetëm që është në fazën e dytë të amendamentimit dhe mendojmë që absolutisht do të ketë edhe suksese në të ardhmen që koordinimi më i mirë, zyra koordinuese dhe komisioni do të kenë edhe efikasitet më të madh në punën e tyre dhe angazhimin me Odën e Avokatëve dhe ndarjen e përgjegjësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e përkrah në parim Raportin vjetor të Komisionit për Ndihmën Juridike falas. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i AAK-së, deputetja Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e përkrah Raportin e Komisionit për Ndihmë Juridike falas. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Koalicioni për Kosovën e Re ka shqyrtuar Raportin vjetor të punës së Komisionit për Ndihmë Juridike falas dhe e përkrah këtë raport për arsye të rëndësishme, arsyes dhe kompetencat të cilat i shfrytëzojnë qytetarët e Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar SLS, deputeti Millosavleviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke razmotrila je Izveštaj o rodu Komisije za pravnu pomoć i mi podržavamo ovaj izveštaj. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar “6+”, deputeti Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, nënkryetar!

Bütçe Komisyonu uyarılarıyla birlikte, Hukuk Desteği Komisyon Raporunu, Yasama Komisyonunda önerisi doğrultusunda, 6+ Parlamenter Grubu olarak desteklemekteyiz. Yasanın tamamlanıp yürürlüğe girmesi ile birlikte bu alanı da tamamıyla kapsayacağını düşünmekteyiz. Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka tjerë të paraqitur.

Nuk ka akoma kuorum për të votuar.

Edhe pika nëntë u shqyrtua.

Deputeti Beqiri e ka kërkuar fjalën për procedurë dhe për mocion për pikën e dhjetë të rendit të ditës.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë kam kërkesë në emër të Grupit Parlamentar që pika e dhjetë fare të mos debatohet sot. Arsye e thjeshtë është, ne konsiderojmë që është dashur të vijë i gjithë materiali i kandidatëve me CV e tyre dhe jo vetëm të këtyre katërve. Kjo është biseduar edhe në Kryesi të Parlamentit dhe jemi të bindur që nuk është bërë, pa i nënçmuar ata që janë të

propozuar, nuk është përzgjedhja e duhur. T'ju sillen deputetëve CV-të, do t'i shohin edhe deputetët të tjerë dhe kërkojmë që kjo pikë të shtyhet dhe të jetë në rend dite tjetër ditë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, mocionin unë nuk mund ta hedh në votim për arsye se s'ka kuorum. Mendoj që sot e mbyllim seancën, është vërejtje për të gjithë neve, se s'janë deputetët për të votuar, as mocioni. Seancën, nëse dëshironi e mbajmë nesër, që ta vazhdojmë me votimin edhe me këtë pikë ose e lëmë për javën tjetër. Atëherë, të hënën në orën 10:00. Faleminderit! Mirupafshim!

* * *

E hënë, 4.7. 2011, ora 10:00, vazhdimi i seancës

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Regjistroni prezencën me kartela!

Të nderuar deputetë,

Mirë se keni ardhur në seancën në vazhdim të 30 qershorit të vitit 2011.

Siç e dini, në mungesë të kuorumit, për sot ka mbetur që të vazhdohet me votimin në parim të katër projektligjeve dhe raportit të debatuar në mbledhjen plenare të filluar më 30 qershor 2011.

Po ashtu, për sot ka mbetur të shqyrtohet edhe pika e fundit e rendit të rregullt të ditës. Konstatoj se në mbledhje janë prezentë me elektronikë 74, prezent fizik 75.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Urdhëro, Ismet!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ju përshëndes ju dhe gjithë kolegët deputetë,

Unë kërkoj në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës që pika e fundit që e thatë ju, ose të hyjnë gjithë kandidatët që i kanë sjellë CV-të, me CV mjaftë të pasura, që unë kam përshtypje se nuk i ka shikuar fare ai komisioni ad-hoc, ose kjo pikë të shtyhet për takimin e radhës. Nëse hynë 8 kandidatët që janë, ne i kemi materialet, secili prej nesh, atëherë unë kërkoj që në emër të Grupit, që secili të votohet prej këtyre të 8-ve një nga një për secilin prej tyre dhe të zgjedhën 4 që i fitojnë votat më së shumti. Do të ishte shumë më korrekte se sa të bëhet një selektim negativ, për mendimin tim, pa i nënçmuar ata të cilët kanë ardhur si propozime, por unë mendoj që Komisioni ad-hoc nuk e ka bërë punën ashtu siç duhet dhe absolutisht ka qenë thjeshtë, mos të them marrëveshje grupe kush për kënd dhe nuk janë shikuar CV-të. Shkurt, propozimi ynë është, të

votohen këta të tetë që kanë qenë të rekomanduar më herët para se komisioni të bëjë seleksionimin ose të shtyhet kjo pikë për takimin e radhës. Faleminderit, kryetar! Ne i kemi emrat të gjithë këtu.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Alma Lama. Vetëm nëse për këtë çështje është, nëse është për çështje tjetër, jo. Urdhëro!

Deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: OK. Faleminderit, zoti kryetar!

Pikërisht për këtë çështje desha të flas edhe unë.

Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” është i mendimit që të tetë emrat që kanë ardhur, ose janë seleksionuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave, t’i kalojnë Kuvendit dhe të votohet një nga një. Kjo për arsyen e thjeshtë, sepse Komisioni ad-hoc nuk ka paraqitur fuqinë reale parlamentare të grupeve parlamentare, por kanë votuar përfaqësuesit e partive politike. Dhe, siç e dimë, këtu ka shumë më shumë parti politike se sa grupe parlamentare dhe votimi nuk duket të jetë real. Pikërisht për këtë arsye ne kërkojmë që votimi të bëhet në Kuvend, pra të shtyhet për një seancë tjetër ose si të vendoset. Faleminderit!

KRYETARI: Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, nuk dakordohem me kërkesat e dy përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Ne vlerësojmë se duhet dhe kërkojmë që ta respektojmë ligjin dhe të veprojmë ashtu siç është e përcaktuar sipas ligjit. Komisionin ad-hoc e kemi zgjedhur të gjitha partitë politike, kemi dërguar emrat atje, ua kemi dhënë besimin dhe ne nuk e kontestojmë besimin e përfaqësuesit të Partisë Demokratike në këtë komision, se e ka kryer punën e tij. Nëse dikush ka ankesa, vërejtje, atëherë lirisht le t’i ndjekë procedurat e mëtutjeshme, po ne jemi kundër shkeljeve ligjore.

KRYETARI: Shkelje ligjore ka bërë Komisioni ad-hoc, i udhëhequr nga... Ju lutem, unë e kam ligjin përpara dhe flas me ligj. Unë nuk po flas për mëndësh, mësohuni! Unë jam këtu për ta mbrojtur ligjin bashkë me juve. Në Ligjin e Komisionit të Pavarur për Media dhe transmetim, në nenin 4, pikën e), në mes tjera shkruan: “Komisioni ad-hoc i Kuvendit duhet të përbëhet nga një përfaqësues e secilës parti që është përfaqësuar në Kuvend” edhe pse kjo është në kundërshtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Komisioni duhet të debatojë jo publikisht për të zgjedhur me konsensus 4 anëtarët e Këshillit nga shoqëria civile. Zgjedhja duhet të reflektojë barazinë gjinore, përfaqësimin e komuniteteve në Kosovë, si dhe aftësinë dhe ideshmërinë që kërkon një rregullator i transmetimit. Do të thotë, ligji kërkon konsensus të Komisionit. Nëse kjo nuk parashihet me konsensus, zgjedhja më e mirë është që të tetë me votim të fshehtë t’i nënshtrohen zgjedhjes, nëse kjo çështje nuk është kryer me konsensus dhe si po duket nuk është kryer me konsensus.

Deputeti Ardian Gjini e kërkoj fjalën më parë.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!
Realisht, ju thatë krejt çka pata në plan të them. Faleminderit!

KRYETARI: Nga koalicioni për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!
Duke u bazuar në mbledhjen e Komisionit ad-hoc, i cili ka nxjerrë rekomandim këta 4 emra dhe duke u bazuar në punën e ligjit, i cili potencon që të jenë 4 emra të zgjedhur nga ky komision, atëherë do të mbetet përgjegjësi e këtij Kuvendi t'i zgjedhë këta 4 persona, ose të mos bie ndesh me ligjin. Faleminderit!

KRYETARI: SLS, Petar Miletij.

PETAR MILETIĆ: Ja mislim da bi bilo ipak najbolje da ovu tačku dnevnog reda odložimo, obzirom da kako ste pročitali, u zakonu stoji da ovaj Savet mora da odražava i multietnički karakter Kosova, da budu zastupljene sve zajednice. Ovaj predlog to ne obezbeđuje, tako da mislim da bi trebalo da damo još vremena da ovaj predlog bude u skladu sa zakonom i mi podržavamo predlog da se ova tačka dnevnog reda odloži.

KRYETARI: Nga “6+”, nuk ka.
I kemi dy mundësi, ose ta shtyjme për seancë tjetër, ose ta vëmë në votim mocionin e Lidhjes Demokratike.

(Reagim nga salla)

Ligji nuk na lejon për komisionin të votojmë. Është mirë ta lexojnë dhe ta shohin ligjin ata që marrin vendime dhe herëve tjera të mos na sjellin këtu diçka që kërkohet me konsensus, pa konsensus.

Urdhëro, Sabri !

SABRI HAMITI: Unë i dëgjova kërkesat dhe arsyetimin tuaj, zoti kryetar.
E mira e së mirës është, meqë po shihet që ka interpretime të ndryshme dhe po shihet që ka pakënaqësi të mëdha dhe dyshime në votimet dhe në zgjedhjet e deritashme, propozoj që pika të shtyhet për mbledhje të ardhshme, në mënyrë që të kenë mundësi edhe grupet politike parlamentare të merren vesh se si do të procedohet.

Mua po më duket që sot nuk ka mundësi të ketë zgjedhje të mirë ose zgjidhje të mirë.

KRYETARI: Faleminderit! Po mendoj se, sido që t'ia bëjmë, ne nuk mund të dalim jashtë ligjit. Dhe, me gjasë ne përsëri do ta kemi këtë situatë. Komisioni ad-hoc, pa konsensus nuk mund ta shkurtojë listën. Do të thotë, sipas kësaj pike që unë e lexova, Komisioni ad-hoc pa konsensus nuk mund ta shkurtojë listën, me konsensus mund ta arrijë. Unë dyshoj që Komisioni mund të arrijë konsensus.

(Ndërhyrje)

Mirë, e lëmë deri në mbledhjen e ardhshme.
A jeni dakord?

Kush është “për”? Faleminderit!
Kush është “kundër”?

Vazhdojmë.

- Votimi në parim i Projektligjit për dizajnin industrial

Të nderuar deputetë,
Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për dizajnin industrial.

Në seancë kemi prezent 93 deputetë dhe tani shkojmë në procedimin e votimit.
Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Me 83 vota “për”, 1 “kundër”, 1 “abstenim”, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për dizajnin industrial.

KRYETARI:Urdhëroni! Pa kartela “për”, kush janë? 1,2,3,4,5. 83 dhe 5- janë 88 veta. Pa kartela, a ka “kundër”?

Me 88 “për”, 1 “kundër”, 1 “abstenim”, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për dizajnin industrial.

Kërkohet nga komisionet funksionale dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

Pika e dytë, për sot:

- Votimi në parim i Projektligjit për patentat

Të nderuar deputetë,
Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për patentat.

Në mbledhje janë prezentë 93 deputetë.
Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Pa kartela, “për”? 5!
“Kundër”? Nuk ka.

Me 84 vota “për”, 1 “kundër”, 4 “abstenime”, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për patentat.

Kërkohet nga komisionet funksionale dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Pika e tretë për sot:

- Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratim në parim të Projektligjit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, dhe votojmë tash:

Prezentë janë 93 deputetë.

Pa kartela “për”? 4.

Më 91 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 “abstenim”, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Kërkohet nga komisionet funksionale dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Pika e katërt:

- Votimi në parim i Projektligjit për markat tregtare

Votojmë tash.

“Për” pa kartela? 4.

Me 87 “për”, 1 “kundër”, 2 “abstenime”, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për markat tregtare.

Kërkohet nga komisionet funksionale dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Pika e pestë:

- Votimi i Raportit të punës së Komisionit për Ndihmë Juridike

Vazhdojmë me votimin e Raportit vjetor të punës së Komisionit për Ndihmë Juridike, për vitin 2010.

Kemi 93 deputetë prezentë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Pa kartela “për”? 4.

Më 85 “për”, 1 “kundër”, 3 “abstenime”, Kuvendi miratoi Raportin vjetor të punës së Komisionit të Ndihmës Juridike, për vitin 2010.

Pikën e 6-të të Komisionit ad-hoc e shtymë. Dhe, komisioni ad-hoc duhet ta ketë parasysh se mund ta shkurtojë listën vetëm me konsensus.

Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia për Transkripte dhe Lekturë e Kuvendit të Kosovës